

HEJZA



Olimbi VELAJ

GJUHA ËSHTË TERRENI I POETIT

LIRIA KULTURORE

“Qeveritë nuk mund të përcaktojnë kulturën e një populli! Sepse, vetë qeveritë në masë të konsiderueshme përcaktohen nga kultura e një populli”

(De Cuellar)

Avni HALIMI

Sipas të dhënave analitike të agjensionit për hulumtim të tregut medial, qeveria e VMRO-së, në kulmin e vet propagandistik (gebelsian) ka shpenzuar mbi 150 milionë euro për reklamim të vetvetes, përfshirë këtu edhe fushatën “Investoni në Maqedoni” të zhvilluar nëpër mediat e huaja. Natyrisht, kjo shifër do të shumëfishohet nëse këtu do të kihet parasysh edhe shpenzimet e bëra përgjatë aksioneve të shumta sensibilizuese të ndërmarra nga shumë ekipe qeveritare nëpër vendet e ndryshme në botë. Dhe, e tëra kjo vetëm për ta bindur botën se, pas reformave të thella, “Maqedonia po përjeton një zhvillim mararamendës” dhe po bëhet vend i sigurt për investime. Nga ana tjetër, ky reklamim u përdor si metodë e shkëlqyer për vjedhjen e miliona eurove nga buxheti i shtetit, sepse sikur ta kishin dert reklamimin e “zhvillimit shtetëror”, me ato qindra miliona euro qeveria mund t’i blinte dhjetëra shtëpi televizive më të zhvilluara në Ballkan e më gjerë!

Është shumë qesharake të mendohet se Maqedonia e Veriut atëbotë po përjetonte zhvillim të gjithanshëm. Shkenca zhvillimore këtë fenomen pozitiv, pra zhvillimin, e përkufizon si aktivitet që prek njësoj, jo vetëm çdo sferë të jetës, por çdo komunitet dhe çdo shtresë të shoqërisë. Pra, nëse flitet për zhvillim nënkupton që të gjithë kanë pjesë në kekun e madh të pasurisë. Së këndejmi, “zhvillimet e hovshme” në Maqedoni e Veriut në të vërtetë flasin kryekëput për nëpërkëmbje dhe për diskriminim të hapur etnik. Në të gjitha sferat e jetës “zhvillimi shoqëror” i diskriminonte në mënyrë të veçantë shqiptarët. Nuk mund të flitet për zhvillim të shtetit nëse ai zhvillim favorizon maqedonasit, ndërsa përjashton në masë të madhe nga pjesëmarrja aktive në jetën sociale, kulturore, ekonomike dhe politike të vendit popullatën shqiptare.

Në mënyrë të veçantë përgjatë viteve të qeverisjes së VMRO-së së Gruevskit është folur dhe debati publik është orientuar kah “zhvillimi kulturor” i Maqedonisë së Veriut. Të gjitha “zhvillimet kulturore” që ndodhën këtu nuk pasqyruan asnjë vlerë të rëndësishme, ndërsa u institucionalizua edhe më fuqishëm diskriminimin kulturor kundër shqiptarëve.

Kur mbi një etni ushtrohet diskriminimi kulturor, kjo do të thotë se



a ajo etni është e robëruar, nuk ka liri kulturore. Liria kulturore i përket kolektivitetit, etnisë, ndaj është e veçantë, ndërsa shumica, për të mos thënë të gjitha format e tjera të lirisë i referohen individit. Zhvillim kulturor do të ketë atëherë kur do të ndjehet fuqishëm diversiteti kulturor, kur këto dallime do të konsiderohen si vlera të shenjta brenda shoqërisë së një shteti. Pra, kemi të bëjmë me respektin! Respekti nuk mund t’i nënshtrohet asnjë ligji, asnjë njësitit policor a ushtarak. Respekti është produkt i edukatës së përgjithshme.

Shqiptarët në Maqedoninë e Veriut kurrë nuk kanë pasur probleme me dallimet kulturore të këtij vendi. Shqiptarët i njohin, i respektojnë, madje edhe i përdorin në praktikë vlerat kulturore maqedonase (flasin maqedonisht, këndojnë këngë maqedonase, kërcejnë valle maqedonase, ndjekin teatro, filma, koncerte maqedonase, lexojnë libra maqedonisht etj.) Ndërsa maqedonasit, institucionalisht mendojnë se shqiptarët janë shoqëri akulturore, pa vlera kulture ndaj dhe sanksionohen me ligj; me ligj u bëhet me dije se sa mund ta përdorin gjuhën shqipe dhe, përgjithësisht, sa mund ta gëzojnë jetën e vet kulturore. Natyrisht, ligjet e tilla janë të parespektueshme për

cilido etni. Këto ligje diskriminuese mund të jenë në zbatim dhe ta ngulfasin zhvillimin kulturor të një etnie deri në çastin kur do të shpërthejë vullkani i padurueshmërisë dhe të përmbysë çdo gjë para vetes, edhe pushtetin diskriminues. Asnjë pushtet, asnjë perandori nuk ka arritur ta përmbysë një kulturë, ndërsa kulturat kanë përmbysur pushtete. Revolucionet kulturore nuk janë të panjohura për njerëzimin.

Pushteti në Maqedoninë e Veriut duhet ta shenjtërojë lirinë kulturore dhe ta stimulojë fuqishëm diversitetin kulturor, sepse vetëm në këtë rast mund të themi se kemi zhvillim kulturor. Për t’u respektuar liria kulturore shqiptare në Maqedoni, shoqëria maqedonase duhet t’i qaset një procesi të gjatë edukativ, që nga kopshtet e fëmijëve e deri në instancat më të larta arsimore, në raport me vlerat kulturore shqiptare.

Gjithsesi, janë irrituese, diletanteske dhe demonstrojnë logjikë vasali edhe deklaratat e disa funksionarëve shqiptarë, të cilët me ëndje pohojnë se shqiptarët gjatë qeverisjes gruevskiane përjetuan “një zhvillim të hovshëm kulturor”. Këtë bindje mund ta kenë vetëm ata sllavomaqedonase që janë

shqipfolës! Zhvillimi kulturor nuk mund të matet me botim të një a dy librave më shumë në raport me 10-20 vite më parë, as me shtimin e një shfaqje në repertorin e teatrit, as me 100 euro më shumë për një shoqëri kulturo-artistike, as me 10 ekspozita më shumë nga piktorët shqiptarë. Këto mund të llogariten vetëm aktivitete kulturore që varen nga vullneti i organizatorit dhe pushtetit, aktivitete këto që bien në kategorinë e lirisë individuale.

Në një fjalim të vetin, më 1995, ish-sekretari i OKB-së, De Cuellar, në cilësinë e kryetarit të Komisionit Botëror për Kulturë dhe Zhvillim (WCCD), duke folur mbi zhvillimet shoqërore si dhe mbi raportet e pushteteve karshi kulturës, do të nënvizojë se zhvillimi i ndarë nga konteksti i vet kulturor dhe human është, thjesht, një rritje ekonomike, pa shpirt, pa njerëzoren. Fatkeqësisht, në Maqedoninë e Veriut sot mund të flitet për një zhvillim që ka “shpirt maqedonas”, derisa ky zhvillim i përket vetëm popullatës maqedonase. Popullata shqiptare mbetet e privuar nga drejta kolektive për ta përjetuar një zhvillim të gjithanshëm. Shqiptarët e Maqedonisë janë i vetmi popull në Ballkan që jeton kulturalisht i robëruar!

Midis nesh

KUR ANTIVLERAT NGRIHEN NË PIEDESTAL!

Është dëshpërues fakti që ngritje në piedestal e antivlerave pasohet me duartrokitje dhe ovacione populiste, dhe ende nuk po gjen kurajën t'i kundërvihet askush. Të gjithë kanë zgjedhur heshtjen dhe konformizmin, duke u bërë kësaj pjesë e së keqes

Agim BAJRAMI

Dikush më dërgonte këto ditë një ftesë miqësore, për të marrë pjesë në promovimin e dy librave të tij të fundit me poezi. Më kujtohet se edhe vitin e shkruar, po ky autor kishte promovuar të njëjtin numër librash të të njëjtit zhanër. Në pamje të parë ky është tregues i punës së palodhur të një autori, që nuk lodhet së shkruari dhe promovuari frytet e punës së tij krijuese. Gjer këtu unë mendoj se nuk ka asgjë të keqe. Nuk ka asgjë të keqe edhe fakti, që fushës së vështirë të letrave i janë afruar dhjetëra e qindra moshatarë dhe jo moshatarë të mi. Fundja, secili ka qejfet e veta dhe në një shoqëri të hapur demokratike, dhe askujt nuk ke të drejtë t'i mbyllësh dyert e pasionit dhe ta privosh atë. E keqja qëndron në faktin se edhe pse niveli artistik i dy librave të fundit të individit në fjalë kishte mbetur në vend numëro, zhurma dhe jehona e këtij promovimi ishte shumëfish më e madhe se vitin që shkoi. Të pranishmit sikur ishin vënë në një garë të pashpallur me njëri tjetrin, kush e kush t'i hapte grykën thesit të elozheve dhe hosanave të panumërta, thua se jemi përballë një krijuesi model. Ndonëse shumica e oratorëve ishin të ndërgjegjshëm për vargun e tij modest dhe pa kreativitet individual, u arrit gjer aty sa poezia e këtij autori të konsiderohej si një shkollë e vërtetë poetike dhe akoma më shumë, si një metaforë të së nesërme. Edhe pse jam tashmë me të tillë klimë dhe me të tilla fluturime pindarike, ky vërshim hipokrizie dhe servilizmi më bën për të vjellë. Dhe jo më kot. Jam tepër i sigurt që pas kësaj maskarade letrare, autori në fjalë dhe qindra autorë të tjerë me të tillë begraund, vitin e ardhshëm do të guxojë të promovojë jo më dy, por tre, katër libra të tjerë të të njëjtit nivel, në mos edhe më të dobët. Ndonëse nuk na vjen mirë situata e rëndë që po kalon letërsia jonë, sot më japin të drejtë. Pa llogaritur rrethet e tjerë, vetëm në muzeun historik kombëtar dhe lokale të ndryshëm në Tiranë, kemi të



paktën nga dy tre promovime të tilla në javë. Është një zulmë shkrimore që nuk njih të ndalur. Fakti që sot kemi shumë promovime dhe gjithnjë e më pak vepra me vlera artistike, i atribuohet më së shumti edhe kësaj atmosfere të helmuar. Është dëshpërues fakti që kjo ngritje në piedestal e antivlerave pasohet me duartrokitje dhe ovacione populiste, dhe ende nuk po gjen kurajën t'i kundërvihet askush. Të gjithë kanë zgjedhur heshtjen dhe konformizmin, duke u bërë kësaj pjesë e së keqes. Ideja pesimiste, se e keqja tashmë është trashur dhe ka marrë përmasat e një dinozauri, duket se ua ka errësuar vështrimin dhe logjikën atyre që duhej të merreshin me to. Sot askush nuk çuditet më kur sheh emrat dhe portretet e këtyre lloj monstrave krijues, duke u kapërdisur në çdo portal dhe faqet e para të gazetave dhe revistave letrare, me ngjyra të ndezura dhe format të madh, ndërsa emrat e krijuesve me vlerë duhet llopë që t'i dallosh. Janë po ata pseudo

krijues, që vazhdojnë të popullojnë edhe ekranet e TV-ve lokale dhe kombëtare, duke numëruar numrin e veprave dhe duke dhënë recetat dhe përvojat e tyre krijuese, se si mund të bëhesh poet i suksesshëm, gjithmonë përballë gazetareve të paafta dhe injorante, duke mbjellë kësaj një tymnajë të jashtëzakonshme në arenën tonë letrare. Papërgjegjshmërisë së tyre aq iu bën fakti që që libra të tillë nuk arrijnë të mbërrijnë asnjëherë në duart dhe vëmendjen e lexuesve. Për ta e rëndësishme është vetëm zhurma. Nëse do t'iu hidhnim një sy librave të tyre do të konstatojmë se më shumë se krijime të mirëfillta, vargje e tyre ngjasojnë as më pak e as më shumë me belbëzimet e një fillestari. Është e qartë se pjesa me e madhe e autoreve të tillë vijnë në këtë fushë kreyt rastësisht, sa për të plotësuar një peng të vjetër apo trill personal. Është një gjeografi e tërë moshash dhe profesioneesh, me një begraund kulturor që e fyen botën letrare.

Në kohëra absurde dhe katrohure edhe letërsia dhe artet nuk mund të jenë jashtë këtij kuadri. Nëse dikur botimi i një libri i nënshtrrohej syve të mprehtë të korrektorit dhe redaktorit letrar, sot prania e tyre konsiderohet e panevojshme. Më ka qëlluar shpesh të dëgjoj nga individë të kësaj fushe mendimin se zeja e të bërit libra, qenka gjëja më e thjeshtë në këtë botë, çka nuk është aspak e vërtetë dhe më mbropa pasoja të rënda. Shkruaj këto radhë të detyruara dhe më vjen në mend thënia proverbiale e Kutelit: "poetet kanë fuqinë ta ngrenë dhimbjen në art, aty ku ne të gjithë gjejmë dhimbjet tona". Është një thënie e sintetizuar që e ngrë në piedestal fuqinë e poezisë dhe poetit, si misionarë të së bukurës, çka nënkupton edhe shenjtërinë e kësaj fushe që po keqtrajtohet nga rastësorët. Kush ka lexuar poezitë me të mira të poetëve tanë të njohur bashkëkohorë Ali Podrimja, Petrit Ruka, Ilirian Zhupa, Skënder Rusi, Vllasova Musta, Vaid Hyzoti, Basri Çapriqi etj, do të bindet më së miri për këtë pohim. Të gjithë këta emra që përmenda janë autoritete të njohur, që janë bërë të tillë vetëm nëpërmjet punës së gjatë dhe me shumë privime individuale. Kjo më jep të drejtë të konstatoj se të botosh nga dy libra me poezi në vit, sado i talentuar të jesh, do të thotë që t'i hysh në hak cilësisë dhe vetë poezisë si materie. "Nëse lexoj një libër, që më ngrin zemrën dhe asnjë zjarr mos ta shkrijë, atëherë ajo është poezi", do të thoshte poetja me famë botërore, Emili Dikinsoni dhe kishte kaq të drejtë. Atëherë kujt duhet t'ia drejtojmë gishtin e fajit, kulturës së dobët letrare apo shtëpive botuese. Edhe pse shumë njerëz i amplifikojnë emrat e tyre, mendoj se pjesa e fajit është kompleks. E vetmja zgjidhje për momentin do të ishte importimi i përvojave pozitive nga shtëpitë e mëdha botuese, si "Onufri" GVG, Buzuku e ndonjë tjetër, të cilat kanë kohë që nuk joshen nga paratë dhe ju kanë vënë traun e postbllokut prurjeve të tilla kaq të dëmshme për letërsinë tonë.

Paradokse

MARËDHËNIA ME INTERNETIN/ FACEBUKUN

Duhet të heqim dorë nga "parodia" e pëlqimeve të "pseudo-poetëve" që shiten për "talente" kur botojnë libra, apo kur "shesin" poezi. Duhet të reflektojmë, që poezia të shpëtojë nga vdekja klinike, nëpërmjet një operacion të thellë kirurgjikal

Emrie KROSI

Interneti është mbase mediumi më interaktiv sot. Ai ka hyrë gjerësisht në jetën e njerëzve dhe lehtëson mjaft të përditshmen e gjithsecilit. Një nga vlerat më pozitive të internetit është mundësia interaktive direkte që i ofrohet çdo përdoruesi për të shprehur mendimin e tij në lidhje me tema të caktuara, pra mundësia për të qenë një komunikues dhe në komunikim. Përdorimi i internetit sjell me vete edhe disa rreziqe, ndër të cilat mund të përmendim p.sh.:

- mos reflektimin e përdoruesit mbi informacionet e marra,
- mosverifikimin e mjaftueshëm të dhënave,
- varësinë teknologjike.

Masivizimi dhe përhapja e mediave sociale si: facebook, instagram, twitter etj, ka ndihmuar në përhapjen masive të krijuesve, madje edhe të përhapjes të shumë grupeve "fantazmë" online me poetë apo shkrues edhe nga vende të ndryshme të botës. Shtjta

online e librave nga amazon.com, (themeluar nga Jeffry Preston Bezos) me miliona kopje librash, madje edhe libra nga autorë shqiptarë, por masivizimi global i facebook-ut (fletë libri), nga përditësimi i llogarive personale të miliona përdoruesve në botë, solli "lulëzimin" e shumë poetëve online, që marrin jo vetëm mijëra klikime (pëlqime), por edhe janë në "top listën" e ndjekësve si "mbushamendës" me fjalët klishe: "poet i madh", "gjeni", "penë e shkëlqyer", "bravo, një perlë" etj, etj, përralla të tilla, kur këto faqe sociale janë të mbushura me bejte, apo poezi epike me tema të trishita, të tejkaluara tashmë nga koha, janë jo vetëm të pakontrolluara, por totalisht çoroditëse, si "vetëreklama" për "gjenialitetin" në art, por akoma më keq kur lartojmë lakuriqësinë e antivlerës, në emër të një poezie moderne shqipe. Këto "shkëlqesa" të shpejta të dala si "kërpudha pas shiut" apo të ringjallura nga hiri i asgjësë si Feniksi, duke "gënjyer" veten se janë "gjeni" në mediat sociale, krijohet nga hapësira boshe

që ka lënë mungesa e kritikës profesionale.

Ky lloj "grykimi" nga llogaritë personale të rrjeteve sociale, sidomos facebook-u, duke bërë poezi pothuajse inegzistente, as nëpër debatet televizive, apo medime gazetareske, jo vetëm që evitojnë mungesën e madhe të kritikës, madje (M) e madhe, por thjesht me disa emra (miqtë e drejtuesve apo miqtë e miqve nga llogaritë personale), duke kumtuar "gjoja" talente dhe emra që duhen lexuar, por kjo lajthitje shkon akoma më tutje, kur themi se kemi kritikë, kemi kritikë në bazë shkencore, (kritika si gjykyese e vlerave të një libri), për të orientuar drejt lexuesin, apo kritika për të "asgjësuar kundërshtarin", pse jo kritika e mbushur me superlativa (madje ndonjëherë gabojmë edhe ne "gjykyesit" e ftohtë) që mund të "favorizojmë" ndonjë lajthitje të rastit, teksa mes lektisjeve tona "devijojmë" për të gjetur udhën e duhur të gjykimin të një poezie. Duhet të heqim dorë nga "parodia" e pëlqimeve të "pseudo-poetëve" që shiten për "talente" kur botojnë libra, apo kur "shesin"

poezi. Duhet të reflektojmë, që poezia të shpëtojë nga vdekja klinike, nëpërmjet një operacion të thellë kirurgjikal, që të përm-bushemi në vorbullën e gjithfarshëm të një (pseudo)konkurrimit marramendës poezi-shkruesish (duke përdhunuar çdo ditë trupin e poezisë), jepen çmime, certifikata, me tarafe (njohje) apo qoka ande(je)këndej Drinit (Shqipëri-Kosovë), me ca gjykyes mësues letërsie të zellshëm, kurse çmime kombëtare totalisht të politizuara, njerëz "inorantë" dhe amatorë që drejtojnë dikasteret e artit jo vetëm letërsia, por edhe teatri, filmi, piktura etj., por përthyerjen më negative e ka pësuar poezia, ajo që të trondit shpirtin, njëmendësia e realitetit tonë, (ka derdhur rropullitë era bajgë) në lirinë e tmerrshme virtuale dhe mënyra e transmetimit të kumtit (mesazhit) tek lexuesit, nga poezi-shkruesit (të vetëquajtur "poetë"), të heqin dorën nga maskaradat dhe përcudnimin e asaj që çlirohet nga dëlirësia e burimit të kristaltë të thellësive shpirtërore të një poeti me (P) të madhe.

Për HEJZËN flet Olimbi Velaj, poete

GJUHA ËSHTË TERRENI I POETIT

Agron Tufa e Luljeta Lleshanaku qenë poetë të cilët më mbështetën shumë në fillimet e mia, ndërsa Lazër Stani, Ramadan Musliu, Myftar Gjana, Moikon Zeqo qenë ata që më këshilluan dhe më ndihmuan mjaft në promovimin dhe rritjen time



Fotografia: Rromir IMAMI

Intervistoi: Zyrafete SHALA

Bisedat me Olimbi Velajn nuk mund të jenë ndryshe, përveçse të natyrshme, sepse vetë personaliteti i saj reflekton modesti, thjeshtësi e natyrshmëri. Që nga paraqitja e saj në skenën letrare shqipe e deri më tani kanë kaluar tri dekada. Olimbia, nuk është më ajo studentja njëzetvjeçare që sapo e kishte zbuluar se për të, vargjet do të ishin trajta më e përshtatshme e komunikimit me kohën dhe njerëzit. Krahas poezisë, që vazhdon të mbetet vokacioni kryesor i saj, Olimbi Velaj është edhe studiuese e letërsisë dhe pedagoge në Universitetin "Aleksandër Moisiu" të Durrësit. Poezia e saj është përkthyer në mbi 15 gjuhë të huaja dhe ka përfaqësuar Shqipërinë në festivale të shumta ndërkombëtare të poezisë. Gjatë kësaj bisede u kthyem në vitet '90, për të ndjekur rrugëtimin e Olimbisë nëpër botën e letërsisë dhe evoluimin e saj si krijuese.

HEJZA: A mund të na thoni fillimisht kush është Olimbi Velaj?

O. VELAJ: Jam një shtetase shqiptare me kombësi shqiptare dhe me një ndjesi shumë të fortë të përkatësisë sime si pjesë e këtij kombi dhe e gjuhës shqipe. Kam pasur fat që në fëmijërinë time shkolla ishte shumë serioze dhe merrej shumë seriozisht. Falë arsimit dhe disa modeleve të mësuesve e pedagogëve të mi me

integritet të padiskutueshëm, arrita të bëhem edhe vetë pedagoge në moshën e mesme. Më parë punova si reportere e gazetare për dy dekada dhe kjo eksperiencë që shumë e vyer, sepse më mundësoi të takoja e të njihja dhjetëra njerëz që lanë gjurmë në jetën time si njeri dhe në punën time në aspektin profesional. Fillimisht takimi im me shtypin ishte për shkak të poezisë, kur nisa të botoja si një poete e re. Pak më vonë nisa punën si reportere, duke qenë ende studente. Interesin për studimet nuk e braktisa, edhe pse nuk pata mundësi të punoja në universitet kur u diplomova për Gjuhë-Letërsi në Fakultetin e Histori-Filologjisë. Pata rastin të shkoja për pak kohë në Sofje për një specializim pasuniversitar dhe që atëherë krijova një ide të qartë për interesat e mia studimore, që u përqendruan më së shumti te folklori dhe te raporti i tij me letërsinë autoriale. Kam udhëtuar e udhëtoj shumë, sidomos nëpër Ballkan dhe kjo më ka bërë të kuptoj më shumë shqiptarin, identitetin e tij. E konsideroj veten me fat për shumë gjëra, po sidomos ndjehem me fat sepse bëj gjithmonë punë që i kam për zemër.

HEJZA: Ju filluat karrierën letrare në një kohë kur Shqipëria po kalonte përmes ndryshimeve rrënjësore. Përmbyssa e pushtetit diktatorial nuk ishte thjesht një ndryshim politik, ajo u reflektua në çdo sferë të jetës, duke tronditur kështu edhe themelet e mendimit njerëzor dhe intelektual. Ju bashkë me poetë të tjerë të rinj, u bëtë përfaqësues të ideve dhe tendencave të reja që po

e orientonin letërsinë shqipe të krijuar në Shqipëri, nga realizmi socialist drejt përafrimit me rrjedhat e krijimtarisë letrare evropiane. Si e vlerësoni nga perspektiva e tanishme, ishte fat të jesh pjesë e këtij brezi krijuesish, apo ishte më tepër përgjegjësi?

O. VELAJ: Nga perspektiva e sotme, vetja ime e asaj kohe më duket e çuditshme. Është shumë e vështirë për një njeri në të njëzetat, që është rritur në një vend të mbyllur, me kufizime të jashtëzakonshme, që përnjëherësh të përjetojë ndryshime kolosale, në të gjitha kuptimet. Mua më kishte ndodhur të përjetoja ndryshime të zakonshme si zhvendosja nga një qytet i vogël në një pak më të madh dhe pastaj zhvendosja në kryeqytet. Ndryshimet deri në atë kohë për mua kishin qenë pjesë e një rritjeje normale, por menjëherë, sapo regjimi monist ra, gjithçka u bë e paqartë. Ne ishim shumë të gëzuar që sistemi ndryshoi dhe në muajt e parë ndjeheshim si mbi re, por pastaj kjo liri e shumëpritur na gjeti të paqartë. Nuk dinim si ta administrojmë, sepse ishim krejtësisht të papërgatitur, së pari për ta perceptuar. Ishte vërtet një kohë tronditjeje. Kjo ishte ajo që përjetoja si njeri. Si poete besoj se gjithçka ndodhi pavetëdijshëm. Siç ishim të pakënaqur me jetën e izoluar dhe të varfër në vitet para rënies së sistemit, ashtu ishim të pakënaqur edhe me artin e realizmit socialist, me estetikën e asaj rryme, që në disa raste na vinte ta refuzonim natyrshëm. Në letërsinë shqipe poezia ka një traditë më të gjatë e më të konsoliduar sesa proza. Çdonjëri nga ata që nisi të shkruante në vitet '90 u mbështet mbi këtë traditë, në prurjet më të mira dhe më të palëkundura që nuk mund të zhbëheshin, pavarësisht koniukturave. Nga ana tjetër, mendoj se kemi pasur fat që në vitet '60 erdhën në skenën e letërsisë sonë disa nga poetët më të mirë të gjysmës së dytë të shekullit të XX. Shija e soc-realizmit, letërsia skematike dhe e dobët ishte lënë pas në një masë të madhe në atë kohë. Poetët e dekadave të mëvonshme nuk e patën fuqinë e atyre të viteve '60, megjithatë ata patën meritën që me krijimet e tyre më të mira të siguronin një vijimësi që nuk mund të injorohej. Poetët e viteve '90 ishin të rinj që në një masë të konsiderueshme njihnin gjuhët e huaja, filluan të zbulonin letërsinë e ndaluar dhe filluan të bënin eksperimente, ndonjëherë edhe si formë refuzimi ndaj gjithçkaje që ishte shkruar më parë. Në rastin tim, mënyra si fillova të shkruaja mund të them se që punë e fatit. Kur jeton në kapërcyell të kohëve, të rrymave, të mentaliteteve, të përjetimeve, është e kuptueshme që do të reflektohet kjo gjë edhe në letërsinë që bën. Qëlloi që unë të isha bashkëstudente me një grup të rinjsh që asokohe po spikatnin si poetë me një frymë dhe gjuhë krejtësisht të re. Ata nuk i lidhte thjesht vetëm letërsia, por mbi të gjitha ishin miq me njëri-tjetrin dhe për pak kohë botuan disa numra të një gazete interesante "E për7shme". Asokohe gazeta "Zëri i rinisë" vazhdonte të ishte agoraja dhe forumi i poezisë dhe ishte duke luajtur një rol të rëndësishëm në përzgjedhjen e të rinjve të talentuar. Edhe pse nuk bëja pjesë në ndonjë grupim, unë pata të njëjtin reagim me ata ndaj poezisë paraardhëse. Nuk e bëra me vetëdije të plotë këtë gjë. Mendoj se në

një farë mënyre u ndikova nga gjithçka e asaj kohe dhe intuitivisht e kuptova se duhet të gjeja një mënyrë timen për t'u shprehur. Në letërsi nuk mund të caktosh qëllime dhe pastaj t'i realizosh pikë për pikë. Sidomos në poezi kjo më duket shumë e vështirë për t'u bërë. Dhe të mos harrojmë se asnjë rrymë e re nuk lind nga hiçi. Të gjithë mbështeten te paraardhësit. Puna është si i tejkalon ata; duke i mohuar, apo duke i lënë pas konkretisht me tekstin që shkruan, duke lënë mënjanë format e tjera të kundërshtimit. Kujtoj se në një masë të madhe ndryshimi ndodhi përmes tekstit vetë. Në vitet e mëvonshme e kam parë shpesh emrin tim të përmendet në gjykimin për poezinë pas '90 dhe vazhdimisht e shoh veten të renditur në këtë grupim. Unë jetova në atë kohë, debutova në atë kohë, i njoha këta poetë, disa prej të cilëve edhe sot e kësaj dite i kam miq dhe kur shoh pas, e çmoj gjithçka të asaj periudhe. Çmoj sidomos faktin që ata ishin shumë të hapur dhe pranues ndaj çdokujt që ishte i talentuar. Kjo ishte një gjë që e kujtoj me shumë mirënjohje nga ajo kohë. Dhe kam bindjen se poetët e viteve '90 ishin në masë njerëz më me integritet dhe shumë larg meskinitetit të paraardhësve. Unë nuk i përkisja asnjë grupi, por e ndieja veten të afërt me ta. Agron Tufa e Luljeta Lleshanaku qenë poetë të cilët më mbështetën shumë në fillimet e mia, ndërsa Lazër Stani, Ramadan Musliu, Myftar Gjana, Moikon Zeqo qenë ata që më këshilluan dhe më ndihmuan mjaft në promovimin dhe rritjen time. U jam mirënjohëse të gjithëve dhe mendoj se debutimi si poete në ato vite ishte po aq fat sa edhe përgjegjësi. Të gjithë së bashku, sidomos me tekstet që lamë pas, mbetëm pjesë e një kohe që shënoi ndryshimin.

HEJZA: Në atë periudhë kohore në Shqipëri krijonin disa grupe poetësh, duke filluar nga ata që ende i qëndronin besnikë soc-realizmit, e deri te poetët ish të burgosur politikë që po shfaqeshin me krijimet e tyre në realitetin e ri. Ku e shihni veten në relacion me këto grupime? A ishte krijimtaria juaj më pranë avangardës apo thjesht zhvillohej drejt një fryme moderniste pa u rreshtuar në asnjë grup?

O. VELAJ: Në përgjigjen e mësipërme e kam treguar se lidhet e mia ishin qartësisht më të afërta me grupimin që u quajt avangardë. Siç e thashë, as nuk kërkova të isha pjesë e ndonjë grupimi dhe as nuk e ndjeva të nevojshme t'i përkisja patjetër diçkaje. Thjesht, vijova të shkruaja duke ndjekur prirjen time. Në kohën kur nisa të botoja ishin poetët e viteve '80 ata që dominonin nga pikëpamja burokratike skenën. Ishte fakt që poetët pas '90 po hynin në skenë me një diferencë shumë të dukshme në të gjitha kuptimet. Të gjithë lexuesit e shijes së mirë po e vinin re këtë dhe nuk qe shumë e vështirë për poetët pas '90 që ta zinin me dinjitet vendin e tyre. Sigurisht, edhe sot e kësaj dite ka raste kur duan ta minimizojnë ose ta injorojnë vlerën edhe praninë e disa poetëve të viteve '90. Por, ky nuk është problemi i poetëve, por i njerëzve mediokër që kujtojnë se letërsia bëhet me lista e jarani. Tek e fundit teksti është ai që mbetet dhe secili duhet të kujdeset bash për këtë e jo për lista konfirmimesh e



çmimesh që kanë qenë e do jenë të ndikuara gjithmonë nga subjektivizmi i hartuesve të tyre. Për fat, në letërsi as nuk hyn dot me hatër dhe as nuk qëndron dot me hatër. Këtë gjë e kam kuptuar në këto 30 vjet.

HEJZA: Keni punuar si gazetare vite me radhë, a ka lidhshmëri mes gazetarisë dhe poezisë dhe a mendoni se në rastin tuaj ato i kanë dhënë dhe kanë marrë shumë nga njëra-tjetra?

O. VELAJ: Letërsia dhe gazetaria duket sikur shkojnë krah për krah, por për mua ky është vetëm një iluzion. Mund të jetë mirë të punosh pak vite si reportere dhe pastaj përvojat me njerëzit e ngjarjet t'i përdorësh në punën si shkrimtare ose si poete. Por, të punosh gjatë si reportere dhe të jesh njëherësh edhe poete, kjo është shumë e vështirë. E them këtë, sepse të shkruarit e poezisë më kthehej në pamundësi varësisht ngjarjeve të përditshme që më ndodhnin në punën si reportere e gazetare. Janë dy regjistra të ndryshëm, pavarësisht se i bashkon fjala. Si reportere të duhet të transmetosh me shpejtësi dhe paanshmëri atë që ndodh, kurse si poete të duhet të meditosh dhe të kesh kohë të lirë e qetësi për të përlytur ngjarjet e pastaj, nëse vërtet diçka të ka mbetur për të thënë, ulësh e shkruan. Në periudhat më intensive të punës si gazetare e kam lënë mënjanë poezinë dhe kjo duket edhe nga sasia e të shkruarit. Megjithatë, unë prapë e konsideroj si fat eksperiencën time 20-vjeçare në gazetari. Në asnjë rast tjetër nuk do kisha mundur të përjetoja aq shumë gjëra dhe aq thellësisht sa në atë kohë. Edhe vitet në të cilat punova ishin shumë domethënëse e të papërsëritshme. Më qëlloi të punoja si gazetare për dy dekada, fill pas rënies së sistemit. Përjetova nga afër shumë ngjarje e njoha nga afër shumë njerëz. Eksodet, hapja me botën, transformimi i pabesueshëm që ndodhi e po ndodh për shkak të lëvizjeve demografike kaotike, firmat piramidale,

transformimet e mëdha politike, sociale, kulturore, lufta e Kosovës... Ishte kohë shumë e çmuar dhe besoj se po ndikon ende tek unë edhe tani.

HEJZA: Aktualisht jeni pedagoge në universitet, studiuese e letërsisë dhe vazhdoni të shkruani, si arrini t'i ekuilibroni këto angazhime?

O. VELAJ: Mund të them se kam arritur të gjej një ekuilibër më të shëndetshëm, sapo u largova nga puna e përditshme në gazetari. Sigurisht mësimdhënia kërkon shumë angazhim, sepse që t'u mësosh diçka të tjerëve, duhet të mësosh vetë së pari çdo ditë dhe të jesh në kontakt me çdo të re që ndodh në fushën tënde. Paralel me mësimdhënien puna me kërkimin shkencor kërkon shumë mund, po sidomos kohë të gjatë e përkushtim. Megjithatë, gjatë kësaj periudhe kam pasur më shumë qetësi e mundësi për t'i lënë hapësirën e duhur të shkruarit të poezisë dhe angazhimit me të. Nuk i kam neglizhuar më ftesat që më janë bërë dhe kam marrë pjesë rregullisht nëpër festivale, koloni letrare, kam organizuar mjaft lexime dhe leksione të hapura me poetë të njohur sot në botë dhe këtë përvojë si poete e kam ndarë edhe me studentët në auditor. Mirë do ishte një njeri të merret vetëm me një gjë tërë jetën, po jo të gjithë e kanë shansin ta realizojnë këtë. Mund të them se në rastin tim, diversiteti i punëve që kam bërë e bëj, në fund më ka ndihmuar. Mbi të gjitha, me rëndësi është të bësh punë që të pëlqejnë dhe mua kështu më ka ndodhur.

HEJZA: Duke qenë studiuese e letërsisë kur lexoni një poezi deshët apo jo, i qaseni asaj nga një këndvështrim tjetër, nga ai i lexuesit të zakonshëm. Sipas jush, çfarë duhet të ketë një poezi në mënyrë që ta vlerësoni si të realizuar?

O. VELAJ: Vërtet, dua apo s'dua, nuk jam më ajo lexuesja e 30 vjetëve më parë,

apo as ajo lexuesja e 20 vjetëve më parë. Të lexuarit e teorisë, pjesëmarrja në shumë diskutime, shkrimi i shumë artikujve dhe leximet që zgjerohen me kalimin e kohës, të bëjnë të receptosh ndryshe. Megjithatë, të gjitha poezitë e mira kanë një gjë të përbashkët, ato receptohen menjëherë si të tilla si nga lexuesit që merren me letërsi, si nga ata që nuk merren me letërsi. Një poezi është e realizuar kur përçon ndjesi të lexuesit, kur ia ndryshon gjendjen atij. Për mua është një test i pagabueshëm ndjesia që ke si lexues para dhe pas leximit të poezisë. Nëse leximi i një poezie ta ndryshon gjendjen, atëherë ajo poezi nuk ka si të anashkalohej. Unë di të dalloj kur dikush shkruan vetëm bazuar te frymëzimi, ose vetëm bazuar te leximet. Një poezi e mirë nuk të lë shijen e reminishencës dhe të bën ta kuptosh se autori është i kulturuar, edhe pse ai mund të mos shfaqë asgjë të drejtpërdrejtë që të të kujtojë ndonjë autor të mëparshëm. Gjithashtu një poezi e mirë nuk është kurrë e papërpunuar. Poeti serioz nuk e nxjerr nga dora një tekst pa e shestuar mirë edhe punën me gjuhën. Në fund të gjitha teoritë bien, nëse një poezi nuk të fut në mendime, nëse nuk të prek në një farë mënyre. Poezia e vërtetë është si dashuria e vërtetë, në të nuk mund të gënjesh dhe nuk mund të shtresh, sado aktor i mirë qofsh.

HEJZA: Në letërsi, është e pashmangshme të evitohen ndikimet nga njëri krijues tek tjetri; madje pikërisht këto ndikime e sigurojnë atë vazhdimësinë nga njëra epokë në tjetrën, por gjithnjë duke u pasuruar me elemente të reja. Cilët janë autorët që kanë ndikuar më shumë në formimin tuaj si poete?

O. VELAJ: Unë kam "kopjuar" në fillimet e mia, si çdo i ri që sapo e nis këtë rrugë. Por, ajo ishte vetëm periudha fillestare. Në moshën 20-vjeçare isha shumë e vendosur që të mos ndikohesha

dhe pasi u përpoqa shumë, besoj se arrita të gjeja një rrugë timen. Atëherë edhe fillova të botoja. Mënyra se si më pritën vendosi në një farë mase edhe vazhdimin tim si poete. Poetë që kanë lënë gjurmë tek unë ishin së pari arbëreshët, sidomos disa botime që qarkullonin edhe arbërisht, edhe shqip. De Rada, Gavril Dara i Riu, Serembe... Kam pëlqyer shumë disa poezi të Naimit, Çajupit e Mjedës dhe në tërësi poezinë e Poradecit e të Migjenit. Nga poezia shqipe e gjysmës së dytë të shekullit të XX kam pëlqyer së tepërmi Fatos Arapin. Tek unë ndikoi shumë edhe poezia ruse, angleze, greke. Që një poezi që e receptova vetëm nga përkthimet. Mbaj mend që lexoja e rileoja poezi franceze e spanjolle. Disa poetë që në vitet '80 erdhën përmes antologjive e përkthimeve shumë mjeshtërore në shqip. Jam ndikuar mjaft edhe nga disa poetë të Kosovës, që i lexoja e i rileoja, sepse po në atë kohë pati një kolanë të poezisë që ne e pritëm me shumë gëzim. Nga ata besoj se kam marrë shumë, sidomos në pikëpamje të ekonomizimit gjuhësor. Por, edhe nga bashkëkohësit e mi që sapo kishin nisur të debutonin them se u ndikova. Më shkaktonte çudi poezia e Rudian Zekthit dhe lexoja me ëndje Ervin Hatibin. Pothuajse të gjithë poetët që debutuan pas '90 i lexoja me vëmendje dhe rrallë ka ndodhur të më befasojnë për keq. Më pas kam lexuar poezi bullgare dhe kam përkthyer nga kjo gjuhë. Mendoj se edhe kjo periudhë pati një farë vlere për mua. Ndërkohë që nëpër festivale e aktivitete të tjera ndërkombëtare kam njohur disa poetë bashkëkohorë shumë cilësorë, që edhe ata kanë lënë gjurmë në mënyrën se si shkruaj sot.

HEJZA: Gjatë këtyre tri dekadave sa jeni duke u marrë me krijimin e poezisë, si çdo krijues edhe ju keni evoluuar; me kalimin e viteve ndryshon pikëvështrimi ndaj botës dhe dukurive të saj, por ndryshon edhe ndjeshmëria me të cilën



u përgjigjemi ngacmimeve që vijnë nga realiteti. Si i shihni nga perspektiva e tanishme poezitë e para që keni botuar, a i ndjeni ende afër botës suaj emotive, apo ju duken të largëta?

O. VELAJ: Ndonjëherë i rilevoj poezitë që kam botuar në fillimet e mia dhe ndryshimi vërehet qartë. Kam qenë më naive, por edhe më spontane. Disa prej atyre poezive mbeten cilësore edhe pse koha kalon. Për këtë më vjen mirë. Ndeshmëria mbetet një parametër i pandryshueshëm te poetët, po me kohë ajo nuk përthyeret njëllor edhe në tekst. Në fillimet e mia më pëlqente gjuha e errët dhe asosacionet gati të papranueshme. Isha pothuajse në kufijtë e shkrimit automatik. Për periudha të tëra e kam lënë veten t'i bindesha kësaj mënyre të shkruarit dhe mendoj se më ka vlejtur. Por, më vonë arrita në një pikë që kërkoja të isha e receptueshme nga të gjithë dhe besoj se tani jam pikërisht në këtë fazë, pra që poezia është bërë e receptueshme krejtësisht dhe nuk mbetet

më në mëshirën e interpretimit. Aq shumë e qartë dhe e thjeshtë është bërë poezia që shkruaj, sa që edhe gjatë komunikimit me përkthyesit kujdesem vetëm që ta përkthejnë besnikërisht, sepse kam punuar shterueshëm për të arritur në këtë stad. Nuk qe e lehtë të vija deri këtu dhe nuk mendoj se ky është stacioni i fundit. Fillimet e mia ishin të përqendruara te lirika, pastaj tek-tuk filloi të më shqetësonte realiteti jashtë meje, fillova të shkruaja ndonjë poezi me referencë sociale, megjithëse nuk e pozoja kurrë në mënyrë të drejtpërdrejtë ngjarjen. Gjithmonë jam përpjekur të shkruaj vetëm kur kam pasur diçka për të thënë. Në thelb mendoj se jam e njëjta, por kam ndryshuar në shprehje. Jo aq shumë sa të mos njihem, por kam ndryshuar.

HEJZA: Një poet i mirë, a mendoni se është rezultat i perceptimit të veçantë të botës, njohjes së poezisë (letërsisë), njohjes së vetes apo duhet të gërshetohen të gjitha këto?

O. VELAJ: Mendoj se janë të gjitha këto së bashku. Po si fillim është ndeshmëria dhe mënyra se si e sheh botën, sa kureshtar je si njeri. Gjuha është terreni i poetit dhe sidomos njohja e thellë e gjuhës amtare mbetet një kusht për poezinë. Një poet i mirë është së pari një njeri i mirë. Kuptohet aty për aty kur poezia shfaqet si formë ekzibicioni dhe kur shfaqet si mënyrë për të thënë të vërteta të qenësishme. Talenti pa humanitet është diçka e papranueshme. Njohja e vetes varet gjithashtu nga niveli i humanitetit. Në pjesën më të madhe të rasteve poetët zbulojnë veten përmes shkrimit të poezisë. Edhe kultura është e rëndësishme, leximi i vazhdueshëm i poezive të tjerëve në epoka dhe gjuhë të tjera. Edhe pse ajo nuk është më e rëndësishme se talenti, prapë luan një rol të padiskutueshëm. Puna e madhe dhe të shkruarit e vazhdueshëm, pa hequr dorë për periudha shumë të gjata, mendoj se kanë mjaft

rëndësi. Në fund, ajo që të bën poet të mirë është besnikëria ndaj vetes dhe sinqeriteti në të shkruar.

HEJZA: Në vëllimin e fundit poetik që keni botuar "Lumturia e të tjerëve" ("The others happiness") vëllim dy gjuhësh, keni përfshirë poezi nga të gjitha periudhat e krijimtarisë tuaj. Çfarë ju motivi që të bëni një sintezë të tillë pikërisht tani?

O. VELAJ: Kisha shumë, shumë kohë që nuk isha e pranishme me një libër. Edhe pse nuk punoja në gazetë, një pjesë e madhe e kohës në universitet më kalonte duke bërë detyra administrative, si zëvendës-dekane dhe përgjegjëse departamenti. Kjo periudhë zgjati për 8 vjet. Gjithashtu pata një periudhë 5-vjeçare angazhimi në Universitetin e Beogradit dhe më herët një periudhë 2-vjeçare në Kolegjin AAB në Prishtinë. Së fundi, për arsye objektive, hoqa dorë nga pozicionet administrative dhe nga punët e tjera e iu përkushtova tërësisht vetëm punës si lektore (vetëm në një universitet) dhe poezisë. Kështu erdhi edhe ky libër. Kishte vite që rrinte në sirtar, bashkë me përkthimin e bërë nga Ukë Zenel Buçpapaj. M'u desh vetëm të shtoja një cikël me poezi të viteve të fundit dhe e dërgova për botim. Të gjitha poezitë e këtij vëllimi kanë qenë të botuara nëpër rubrikat letrare të gazetave ose në revistat letrare në qarkullim. Erdhi si një borxh që ia kisha vetes. Nuk kishte pse të mos i mblidhja në një libër ciklet poetike që i kisha botuar më parë në kohë të ndryshme. Kështu është edhe më e lehtë për ata që do të duan ta lexojnë poezinë time. Shumë nga poezitë e këtij vëllimi edhe janë botuar në disa gjuhë dhe unë pata marrë pjesë në festivale e antologji të ndryshme, duke u përfaqësuar me ato. Gjithashtu paralel kisha nisur të bashkëpunoja për përkthimin e librit në italisht dhe për këtë falënderoj shumë Valbona Jakovën, Beppe Costa-n dhe Claudio Moica-n. QKL e shpalli fitues librin në konkursin për botimin e veprave shqip në gjuhë të huaja dhe ndodhi që edhe botimi shqip-italisht të bëhej brenda të njëjtit vit.

HEJZA: Botimi i radhës do të jetë nga fusha e studimeve letrare apo ndonjë vëllim tjetër me poezi?

O. VELAJ: Kam punuar për një vëllim të ri me poezi dhe besoj se vitin e ardhshëm do arrij ta botoj. Gjithashtu kam nisur të punoj për një monografi që përqendrohet te mënyra si e mësojmë dhe si e studiojmë folklorin. Besoj se për dy vjet këtë punë do ta kryej, nëse gjithçka do të shkojë normalisht.

HEJZA: Për fund, çfarë do t'u thoshit krijuesve të rinj apo atyre që e duan poezinë, por që ende nuk e kanë marrë guximin të shkruajnë?

O. VELAJ: Do t'u thosha që poezia nuk duhet ngatërruar me asnjë formë ekzibicioni dhe që duhet të përballesh me publikun, nëse janë të bindur për artin e tyre. Unë kam këtu parasysh njerëz që janë shumë të qartë dhe që nuk i kanë hyrë kësaj rruge për asnjë interes tjetër, përpos atij artistik. Mendoj se përballa është domosdoshmëri në çdo rast. Cilado qoftë pasoja, është më mirë kur përballesh, sesa kur i shmangesh përballesh. Nëse shkruani mirë, herët apo vonë, do ta keni lexuesin tuaj dhe do ta merrni shpërblimin. Unë uroj që në letërsinë shqipe të kemi më shumë autorë që do t'i kalojnë kufijtë nacionalë, realisht, vetëm për shkak të cilësisë së shkrimit.

Në shiritin e kohës

MISTIFIKIMI I PËRDITSHMËRISË

Shqiptarët sot e gjithë ditën e mistifikojnë përditshmërinë dhe nga ajo krijojnë fetishe e tabu. Shqiptarët ballafaqohen me një problem fundamental dhe me domethënie ekzistenciale: zbulimi i së vërtetës, shqiptimi i saj dhe shpallja e saj si gjë publike



Ramadan MUSLIU

Jeta e ballkanasve sot e gjithë ditën është e mbushur me tabu e fetishe. Që nga ardhja e sllavëve këtu, asgjë nuk ka ndryshuar në konfiguracionin psikologjik e moral. Mesjeta në mënyrë latente ruhet dhe ajo për çdo ditë e më tepër shfaqet herë si reminiscencë e një psikologjie që prirët nga mistifikimi, herë si një filozofi me karakter të errët bizantin, herë si iracionalitet që mbytyt arsyen. I njëjti pozicion mesjetar sot vepron në raportet ndëretnike: sllavët edhe më tutje synojnë ekspansionin në veri, jug, lindje e perëndim, duke riprodhuar rudimentet e dyndjeve barbare dhe filozofinë e rrënimt të çfarëdo shenje dhe parashenje kulturore autoktone. Shqiptarët sot e gjithë ditën sillen në rrethin e mbyllur të mallkimit skllavëror, duke i ndërruar ideologjitë e kohës sonë në vend të religjioneve, siç bënin më parë, dhe rishitas kthehen brenda skemave mesjetare bizantine: ndërto me dorën e djathtë e rrëno me të majtën. Imazhi ikonoklast vazhdimisht është fotografi dominuese: rrënohen përmendore e shtatore, fotografi e portrete dhe rishitas, në vend të tyre, synohet të vihet diçka tjetër, shtatorja a portreti i prijësit karizmatik, i cili gjithsesi duhet t'i ngjasojë të përparshmit. Që nga Lufta e Dytë e kënde, shqiptarët kanë jetuar me iluzionin e një mirëqenie që del nga dëgjueshmëria e pushtetit, i cili këtë e kishte proklamuar publikisht dhe e kishte shndërruar në normë dhe dispozitë, thyerja e së cilës sanksionohet me ligj. Shqiptarët verbërisht i besojnë sloganit komunist: "vëllazërim-bashkim". Mirëpo, pos sloganeve të ngjashme, jeta e shqiptarit ishte e mbushur me tabu dhe, të

kundërtën e tyre, me fetishe. Që nga Lufta e Dytë e kënde shqiptarëve u përgatiteshin grackat bizantine-komuniste, te cilat kishin për qëllim zvogëlimin numerik të këtij etnosi dhe ndryshimin e hartës etnike të territoreve të tyre. Krahas këtyre grackave, që mbështilleshin me ideologji dhe doktrinë komuniste, thyerja e të cilave paraqiste herezi, imponohej edhe qëndrimi specifik i shqiptarëve: pranimit i të imponuarës apo refuzimi i saj. Duke u sjellë sipas një skeme që s'është gjë tjetër pos refleks i kushtëzuar pavlovian, tregon shkallën e dresurës kolektive. Pushteti dhe institucionet speciale kishin pasur sukses më të madh në imponimin filozofisë së të nënshtruarit, filozofi kjo që shtrihej mbi të gjitha veprimtaritë jetësore të shqiptarit. Për këtë arsye sot, veç të tjerash, kemi një qëndrim specifik ndaj përditshmërisë dhe ngritjes së saj në statusin e faktit historik. Shqiptarët sot e gjithë ditën e mistifikojnë përditshmërinë dhe nga ajo krijojnë fetishe e tabu. Shqiptarët ballafaqohen me një problem fundamental dhe me domethënie ekzistenciale: zbulimi i së vërtetës, shqiptimi i saj dhe shpallja e saj si gjë publike. Pikërisht shpallja publike e së vërtetës është kulmi i ironisë së jetës së shqiptarit, sepse çdo e vërtetë që mund t'i thuhet në sy, jo vetëm që do të konsiderohet herezi, por merr edhe domethënie e tradhtisë. Prandaj, sot shqiptarët ballafaqohen me problemin fundamental që i jep kuptim ekzistencës: çfarë është morali i tyre kolektiv. Ta përsëritësh formulën se skllavi nuk ka moral, do të ishte shkalla më e lartë e anatemimit. Mirëpo e vërteta është e vërtetë, kurse etiketa që mund të fitohet, mund të hiqet vetëm në kohën kur do të konstituohej morali

qytetar dhe do ta zëvendësonte moralin e skllavit, domethënë imoralitetin e tij.

Përditshmëria e shqiptarit paraqet një lëndë jashtëzakonisht të pasur për hulumtime sociologjike dhe të formave të tjera për ekspertët e këtyre lëmenjve që, fatkeqësisht, i kemi fare të pakët. Te jeta publike e shqiptarit dominon skema intelektuale, kulturore, shoqërore dhe etike, që është në përputhshmëri me atë të formacionit feudal.

Kjo edhe s'është befasuere kur në plotëni e bëjnë jetën feudale, kur gjithë aktiviteti i intelektualit dhe i individualitetit përmbillet në aktivitet të qarqeve e klaneve të izoluar. Shqiptarët assesi nuk bëjnë jetë kombëtare. Ky fakt tregon se nuk kanë as shkencë, as ekonomi, as kulturë kombëtare, së paku jo si formacione të mirëfillta. Në vend të këtyre, shqiptarët e kësaj gjysmëpjesë të kombit, por edhe ajo tjetra, kanë individë, kanë individualitete krijuese. Formacionin kombëtar, i cili për Evropën e sotme është një arkaizëm i tejkaluar nga zhvillimi i tyre shoqëror, e krijojnë mekanizmat shtetërore, që mjerisht te shqiptarët janë në formë rudimentare. Shqiptarët me një shtetësi jo fort të moçme, në kuptimin modern të shtetësisë e jo sipas normës mesjetare apo antike, nuk kanë mundur t'i aktivizojnë ato mekanizma. Mungesa e aktivizimit të tyre, gjë që vlen më shumë për këtë pjesën e këtushme të shqiptarëve, ka bërë që sot të jetë dominuese skema mentale bizantine-komuniste. Pikërisht bizantinizmi është filozofia përcaktuese jo vetëm e shqiptarit.


Çështja është në raportet ballkanike, sepse Ballkani e ka humbur statusin që ia jepte epiteti Evropë Juglindore, të cilën e gjakonte Konica ynë i madh,

ndryshojnë për nga qëllimi. Qëllimi ekspansionist serbo-malazez bëri që martirizimi të bëhet në funksion të mistifikimit të së drejtës etnike dhe historike ndaj Kosovës. Tek shqiptarët përfytyrimi i shtrembër krijohet nga refleksi mbrojtës. Sot e gjithë ditën jemi dëshmitarë të një martirizimi të viktimeve, një pjesë e të cilave janë viktima rasti, me qëllim të krijimit të refleksit mbrojtës. Shtrohet pyetja: ku është e vërteta dhe moraliteti i aktit? Kur mungon mbrojtja e vërtetë, kur mungojnë mekanizmat e mirëfilltë mbrojtës, atëherë mistifikimi duhet ta zëvendësojë moralitetin. Kështu krijohen fetisheet dhe tabutë, ndalesat dhe glorifikimet. Skema mendore e individit të përditshmërisë sonë sillt në rrethin që fillon me hiperbolizimin dhe përmbillet me antitezën e saj, në llotë. Zmadhimi dhe mohimi janë dy qëndrimet komplementare që herë e mbysin e herë e ngjallin të vërtetën. Më në fund, e vërteta është ajo që gjendet e shtrirë në shtatin e Prokrustit dhe që duhet të shkurtrohet apo të zgjatet sipas nevojës. E vërteta e përdorshme dhe me afat të caktuar të qëndrueshmërisë, as që është e vërtetë. Sllavët, serbët, malazezët e maqedonasit, me pëlqimin e fshehtë të sivëllezërve të tjerë, do të sillen me moralin e xhandarit ndaj "delikuentëve" shqiptarë, që kohëve të fundit kanë pushuar t'i besojnë humanitetit të xhandarit. Ndërkaq shqiptarët, ngadalë por shumë sigurt, po kuptojnë se jeta nën tutorinë e xhandarit është imorale. Kur shqiptari ta kuptojë se skllavi nuk ka moral, atëherë duhet të shpresojë se ka filluar të çlirohet së brendshmi.

(Dita, 15. VI. 1991)

PAK MBI ARSYEN, NË LAGJEN E SHPIRTIT

Asgjë nuk i ka shkaktuar njerëzimit më shumë vuajtje sesa hegjemonia e mendimit pa shpirt. Është e vërtetë se secili mendim konsumohet herët a vonë sepse realiteti zbulon përfundimisht falsitetin e tij, megjithatë, nëse mashtrimi themelor nuk njihet, një mendim i gabuar, thjesht, zëvendësohet nga një tjetër



Njeriu i vërtetë

Të gjitha llojet e paragjyqimeve dhe dilemave nënkuptojnë se jemi të identifikuar vetëm me arsyen që mendon. Kjo, do të thotë, se ne nuk shohim qeniet reale, por vetëm përfaqësimet e atyre qenieve në procesin e racionalizimit. Reduktimi i vitalitetit të një qenieje njerëzore në një shfaqje është një formë dhune në vetvete. Të menduarit që nuk bazohet në vetëdije shpirtërore bëhet i vetë-mjaftueshëm dhe jofunksional. Inteligjenca e ndarë nga urtësia është jashtëzakonisht e rrezikshme dhe shkatërruese. Kjo është gjendja aktuale e shumicës së njerëzimit. Inkurajimi i mendimit përmes shkencës dhe teknologjisë, ndonëse në thelb nuk është i mirë dhe as i keq, bëhet gjithashtu shkatërrues sepse shumë shpesh mendësitë nga të cilat ato lindin nuk janë të bazuara në vetëdijen e brendshme. Hapi i ardhshëm në evolucionin njerëzor është të kapërcejmë të menduarit dhe të kalojmë në lagjen e shpirtit. Kjo duhet bërë tani dhe paraqet detyrë urgjente. Kjo nuk do të thotë që njeriu duhet të ndalojë së menduari, por që nuk duhet të identifikohet më, plotësisht, me të, se mendimet nuk duhet të na zotërojnë. Duhet të ndjejmë energjinë e qenies tonë të brendshme. Vetëm atëherë zhurma mendore do hesht dhe do zhduket. Trupi bëhet kështu derë hyrëse në një ndjenjë më të thellë të gjallërisë që shtrihet nën emocionet dhe mendimet e lëkundura. Në këtë hapësirë mund të ndjejmë vitalitetin me gjithë qenien tonë dhe jo vetëm me kokën. Në atë prani ku nuk ke nevojë vetëm të mendosh, por, edhe të ndjesh çdo qelizë është e gjallë. Mendja do të vazhdojë të funksionojë, edhe atë më mirë, pasi do të përdoret dhe shprehet përmes një inteligjence më të madhe se ego-ja lëndore. Në realitet ky është njeriu i vërtetë.

Në këtë përmasë perceptimi është kristal i qartë, i pa paragjykuar nga mendimet. Pra, ky stad ndryshon nga të menduarit pa prani të vetëdijes. Këtu, disa herë jemi rehat edhe me gjendjen e "mos dijes". E kupton se duhet kaluar përtej mendjes "pa mend", sepse mendja është gjithmonë duke u përpjekur të konkludojë dhe interpretojë. Mendja ka frikë të mos dijë. Pra, kur arrin të pajtohet me kufirin e mendjes, tashmë ke shkuar përtej mendjes. Nga kjo gjendje pastaj lind dija më e thellë, e cila nuk është konceptuale.

Asnjë mendim nuk mund ta përmbledhë plotësisht të Vërtetën

Vepri artistik, filozofia, feja, mësimdhënia, këshillimi, kërkohen përpjekje të cilat arsyen menduese nuk mund t'i përfshijë plotësisht. Një fuqi dhe inteligjencë më e madhe se ne, në thelb e merr përsipër këtë punë. Nuk ka më një proces vendimmarrës - vepri realë ndërmerren në mënyrë spontane - dhe "ne" nuk jemi të vetmit që i bëjmë ato.

Zotërimi i jetës është saktësisht e kundërta e kontrollit të saj. Ne duhet të përshtatem me jetën me një vetëdije më të lartë. E vërteta është shumë më gjithëpërfshirëse nga sa mund ta kuptojë mendja. Asnjë mendim nuk mund të përmbledhë të Vërtetën plotësisht. Për shembull, mund të thuhet: "Të gjitha gjërat janë në thelb një." Është një udhërrëfim, dhe assesi një shpjegim. Të kuptosh ato fjalë do të thotë të ndjesh thellë brenda vetes të vërtetën për të cilën ka mall qenia e njeriut. Realiteti kërkon vazhdimisht jo vetëm ushqimin e mendjes, por edhe ushqim për identitetin e tij, për ndjenjën e vetvetes. Është mënyra në të cilën egoja vjen në ekzistencë dhe në të cilën ajo vazhdimisht rikrijon vetveten. Pikërisht, duhet kaluar pak mbi arsyen dhe vizituar lagjen e shpirtit...

Nga Metin IZETI

Kërcimi mbi arsyen dhe rrugëtimi në lagjen e shpirtit është një dimension që na çliron neve dhe botën nga vuajtjet që ia shkaktojmë vetes dhe të tjerëve kur, "vetja jonë e vogël", e krijuar nga mendja dhe për të cilën ne sot mendojmë se është gjithçka që dimë, e drejton jetën tonë. Dashuria, gëzimi, shtrirja krijues artistik dhe paqja e brendshme e qëndrueshme nuk mund të vijnë në jetën tonë përveçse përmes këtij dimensionit të pakushtëzuar të ndërjegjes. Nëse arrimë t'i përjetojmë, qoftë edhe herë pas here, mendimet që kalojnë nëpër kokën tonë thjesht si mendime, nëse arrimë të vëzhgojmë modelet e reagimit mendor-emocional si ngjarja të ndara nga ne dhe fragmentare, atëherë ai dimension tashmë është shfaqur tek ne - si një prani e absolute ku çdo gjë është menduar dhe gjërat ndodhin, si një hapësirë e brendshme pa kohë, dhe pikërisht aty shpalolet përmbajtja e jetës.

Burgosja konceptuale e vetvetes

Rrymat e mendimit të zhveshur nga zemra e shpirti kanë një inerci të madhe, e cila, siç e shohim, na tërheqë lehtësisht në vetvete. Çdo mendim e mban peshën personale në një hapësirë shumë të ngushtë. Secili mendim dëshiron të tërheqë vëmendjen tonë të plotë. Prandaj detyra kryesore është që un-i jonë i plotë nuk duhet të mbetet në ndikimin e mendimeve të hëpërhëshme dhe t'i merr shumë seriozisht ata. Pasi, mbetja nën peshën e mendimeve pa shpirt e ngatërron mendimet dhe pikëpamjet e saj me të vërtetën. Mendja thotë: kështu është dhe pikë. Ndërsa njeriu duhet të jetë më i madh se një opinion për të kuptuar faktin se sido që të interpretosh "jetën tënde" apo jetën dhe sjelljen e personave të tjerë, sido që të

vlerësosh çdo situatë, nuk është gjë tjetër veçse një këndvështrim, një nga shumë këndvështrimet e mundshme. Realiteti është një tërësi e vetme në të cilën çdo gjë është e ndërthurur, në të cilën asgjë nuk ekziston për vete dhe në vetvete. Opinioni e ndan realitetin, e copëton atë në thërime dhe copa konceptuale.

Arsyeja menduese është një mjet i dobishëm dhe i fuqishëm, por është gjithashtu shumë kufizues kur të merr përsipër plotësisht jetën, kur nuk arrin të kuptosh se është vetëm një aspekt i vogël i ndërjegjes dhe qenies, që në realitet jemi. Urtësia nuk është produkt vetëm i mendimit. Kuptimi i thellë i urtësisë buron nga akti i thjeshtë për t'i dhënë dikujt ose diçkaje vëmendjen e vazhdueshme. Vëmendja, vetëdija është inteligjenca kryesore. Ajo shpërndan barrierat e krijuara nga të menduarit konceptual dhe me të vjen të kuptuarit se asgjë nuk ekziston vetvetiu dhe për vete.

Si të shuhet uria e mendjes

Vëmendja bashkon vëzhguesin dhe të vëzhguarin në një fushë të vetme pranije. Ajo është një vorbë ku shumëshmëria zihet dhe avullohet në njëshmëri. Sa herë që zhytemi në thellësitë e mendimit të detyruar, ne, i shmangemi asaj që jemi. Në këto raste nuk jemi të kënaqur prej asaj ku jemi. Ankthet dhe streset e materializmit të sforcuar dhe konsumerizmit marramendës burojnë nga besimi i gabuar se opinioni pastër racional mund të përmbledhë realitetin ose të vërtetën. Opinione puroracionale janë burje konceptuale kolektive. Dhe fenomeni i çuditshëm është se njerëzit i duan qelitë e tyre të burgut sepse u jep atyre një ndjenjë sigurie, kur thotë, "Unë e di". Asgjë nuk i ka shkaktuar njerëzimit më shumë vuajtje sesa hegjemonia e mendimit pa shpirt. Është e vërtetë se secili mendim konsumohet herët a vonë sepse realiteti zbulon përfundimisht falsitetin e tij, megjithatë, nëse mashtrimi themelor

nuk njihet, një mendim i gabuar, thjesht, zëvendësohet nga një tjetër.

Pikërisht për këtë them se mashtrimi kryesor është identifikimi me opinionin vetëm lëndor. Zgjimi shpirtëror është zgjimi nga gjumi i të menduarit. Sfera e pranisë shpirtërore është shumë më e madhe se ajo që mund të përfshihet nga mendimi. Kur nuk besoni në gjithçka që mendoni, do të dilni nga të menduarit dhe do të shihni mund të mendimi nuk është ai që ju jeni vërtetë. Mendja ekziston në një gjendje "pamjaftueshmërie" dhe gjithmonë dëshiron diçka të arrijë, të rrugëtojë drejt qëllimit. Kur identifikohemi me mendjen, mërziemi dhe shqetësohemi shumë shpejt. Mërzia do të thotë që mendja është e uritur për stimuj, ushqim për mendime dhe kjo uri nuk mund të ngopet përveç se me shpirtin. Kur ndihemi të mërziur, përpiqemi të kënaqim urinë e mendjes duke lexuar revista, duke bërë telefonata, duke parë televizor, duke lundruar në internet, duke bërë pazar. Por ama, sërish mbetemi të uritur, duke pretenduar se kemi ndjenjë të mungesës dhe se mendja ka nevojë për më shumë se sa një nevojë fizike që e plotëson shpejt duke ngrënë më shumë ushqim ose duke përjetuar kënaqësi lëndore.

Ndërsa kur bëhemi të vetëdijshëm për këto ndjenja, papritmas, rreth mendimit, krijohet një hapësirë qetësie. Në fillim do të jetë një hapësirë e vogël, por ajo ndjenjë e hapësirës së brendshme do të rritet dhe ndjenja e mërziës do të zhduket në forcën dhe kuptimin e realitetit. Kështu që edhe mërzia mund të na mësojë se kush jemi dhe kush nuk jemi. Atëherë do të zbulojmë se personi "i dëshpëruar" nuk jemi ne. Mërzia kushtëzohet thjesht nga lëvizjet e energjisë shpirtërore në ne. Njeriu në esencë nuk është një person i zemëruar, i trishtuar ose i frikësuar. Mërzia, zemërimi, trishtimi apo frika nuk janë esenciale, nuk janë personifikuese. Të gjitha këto janë gjendje të mendjes njerëzore. Ata vijnë dhe shkojnë. Asgjë që vjen dhe shkon nuk është ajo që jemi.

FENOMENI KAZANXAKIS

Kazanxakis nuk "plaket" por rinohet vazhdimisht. Janë mesazhet e tij të së ardhmes, të cilat e kapërcenin së tepërmi kohën kur jetonte, që tani kanë gjetur vendin e tyre fiziologjik, tek të rinjtë e kohës sonë

Grigor JOVANI


Dhjetëvjeçarë të tërë pas vdekjes së tij, Nikos Kazanxakis nuk ka reshtur kurrë së udhëhequri "detashmentin e shkronjësve" në letërsinë greke, por edhe në atë botërore. Të ngjan se edhe sot, tastjera e shkronjave e makinës së tij të shkrimit, kudo që të ndodhej, në shtëpitë e veta, në ishullin e Egjinës në Greqi, në Andip të Francës apo në Franburg të Gjermanisë, nuk ka reshtur së prodhuari shkronja dhe fjalë, nga prekjet e vazhdueshme të gishtave të shkrimtarit të palodhur. Ngaqë emri dhe vepra e tij vazhdojnë të jenë në qendër të vëmendjes të gjithë atyre që merren apo ndjekin bëmat letrare nëpër botë. Simpoziume dhe tubime të ndryshme, studime dhe përkushtime të panumërta, vazhdojnë të kenë në fokusin e tyre "fenomenin Kazanxakis", ndërkohë që përkthimet e veprës së tij janë shtuar ndjeshëm kohët e fundit, qoftë në botën paksa konservatore dhe ksenofobe anglosaksone të Letrave, ashtu edhe në pjesën tjetër të "planetit letrar", me shembullin më të freskët, përkthimet e librave të tij në gjuhët kineze dhe koreane. Globit nuk iu shua kurrë etja për shirat e "uraganit Kazanxakis", tani së fundi ca më shumë.

50 e ca vjet pasi makina e dytë më e famshme e shkrimit, për shkak të fotografive të shumta të të zotit pranë saj (e para, pa dyshim, është ajo e Heminguejit), u transferua në shtëpinë e tij prindërore në Kretë, shndërruar tashmë në muze, Kazanxakis vazhdon "të shesë" çmendurisht në "tregjet ndërkombëtare letrare", madje me ritme të shfrenuara. Dhe ndonëse në asnjë nga simpoziumet që përmendëm më lart nuk u dha një përgjigje e saktë, se ç'është ajo që shet më tepër nga ky shkrimtar (gjithë media letrare greke ka këto kohët e fundit në gojë pikërisht këtë pyetje), megjithatë një fakt është kuptimplotë: në dialogun e gjerë publik që hapi në blog-un e vetë elektronik periodiku serioz i Letrave, "Vivliothiki" (Biblioteka), pjesëmarrja e brezave të rinj të lexuesve ishte e jashtëzakonshme. Domethënë, Kazanxakis nuk "plaket" por rinohet vazhdimisht. Janë mesazhet e tij të së ardhmes, të cilat e kapërcenin së tepërmi kohën kur jetonte, që tani kanë gjetur vendin e tyre fiziologjik, tek të rinjtë e kohës sonë.

FENOMENI PAMBARUAR

Kujt i dedikohet, në fund të fundit, kjo fitore prestigjioze e Kazanxakis në betejën e tij të vazhdueshme me kohën - mos mbase duhet shpjeguar me kushtet e një fenomeni të pambaruar letrar? Nuk ka një përgjigje konstante për këtë. Askush nuk e ka dhënë gjer më tani. Është konstatuar vetëm habia dhe admirimi i madh për këtë shkrimtar, që nuk rresht kurrë duke na surprizuar me "të rejtat" e tij.

Dejvis Konolli, duke u munduar të shpjegojë prezantimin e suksesshëm të Kazanxakis në botën anglosaksone, vëren mënyrën se si u transplantua shkrimtari në këtë botë gjuhësore. Madhësia e kësaj figure në botën jo



greke, kushtëzohet nga dy faktorë: i pari është kreu praktik, në përkthimet e tij anglisht mungojnë dialektizmat e shumta të origjinalit, të cilat mund të ndikonin negativisht tek lexuesit. Për të shpjeguar faktorin e dytë, që kushtëzon popullaritetin e Kazanxakisit tek anglosaksonët, Konolli i referohet studiuesit Rodrik Biton, sipas të cilit, veprat e grekut të famshëm përmbajnë një fakt të fshehur, që përjashton a priori çdo zgjidhje të imponuar, duke krijuar ndjenjën e një mesazhi gjithmonë të hapur, që pret zhbirimimin dhe qëndrimin e gjithsecilit prej lexuesve.

Po të shikosh me vëmendje të dy faktorët e sjellë, do të kuptosh fare mirë ç'thotë Konolli, për zbutjen gjuhësore të Kazanxakisit, gjatë përkthimit në anglosaksonishten. Mbetet të shikojmë ç'bëhet me përkthimin e tij në gjuhët e tjera, por edhe në vetë greqishten, që me një mënyrë kaq të papërsëritshme, nuk ka reshtur së ndikuarit masat e lexuesve. Si e ka bërë këtë? Me gjuhën e tij shumëngjyrëshe, njëkohësisht edhe kaq... të rëndë. Për sa i përket konkluzionit të Bitonit, i ka rënë plotësisht në të, kur i referohet "mesazhit të lirë të veprave të Kazanxakis". Kjo e fundit mund të shpjegojë mrekullisht edhe fatin e popullaritetit të jashtëzakonshëm të shkrimtarit në atdheun e tij.

Njëkohësisht, kritika greke, konstaton edhe një fakt të përkundrejt: në të njëjtat libra ekzistojnë edhe disa mendime dhe zgjidhje "të padiskutueshme" nga ana e shkrimtarit. Ndryshe nga ç'e ka zakon, nuk pranon (çuditërisht) kompromise. As që kyn në debatin më të thjeshtë për këtë. Është e qartë se tek ai ekzistojnë disa tabu, që mbase rrjedhin nga atavizma të trashëguara. Si shpjegohet kjo, për një mendje kaq të lirë dhe të përparuar? Nuk mund të gjejmë përgjigje tani. Është çështje hulumtimesh të vazhdueshme. E thamë, nuk është zgjidhur akoma

plotësisht "fenomeni Kazanxakis". Tipar veçues ky për shkrimtarët e kalibrit të tij.

POETI, DRAMATURGU DHE KRITIKU - "AJBERG" ENDE I PAZBULUAR

Kur bëjmë fjalë për fenomenin e qarkullimit të jashtëzakonshëm të librave të Kazanxakis në Greqi dhe në botën jashtë saj, nuk duhet të harrojmë për asnjë çast se fjala është ekskluzivisht për romanet e tij të pasluftës, që shfaqen më 1946, me botimin e "Jeta dhe Qytetaria e Aleksis Zorbas". Megjithatë, edhe Kazanxakis poet, dramaturg dhe kritik, që, le ta pranojmë, shumë vështirë del përpara dhe kuptohet qartë prej publikut të gjerë (me përjashtim, ndoshta, të veprave të tipit "Asketizmi"), vazhdon, megjithatë, të preokupojë seriozisht një pjesë të shkencës filologjike, duke tërhequr studiues të vjetër dhe të rinj në këto monopate të vështira, që ngjajnë të pambaruara. Ka diçka këtu për t'u kthjelltësuar. Nuk është bërë kënaqshëm gjer tani, por kjo nuk do të thotë se është e pamundur të ndodhë në të ardhmen.

Nëse në të kaluarën, kritikët e kanë kryqëzuar sa herë Kazanxakin për veprën gjigande poetike "Odiseas" ose kanë hedhur dyshime për dramaturgjinë e tij, diskutimi për vlerat e këtyre gjineve në veprën kazanxakiane nuk ka mbaruar dhe nuk është thënë fjala e fundit. Ngjan se kjo pjesë e veprës së tij është si pjesa e zhytur e ajbergut, sa më shumë del në dritë duke u kumtuar, aq më tepër zbulohen gjëra të reja, të pa diktuar më parë. Ritmet e këtyre zbulime përshpejtohen nga koha në kohë. Interesimi është i madh.

Tërheqja magnetike që ushtron Kazanxakis, e imponuar pashmang-

shëm tek një pjesë e madhe e botës së sotme filologjike, ka lënë pa shpjeguar ndërkohë edhe një pjesë të historisë së tij. Kolegu dhe miq i tij i afërt, J. N. Perantorakis, duke bërë fjalë për binomin Kazanxakis - kritikë, njëqind vjetë pas botimeve të para dhe mbi gjysmë shekulli nga vdekja e tij, thotë: "Fakt është se shkrimtari lexohet dhe studiohet sistematikisht, pa u sanksionuar, ndërkaq, prej shumicës së kritikëve, një ikonë legjitime e pasaportës së tij letrare dhe e personalitetit të tij krijues." Ajbergut nuk shfaqen një mëngjes plotësisht, në të gjithë trajtën e tyre. Duhet kohë të ambjentohesh me ta, pale t'i hulumtosh siç duhet.

MODERNIZMI -NJE "TREN I HUMBUR"

Gjatë diskutimit për Kazanxakin, që hapi tani së fundi periodiku "Pema", dy nga përfaqësuesit e kritikës moderne greke, D. Dimbirulis dhe A. Bertis, theksojnë se një nga mangësitë më të dukshme të shkrimtarit është dobësia e tij për të bashkëbiseduar me modernizmin.

Kjo e vërtetë nuk mund të shmanget: midis atyre shkrimtarëve që hulumtuuan botëkuptimin dhe mënyrat e shprehjes së modernizmit, Kazanxakis ngjan me një gjigand të pashpjegueshëm, që është i dënur të kërkojë pa sukses qëllimet e vetekzistencës. Fakti është se nuk mundi të bëhet zot i këtij planeti të ri, të përmasave të mëdha, që i rrotullohej përsipër kokës.

Natyrisht, nuk kemi të drejtë ta dënojmë për këtë. Këtë tren e kanë humbur edhe të tjerë, para dhe pas tij. Nuk e arritën ose nuk e kuptuan ç'ishte dhe ku shkonte. Askush nuk doli në gjyq për këtë...


VDEKJA E PASHMANGSHME

(Rreth romanit INATI të Filip Roth)

Adriatik ZEQIRI

Amerika në periudhën e luftës më të ashpër, pas asaj të Dytë Botërore, gjatë luftës koreane, në fillim të viteve '50-ta të shekullit njëzet. Ky është areali kohor dhe social i vendosjes kronologjike të fabulës së romanit "Inati" të Filip Roth, njërit nga shkrimtarët bashkëkohorë më në zë amerikan. Lufta e cila po përpinte me mijëra shpirtra njerëzish në kohë shumë të shkurtër, ishte shndërruar në ngacmimin më të madh në aspektin e ndjeshmërisë, në atë moral, psikik dhe në aspektin e ndërgjegjes. Vdekja e pashmangshme e shumë të rinjve amerikanë në betejat e kësaj lufte, tmerrri që ndillte me situatat që provonte, bënte që sjellja njerëzore, nën trysni anormale, të përjetonte gjendje anormale. Frika nga vdekja (një situatë psikike, që e përcjell njeriun e çdo kohe), është intencë kryesore e cila sjell deri në shpërftyrimin e qenies humane në kodet morale.

Heroi narrativ i romanit është Markus Mesner, hebre me origjinë, i biri i një kasapi kosher, student i vitit të dytë të kolegjit Uajnsburg të Ohajos. Markusi 19 vjeç, do të fillojë studimet e tij në kolegjin "Robert Triti", në qytetin e vogël të Njuarkut në Nju Xhersi, aty ku edhe jetonte me të atin e të ëmën dhe punonte në shitoren e tyre të vogël të mishit kosher, si ndihmës i babait të tij. Ky i fundit pastaj për t'u bërë shkak që Markusi të kërkojë të ikë nga shtëpia dhe të ndërrojë ambientin e kolegjit, nga ai i Robert Trit-it, një ambient ndjellës për të, i dashur, në atë të kolegjit Uajnsburg të Ohajos, duke vazhduar aty vitin e dytë të studimeve. Frika se një ditë djali i tij i vetëm do të dështonte në mësimet edhe do të ishte kandidat potencial për rekrutim për në luftë, e tmerronte kasapin kosher Mesner dhe i kishte krijuar një makth në brendësi të shpirtit. Kjo frikë e njeriut, i cili vetëm kishte humbur njerëz në frontet të largëta gjatë Luftës së Dytë Botërore, është nxitja e veprimeve anormale brenda njeriut. Ai do të ndjekë në çdo hap djalin e tij, duke e nxitur drejt një zemërate (inati) me të, konflikti që në heshtje e ndan me qenien më të dashur, duke e humbur përgjithmonë. Markusi do të zhvendoset në Ohajo që të lirohet nga obsesioni prindëror i të atit dhe në atë mënyrë të vazhdojë studimet në kolegjin Uajnsburg, duke pretenduar rezultate të larta, në mënyrë që të shmangë thirrjen për rekrutim në ushtrinë amerikane, e në këtë formë të përfundonte në fushëbetejat e Koresë, destinim i vdekjes së sigurt. Për t'i shpëtuar kësaj duhej të bëhej loja më e vështirë humane nga Markusi si protagonist duke iu përgjigjur shumë shtresimeve kodifikuese shoqërore, si ato morale e shpirtërore, por që nuk përgjigjeshin në asnjë moment me karakterin, besimin dhe botëkuptimet e tij. Një djalë që ishte hebre nuk arrinte që të dëgjonte shërbesat e të mërkurës në kishën katolike të kolegjit, një i ri që kishte idhull Bertrand Rasellin (një ateist, i laureuar me çmimin Nobel) pragma-



tist, nuk mundej të ishte në pajtim me moralizimet aq kristiane te dekanit Koduell dhe shumë natyrshëm do të ishte konflikti i vazhdueshëm me të; një njeri që kërkonte studim nuk mund të qëndronte në një dhomë me njerëz të tjerë që krijonin gjendje konflikti si Bertram Flaseri, apo edhe të tillë që ishin zhveshur nga ajo që është humane (në kontekstin e dallimit si qenie), për të kaluar në statusin e qenies vetëm, si Eluini. Ai kërkonte qetësinë, apo thënë më mirë vetminë, gjendje tipike për një njeri që ndjenja e frikës i rëndon në ndërgjegje. Frikës nga vdekja, nga vdekja në luftë, një ndjenjë kjo e përcjellë nga i ati i tij, por që padyshim është elementi kryesor emocional që nxitë njeriun drejt veprimeve të pakuptimshme në pamje më reale. Si shtysë prej kësaj, zemërimet ishin më të mëdha, inati ishte më i veçantë dhe veprimet pastaj do të ishin edhe më groteske, duke e shikuar çdo gjë nën hijen e bizaritetit dhe të jashtëzakonshmes, përfshirë edhe lidhjen aq karakteristike me një vajzë që, edhe ajo do të jetë me një nivel të tillë të shprehjes psikike. Olivia Haton, e cila vinte me një traumë mentale nga ndarja e prindërve të saj, duke e

dërguar atë deri në aktin më të tmerrshëm njerëzorë të vetëvrasjes në tentim, ngaqë nuk kishte arritur ta realizonte deri në fund. Dhe, në mënyrë të pashpirt vendoset pikërisht brenda kësaj loje. Loje ndjenje dhe ndërgjegjeje që flet tërë kohën për të keqen, për vdekjen. Dashuria që do të lindë në mes të Olivias dhe Markusit është më dramatikja në konceptim dhe në atë se si ata do ta interpretojnë atë, duke kaluar nivelet e veprimit e të shprehjeve deri në perversione seksuale, por gjithsesi brendapërbrenda sensualitetit të tyre aq të prekshëm dhe të lëndueshëm njëkohësisht; për të përfunduar që të dy në mënyrë të tmerrshme, njëri në institut psikiatrik (Olivia Haton) e tjetri në front të luftës ku edhe i jep fund jetës i vrasë në betejë (Markus Mesner).

Tipizimin si hero narrativ e vendosëm me qëllim që në fillim për të parë pozicionin e rrëfimit të personazhit kryesor të romanit, që është një gjendje jo normale njerëzore, është në pragun mes jetës dhe vdekjes, aty ku çdo gjë mundet të jetë ndryshe, të vlerësohet ndryshe, veprimet, idetë, jeta dhe vdekja vetë. Është momenti kur që të dyja mundet t'i prekësh me dorë. Sugjestionimin e

kësaj e kemi në një tip parateksti, jo shume tipik për zhanrin, dhe në aspektin kompozicional nuk i përgjigjet përmbajtjes së brendshme të pjesës që e ka, por që bën vetëm zhvendosje të pozicionimit të narratorit, mirëpo edhe të leximit me atë rast. Pra, ky është momenti i lojës strukturale të tekstit me një paratekst Inati (si titulli i veprës) shprehje e një ndjenje njerëzore, një situatë psikike koshente dhe një brendateksti sugjestionues për pozicionin e rrëfimitarit, Nën morfinë (titulli i pjesës së parë, pjesa kryesore dhe më e madha e romanit), që është një gjendje tjetër psikike që i përgjigjet me shume subkoshiençës, nën ndikimin e një medikamenti qetësues, morfinës, dhe vendosja njëri në tjetrin do të na sjellë në atë që jam i prirur ta quaj e jashtëzakonshme në letërsi, inati i një njeriu në një gjendje mes jetës dhe vdekjes, në luftë për ekzistencën si qenie. Dhe inati si duket do të drejtohet pikërisht në këtë pikë të fundit, te ideja e ekzistimit si qenie, lufta që duhet të bëhet për të mbijetuar. Pra, e veçanta do të jetë pika prej ku do të rrëfëhet narratori, i cili njëkohësisht do të jetë edhe hero i rrëfimit (tregimit) vetë, një tip retrospekcionit ku sillet në mendje një pjesë e së kaluarës në jetë në një moment delikat të njeriut kur është duke ikur nga kjo botë, por në mënyrë të çuditshme, sepse do të jetë në funksion të rikujtimit të zemërimeve, inateve, duke u dhënë atyre një peshë që edhe nuk mund të imagjinohej prej vetë njeriut.

Për të zbardhur këtë pikë e kemi pjesën e dytë të tekstit me një lloj parateksti metaforik Dalja nga terri (zbardhje), dalje e cila bën zbulesën, duke na orientuar drejt asaj se çka ndodhë në kohë dhe si erdhi gjithë ai rrëfim qëparë. Këtu edhe statusi i tekstit merr trajtë tjetër, i afrohet më tepër kronikës dhe rrëfimi kalon në vetën e tretë. Është pjesa ku bëhet shpallja e vdekjes së Markus Mesnerit në Korenë Qendrore, pasi që i plagosur rëndë për vdekje me orë të tëra kishte qëndruar nën ndikimin e morfinës.

Inat për çka? Zemërim ndaj kujt? Ndaj të atit që e vë nën hekurat e vëzhgimit e kontrollit, ndaj botës që nuk ia qasin botëkuptimet, inat ndaj jetës, njeriut që është i tillë, apo në fund inat ndaj vetes? Po. Inat ndaj të gjithëve nga pak, por ajo që do të jetë në qendër të inateve, është struktura e jetës së njeriut që ka një destinim final, vdekjen, lufta e madhe për të ikur prej saj, për t'iu shmangur, por shmangiet duke mos i duruar brenda vetes sonë. Le të jemi ne të paprekshëm përbrenda egos sonë, dhe bota e jeta të na vijnë përreth ashtu siç ne na përgjigjen, jashtë rregullave, jashtë kanuneve. Kjo është të shikohet në terma egocentristë, gjithçka sillet rreth nesh, e ne jemi qendra. Por, a jemi në gjendje të përballojmë vlera të tilla? Botëkuptimet e tona janë të vlefshme, të paprekshme, të shenjta edhe kur na vrasin. Edhe jeta që aq shumë e duam gjithashtu. Njeriu e ka në dorë të zgjedhë.

E KEQJA PËRBALL SË MIRËS

Dramaturgjia që në kohën e Aristotelit është cilësuar si gjini mimetike, imituese të veprimeve të njohura në jetën e përditshme ose të përfytyruara si të tilla



Emine BORIÇI

Ermelinda Alushani Myzeqari është një ndër shkrimtaret bashkëkohore që në veprën e saj ka përdorur teknika të ndryshme të rrëfimit për të treguar unicitetin e stilit, veçantitë e një shkrimtareje që njeh mjeshtërisht teknikat narrative prozaike. Pa ngurruar mund ta quajmë përfaqësuese të letërsisë së mirëfilltë, e cila me brumin artistik i prezantohet publikut me veprën "Labirinthe e shpirtit". Modernitetin e krijimtarisë e vërejmë në avangardimin e procedeve të ndryshme, duke përmendur thyerjet kohore prolepsike dhe analepsike si një shenjë determinuese e rrymave kapërcyell modernizëm-postmodernizëm. Vepra në aparencën e parë duket e kushtëzuar, e ngërthyer nga fragmentarizimi, por nga koherenca dhe kohezioni i tekstit kuptojmë linearitetin zinxhiror mbi një kuptim, mbi njeriun, i cili është i etur të marrë trajtat e mbinjeriut migjenian, lodron për të qenë pjesë e lirikut romantik deradian, por sërish nuk familjarizohet me këtë diapazon, duke kaluar në absurdin e kohës për t'u vetëquajtur personazh kamynian, por të gjitha këto itinerare njeriu i Myzeqarit nuk frymon i qetë e përzgjedh të përfaqësohet ashtu siç është; njeri postmodernist i cili do të qëndrojë i zhveshur nga çdo parim social, psikologjik, etik e moral. Bilateraliteti i unit midis së mirës dhe së keqes e pozicionon individin e Myzeqarit të përzgjedh duke e obliguar, detyruar të shkojë te pozitivja, edhe pse rruga drejt saj ka vështirësi e lodhje e shënjesi primar është NJERIU, e kjo kuptohet gjatë mënyrave të rrëfimit dhe me anë të monolog-dialogëve të ndryshëm.

Dialogu është element kryesor i

dramës. Dramaturgjia që në kohën e Aristotelit është cilësuar si gjini mimetike, imituese të veprimeve të njohura në jetën e përditshme ose të përfytyruara si të tilla. Kur përkapim dialogë në një prozë (ose poezi epike) ne parafytyrojmë ngjarjen, duke u bërë më shumë sesa lexues, dëgjues të veprës. Pra, konkludojmë mbi dialogun si mjet që krijon imazhe vizive në sytë e lexuesit për të prolepsuar skenën a ngjarjen.

Dialogu bën të mundur afrimin e lexuesit me ngjarjen, duke e bërë tregimin sa më real e sa më pranë lexuesit. Kjo nuk do të ndodhte nëse rrëfimi nuk do kishte element të vetës së dytë. Ashtu si dialogu, edhe monologu është pjesë e dramaturgjisë e cila mundëson një pamje sa më vizive e mimetike të ngjarjes, duke e afruar mjaft edhe lexuesin me të, sa që lexuesi në këto momente është spektator.

Në tregim ky rrëfim ndodh edhe në fjalët e cituara nga personazhet, të cilat si të tilla duhet të ruajnë autenticitetin e tyre, pa ndërhyrje nga jashtë, pra, të përdorura në ligjërata të drejta. Vetë rrëfimi është një element semiotik, analiza e të cilit na ndihmon në hyrjen në skutat më të thella të tekstit. Mbi funksionin rrezatoro - sinekdokizues - funksional që e karakterizon rrëfimin, kemi zgjedhur skicën "Harresa" dhe "Jetëvdekja".

Kjo zgjedhje na krijon mundësi argumentuese se zhanri siç është novela, skica apo romani brenda së njëjtës vepër krijohen nivele krahasimore me anën e procedeve të ndryshme letrare. Rrethi vicioz fillon me skicën "Harresa" dhe përmbyllet me skicën "Jetëvdekja" pasi personazhi kryesor një plak në heshtje kërkon barazinë me banorët e tjerë të qytetit, por nuk merr asnjë respekt dhe për kraheje përveçse përcmim dhe

largim në forma miserable, duke u përjashtuar totalisht. Rrëfimtari i gjithëdijshëm i cili është i predispozuar të dijë të brendshmen dhe të jashtmen e personazhit, na përcjell edhe anshmërinë dhe simpatinë për plakun duke mos e identifikuar me emër dhe me tipare, por ai universalizohet duke e bërë tipar dallues alushian. Na përshkruhet në mënyrë koncentrike, sintetike aparenca dhe bota e brendshme e plakut, por nga rrëfimtari narrator na lë hapësirë të futemi në subkoshiençë të personazhit e të kuptojmë atë në raport me vetveten dhe me të tjerët. Kjo mënyrë rrëfimi përngjan me poezinë që tërësia kuptimore zberthehet në ato vargje të paktë, edhe rrëfimi i veprës në shqyrtim mënjanon te simbioza e psikologjisë dhe e simbolizmit, duke dhënë një vorbull të fuqishme që pranon brenda saj vetëm ata studiuës që arrijnë të rimarrin të njëjtën kënaqësi estetike si autorja e duke u përjashtuar më afër kuptimit të veprës, e në këtë rast më afër personazhit, plakut.

"Plaku erdhi në qytetin tonë bashkë me dëborën e parë. Ishte i kërrusur, i veshur me rreca të fëlliqura, mbuluar me një vështrim të përhumbur dhe ringjalli neveri te bashkëqytetarët e mi. Kur kalonte krahe njerëzve, ata i shmangeshin sikur të kishin frikë mos infekttoheshin..."

Paranteza e vetë titullit përkon me fundin e skicës që figura e atij plaku ishte zhdukur që sa kishte ardhur, e bora nuk arrin të bëhet katarsisi i banorëve, shplarës e simbol i pastërtisë, por një fenomen, dukuri atmosferike që nuk arrin të zhveshë egoizmin mbarënjëzësor, kurse vdekja është forma më e mirë për të gjetur kuptimin e ekzistencës. Frojdi e kategorizon vdekjen si një lloj para-

digme fundamentale ku e panjohura bëhet qëllim në vetvete. Plaku këtë qëllim na e la enigmatik, por përgjigjen decizive e marrim te skica "Jetëvdekja". Një antonim i fuqishëm na vjen që në titull, i ndërtuar nga ana gjuhësore me anë të dy fjalëve që shënojmë të kundërtat e fenomeneve, e nëpërmjet kësaj kompozite gjejmë ciklin jetësor.

Të pranishëm kemi narratorin e vetës së parë dhe të vetës së dytë, duke na përfshirë pikërisht në atë skenë të lartpërmendur; bëhemi njësh me personazhet duke ndërë edhe pëshpërimën me të vogël në Botën e Trilluar. Personazhi vëlla përngjan me plakun, ndonëse guximshëm do të thosha që me anën e teknikës së retrospektivës është i njëjti personazh e në të njëjtat situata. Të kujtojmë rëniën e dëborës, ëndrrat dhe dëshirat e pathëna, vetmia si dhe rrugët që marrin një nocion krejt tjetër. Një procede ndryshe është vetëm shoqërimi ku plaku kishte vetveten dhe natyrën e ftohtë, kurse personazhi vëlla kishte përkrah motrën, armën më të fortë që mund të posedoj ndokush. E plaku na prezantohet nga një zë i dijshtëm dhe vëllai nga shkrirja e vetës së tretë, duke jetësuar dialogun midis gjakut.

Ti je i ri, ke shumë ëndrra, m'i thuaj ato, është e vetmja natë që mund t'i dëgjoj.

Po ja, i thashë, dua që jeta ime të jetë e fshehtë, me mistere të këndshme, e bukur.

Konstatimi i natës së gjatë, natë kuteliane mund të ishte e fundit për vëllain e motrën dhe se kjo në fundit donte më shumë nga jeta e tij, ndonëse ai ia shpjegon fare bukur kur i shprehet se "ky grumbull me dëborë është dallga e detit të jetës, ky tjetri është kali fluturues, kurse ky është shtëpia jonë e bukur dhe e re. Je e vogël për t'i kuptuar kaq gjëra të bukura e kaq të veçanta..."

Nuk është aspak e thjeshtë të kuptohen këto grumbuj sintagmash, të cilat përbëjnë thelbin e jetës, e në një moment sekondar njeriu ikën nga kjo botë sikundër personazhi vëlla, ndonëse na paraqitet si i sëmure dhe i rënduar nga gjendja shëndetësore.

E përfundimi? Harresa për njerëzit e mirë të cilët nuk vlerësohen, por shtypen nga turma në mënyrë të pamëshirshme. Kuptimin e jetës nuk u mundua ta japë personazhi plak, por ai vetëm sa e filloi për të na treguar sesa e keqe është kjo shoqëri e sesa shtypëse, por arrijmë të përfundojmë, arrijmë të japim një definicion me figurën e vëllait, i cili sado thuri ëndrra, ishte pikërisht shoqëria që ia shprishi këto ëndërrime, "Bora e shkrirë në sheshin e asaj province ishte për mua një baltnajë, ku njerëzit shkelin te nxitonin nëpër rrugët e tyre".

E pra, kjo provincë edhe pse në pamje të parë duket sikur është e pastër, nuk është gjë tjetër veçse llum, llum i cili, dashur padashur, të vjen në jetë e të merr në rrjedhën e tij të papastër.

FATKEQËSISHT!

METAFORA KONCEPTUALE

(Rreth poezisë "Korale të përjermëta" të Sadik Krasniqit)



Liridona SHEHU

Aftësia për të prodhuar dhe kuptuar gjuhë, është veti unike e qenieve njerëzore, apo siç shprehet Chomsky (2007:02), pronë unike e llojit njerëzor në thelbin e saj dhe pjesë e përbashkët e trashëgimisë sonë biologjike, me ndryshime të pakta mes qenieve njerëzore. Metaforat konceptuale janë një ndër këto aftësi unike. Gjuha ka aftësi për të siguruar kategori konceptuale që organizojnë e komunikojnë thënie apo mendime që në mënyrë subjektive ndërtojnë realitetin. Realiteti, në anën tjetër, është përvojë e bazuar në njohuri të mëparshme. Metafora, pra, është mendim i strukturuar në shërbim të gjuhës, e gjuha është natyrshmëria jonë.

Lakoff & Johnson (2005) nënvizojnë se metafora konceptuale është në ne, në mendimet e veprimet tona, ajo nuk është veç çështje e gjuhës, por realizohet përmes gjuhës, është natyrshmëri e përditshmërisë sonë. Metafora konceptuale ka një strukturë të veten, është metaforë orientuese dhe ontologjike, ka një vërtetësi të sajën, një theksim dhe një fshehtësi të disa elementeve të saj, e mbi të gjitha, ajo përcjell mesazh, është pjesë e komunikimit, e mendimeve dhe e veprimeve tona.

Interpretim i metaforave konceptuale në tekst poetik

Metaforat në tekstet poetike janë kryesisht figura stilistike, domethënë kemi të bëjmë me metaforën si figurë, por gjatë analizës së të dhënave në korpusin hulumtues, rezulton se metaforizimet konceptuale në diskursin apo stilin poetik dalin me frazema të ndryshme, edhe prej atyre që janë pjesë e natyrshmërisë sonë, d.m.th. e kognicionit tonë. Sipas R. Hudson (2004:91), kultura mund të përcaktohet si lloj i njohurisë së mësuar nga të tjerët, qoftë përmes udhëzimesh të drejtpërdrejta, qoftë duke vërejtur sjelljen e të tjerëve. Derisa e fitojmë kulturën tonë nga ata që kemi përreth, mund të supozojmë që ne e kemi të përbashkët me ta, pra një lloj njohurie ka të ngjarë të luajë një rol thelbësor kur ne komunikojmë me ata, dhe, sidomos, kur ne përdorim gjuhën. Gjuha metaforike e paraqitur në

shembujt e mëposhtëm, na bënë të kuptojmë se kultura jonë gjuhësore ia del t'i zbrërthet dhe t'i njohë konceptet e shfaqura në vargjet poetike, edhe në qoftë se ne si lexues nuk i kemi përdorur kurrë në komunikimet tona shoqërore, por janë diku në dijet tona. Në korpusin hulumtues kemi pasur edhe një poezi që është përzgjedhje subjektive, kryesisht për lehtësi përdorimi të materialeve poseduese.

Fusha e metaforizimeve konceptuale, në njëfarë mënyre e drejton procesin e kognicionit mbi botën dhe kjo fushë përfshin elemente të caktuara kulturore e zakonore të një populli apo një gjuhe të caktuar. Në gjuhën tonë **këmbë të marra**, sipas vargut **Ecim mbi bar me këmbë të marra** (Metaforë strukturale), janë këmbët që ecin ngadalë, këmbë që shkojnë dredhas, këmbë që hedhin hapa të lehtë e me përtesë apo këmbë me të cilat nuk ecet fare. Kjo metaforë e ka kuptimin e njerëzve që nuk ecin, që nuk bëjnë një hap para me vendosmëri, por me njëllot të përgjumjes. Në traditën tonë gjuhësore apo edhe kulturore e rajonale, "m'janë marrë kamtë" e përdorim kur duam të tregojmë se jemi lodhur, kur duam ta shfaqim shqetësimin për shëndetin tonë, apo kur jemi në gjendje të rëndë shëndetësore. E përdorim atë natyrshëm këtë frazë, edhe e kuptojmë atë natyrshëm sa që s'i shkon kujt mendja se ka një bazë metaforike.

Vargjet **Mbi flokun tonë të llamarinë bie shi i imtë** (Metaforë strukturale), dhe **Shikojmë ylberin me sy të qelqtë**, janë njësi që i hasim më rrallë në të folurit e përditshëm, por duket sikur nuk ka nevojë të na sqarojë dikush kuptimin e tyre. **Floku i llamarinë** është floku i thinjur që e tregon edhe një shenjë të pleqërisë, jo domosdo të pleqërisë, por që në traditën tonë gjuhësore perceptohet kështu.

Edhe shikimi i ylberit **me sy të qelqtë** na jep një shenjë tjetër të moshës, të pleqërisë (po e theksojmë, jo domosdo të pleqërisë). A ka sy të qelqtë? A janë sytë tanë të qelqtë? A shihet vetëm ylberi me këta sy? E sa e sa pyetje tjera mund t'i bëjmë, por përgjigjja do jetë e ngjashme për secilën pyetje. Sytë e qelqtë janë syzet që i mbajmë për të përforcuar shikimin, e që në këtë poezi kjo frazë ka efekt stilistik dhe metaforik më të shprehur duke na bërë të kuptojmë se jemi lodhur, po shikojmë drejt plakjes, sepse po ecim **me këmbë të marra** e po shohim **me sy të qelqtë**. Një metaforë e ngjashme me këtë që ka më shumë përdorim tek masa është 'me pa me katër sy', e që thuhet e kanë bazën e njëjtë të shprehësisë, por efekti mund të jetë i përkallëzuar.

Miklojmë zogjtë me gishtërinjtë e vdekur (Metaforë ontologjike), është vargu i radhës i poezisë së lartë-shkruar, varg i cili na i jep shpirt gishtërinjtë, por që ai shpirt është i vdekur. Ne mund të kemi gishtërinjtë të lënduar, të djegur, të gërvishtur, të thyer, por edhe të vdekur, të vdekur janë kur humbin ndjeshmërinë, kur nuk kanë më efekt për kryerjen e nevojave tona, të paktën fizikisht. Ky përshkrim i jep një trishtimi poezisë, duke na bërë të bashkë-ndiejmë gjendjen e

tekst-shkruesit si diçka në rënie, si një trup në rënie, **me këmbë të marra, sy të qelqtë e gishtërinjtë të vdekur**.

Në këto vargje ka një fuqi shprehësie që të merr me vete sepse të duket sikur e njeh atë realitet që e shprehin metaforat e nënvizuara dhe më nuk është vëmendja të mjetet e realizimit por te efektiviteti metaforik. Në gjuhën shqipe **krah i këputur** është krah i lodhur, krah që nuk e kryen më funksionin e tij parësor si pjesë e trupit që është. I paraqitur artistikisht në këtë poezi, **Vallëzimet pa muzikë vallen e krahëve të këputur**, na jep një pasqyrë tjetër të një gjendjeje jo të mirë shpirtërore dhe fizike, të një individi, të një bashkësie shoqërore apo të një populli. Për folësit e shqipes nuk është veç një sintagmë e thjeshtë gjuhësore por prej këndvështrimit që i japim krijon një fushë metaforike që gjen përdorim të shpeshtë në komunikimet tona.

Bryma që bie në plagën me gjak të kaltër, krijon një tjetër efekt metaforiciteti. E dimë se bryma është një shtresë e hollë e bardhë që i ngjason borës, por që kur bie, zakonisht në tetor e nëntor, është si e ngrirë dhe u bën dëm të mbjellave. Vargu **Në plagë me gjak të kaltër bie brymë** është një gjetje e veçantë metaforike që e tregon dëmin apo dhimbjen që na shkaktohet në plagët tona, ashtu siç bimët prishen e thahen nga bryma. Gjithsecili që e njoh konceptin e brymës, do ta ndiejë për një moment dëmin që i vjen prej saj, e atë më tepër nëse plaga që sulmohet është e hapur.

Qeshim deri në kupë të qiellit është metaforë e llojit orientues. Ne e dimë që qielli nuk ka kupë, nuk e shohim, siç e dimë që oxhaku nuk ka ballë, se as ballin e oxhakut s'e shohim. Por e njohim mjaft mirë kuptimin metaforik të tyre, sepse e dimë që kupa e qiellit është pjesa më e lartë e tij, pjesa e thellë qendrore, ashtu siç është edhe kupa e kresë në perceptimet tona. Në shqipen kemi edhe shprehje të tjera metaforike që krijojnë kuptime e realitete prej kupës.

E pa pikëllim hyjmë në ujin e vdekur (Metafora ontologjike)

Bëhemi krejt korale të përjermëta, janë vargjet e fundit të poezisë që po ashtu kanë metaforicitetin e tyre, në të parin duke e animizuar ujin, duke e bërë shpirt të vdekur, dhe hyn në llojin e metaforave ontologjike. Në vargun e dytë, duke u bërë korale të përjermëta, po ashtu metaforë e llojit ontologjik, sepse koralet animizohen, bëhen të përjermëta si njerëzit. Njerëzit, kur zgjohen somnambul, jerm apo përjerm, nuk i kontrollojnë veprimet e tyre, sepse janë në gjendje gjumi, por duken gjysmë të zgjuar e gjysmë të fjetur.

Nëse marrim veç këto tri vargje prej gjithë poezisë:

Vallëzimet pa muzikë vallen e krahëve të këputur

Ecim mbi bar me këmbë të marra dhe

Bëhemi krejt korale të përjermëta (metafora ontologjike), mund të themi me bindje se e kemi kuptuar metaforën e lodhjes, të molisjes, të gjendjes së rëndë shpirtërore e fizike, e cila e ka

kapluar një grup shoqëror apo një popull të tërë. Fuqia e metaforës është në njësitë specifike me të cilat e realizon qëllimin e saj të efektivitetit, por edhe në dijet tona të shtresuara që janë të natyrës kognitive.

Përfundime

Të diskutojmë për metaforat, veçanërisht për metaforat kognitive, do të na duhet të thellohem më shumë në gjuhësi, edhe psikologji, pa lënë anash eksperiencën tonë të natyrshme dhe fushën tonë kognitive. Këtë herë i bëjmë një lexim librit burimor "Metaphors we live by" të L. & J., dhe disa studimeve të shekullit të kaluar dhe të tashëm rreth metaforave dhe morëm për bazë vetëm studimin apo paraqitjen e metaforës konceptuale pa u zgjeruar tej mase, duke identifikuar metaforat strukturale, orientuese dhe ontologjike.

Kemi arritur në përfundim se gjuha, veçanërisht gjuha metaforike, nuk është vetëm veti e teksteve të shkruara dhe nuk kërkon mjeshtri apo aftësi të veçantë, por njësoj është e pranishme edhe në gjuhën e folur, sepse njohjet tona për botën, konceptet dhe fenomenet përreth përbëjnë kognicionin tonë. Ne shkruajmë dhe flasim me metafora konceptuale, sepse sistemi ynë gjuhësor, e përsërisim, është metaforik për nga natyra, e ka bazën në eksperiencat tona fizike. Apo thënë më mirë, gjuha shërben si mjet për t'i strukturuar veprimet tona të përditshme dhe mendimet tona të përhershme të bazuara në perceptimet dhe ndijimet tona.

Edhe një herë po e theksojmë se gjuha është një sistem i strukturuar asisoj që prodhon kuptim përmes mendimeve dhe veprimeve. Ne, vërtetë, jetojmë me metafora, e ndoshta ndoshta edhe të jetuarit është një metaforë, meqë përbëhet nga konkretja që është përvoja shqisore dhe abstraktja që është metaforike.

KORALE TË PËRJERMËTA

Ecim mbi bar me këmbë të marra
Mbi flokun tonë të llamarinë bie shi i imtë
Shikojmë ylberin me sy të qelqtë

Miklojmë zogjtë me gishtërinjtë e vdekur
Vallëzimet pa muzikë vallen e krahëve të këputur
Në plagë me gjak të kaltër bie brymë

Qeshim deri në kupë të qiellit
E pa pikëllim hyjmë në ujin e vdekur
Bëhemi krejt korale të përjermëta.

(Sadik Krasniqi, *Oazë palmash të djegura*, Faik Konica, Prishtinë, 2015)

AFTËSIA PËR TË LEXUAR GJËRAT NË DISA MËNYRA

Autori në të njëqind e shtatëdhjetë e shtatë faqet e këtij libri ndalet në krijimtarinë e autorëve, duke na prurë neve dhe lexuesve të tij e të autorëve në konsideratë një status të thjeshtë e të bukur tërheqës promovues të vlerave të shkrimit, studimit, kërkimit shkencor dhe krijimit shqip

Prof. Dr. Fatmir TERZIU

Autorin e këtij libri me recenca, kritika dhe analiza letrare, Bilall Maliqi, të titulluar „Nëpër vepra letrare” e kam ndeshur në poezi, shkrime të ndryshme, kritika dhe mjaft vëzhgime letrare të autorëve të tjerë. Në këtë rrugëtim dhe pikëtakim letrar në një hapësirë të largët e në një vend ndryshe ajo që na bashkon është leximi i njëri-tjetrit në Gjuhën e bukur Shqipe, pasi ajo që duhet të ridimensionohet është arsyeja që vjen nga pozita gjeografike e Bilall Maliqit që vjen nga ai mjedis ku Gjuha Shqipe meriton vlerën e saj dhe të përkujdesjes në shumë arsye. Kështu dhe ky libër, pra „Nëpër vepra letrare” ka dyfish arsye në këtë vlerë. E para, i përket pikërisht arsyes kryesore me të cilën ky autor, si mjaft të tjerë në kushte të ngjashme nën Serbi, mban gjallë krijimtarinë dhe promovon atë, dhe së dyti talentit të tij të mrekullueshëm që jepet në këtë rast me njohuri, përkushtim dhe dashuri letrare.

Autori në të njëqind e shtatëdhjetë e shtatë faqet e këtij libri ndalet në krijimtarinë e autorëve, duke na prurë neve dhe lexuesve të tij e të autorëve në konsideratë një status të thjeshtë e të bukur tërheqës promovues të vlerave të shkrimit, studimit, kërkimit shkencor dhe krijimit shqip. Marrja në konsideratë e krijimtarisë së autoreve dhe autorëve: Albina Idrizi, Ramize Murtezi- Shala, Hysen Këqiku, Begzad Baliu, Faton Krasniqi, Nijazi Kastrati, Rrahman Hyseni, Bahtijar Kryeziu, Reshat Neziri, Jahi Murati-Staneci, Ferid Selimi, Baki Rexhepi, Mustafë Ismaili, Ejup Kamberi, Hasan Emërllahu, Sadik Sadiku, Shkëlzen Halimi, Agron Boriçi, Raif Gashi, Afrim Mustafa, Murat Ajvazi, Arif Molliqi, Shefki Selami, Marilena Grigore, Neviana Shehi, Juljana Mehmeti, Xhemë Karadaku, Sevdail Hyseni, Rrahman Hyseni, Hyrije Jusufi, Majlinda Shaqiri, Avni Shaqiri dhe Emine Murseli, na jep një pasqyrë të qartë të përkushtimit të kritikut, Bilall Maliqi në të dy pikat e lartcituara. Janë tridhjetë e katër autorë të marrë në këtë konsideratë dhe që në fakt për disa, mund dhe të kishte një botim më vete, pasi autori është ndalur veçanërisht në disa botime të tyre të fushave të ndryshme, sikurse është rasti i botimeve të Baliut e të ndonjë tjetri.

Por, si duhet të vlerësojmë dhe lexojmë këtë libër të përkushtuar të bukur të ndalesës të këta autorë. Ka disa mënyra që shkojnë mrekullisht tek leximi i vlerave që ai përcjell, informacionit dhe domosdoshmërisë së njohjes, por ka një gjë të ndryshme në këtë epokë informacioni, ku ne kemi akses në një sasi të paprecedentë materiali leximi përmes burimeve të mediave sociale, ku ndodh edhe transferimi i zakoneve të leximit, por jo atij të printuar dhe ku duhet natyrshëm



fokusi, reflektimi, thellësia dhe përzgjedhja në autostradën e informacionit që në jo pak raste mund të jetë i ndërlikuar.

Me këtë libër jashtë atyre që të krijojnë stacionim së pari lexojmë cilësinë. Me zgjedhje të pafundme vjen një proces përzgjedhjeje nga autori i këtij libri. Aplikohet me të njëjtën aftësi dalluese që përdoret për raftin e librave në dhomën tuaj. Nuk ndjehesh i detyruar të ndjekësh faqet për shkak të popullaritetit, ose emrit të kolegëve, por ndjen pikat që të bashkojnë kuriozitetin për vlerën që përcjellin librat e tyre. Dhe me këtë libër ndjehesh i qetë, se nuk je më në rrjetet sociale që të krijosh stresin, se sa ndjekës ke ose sa njerëz? profilet? E tyre bëhen palë me shkrimet e tua. Ndërsa përqendrimi në sasi do të mbingarkonte ekranin tuaj të kompjuterit, në këtë rast libri i Bilall Maliqit, mënjanon këtë rudiment dhe sjell kënaqësinë e leximit.

Me këtë libër të autorit Bilall Maliqi lexuesi kryen mes leximit të autorëve në konsideratë edhe kontrollin e cilësisë. Herë pas herë nëpër faqet e librit shndërrohen tematika, ide dhe mesazhe, që mënjanojnë reklamën e reklamimet e bezdisshme. Kjo është një formë e ndryshme dhe pozitive që „Nëpër vepra letrare” zhbiron suksesshëm dhe kërkon përmbajtje me cilësi të lartë, tërheqëse, jo qasje të padurueshme. Nëse furnizimi i tillë informues dhe njohurindjellës ngadalë secila faqe e këtij libri bëhet një faqe e madhe promovuese që shpërqendrohet nga njohuri të tjera më të denja, dhe

aty kupton se është koha për të pastruar atë magazinimin e tepërt që përcjell në ndonjë rasti ndonjë libër me kritika, të cilat janë thjesht lista shoqërisht.

Kjo kulturë e qasjes informuese të krijimtarisë së autorëve të lartcituara në këtë libër duket më pas se u rrit nga kultura e leximeve, që mund të tregojnë se sa thelbësore është botimi i një libri, por dhe transmetimi i tij jo vetëm si format në dhe për epokën dixhitale, por dhe në formën më tradicionale në print. Si të tillë ne jemi rritur duke adhuruar emrat e mëdhenj të letërsisë, Shelley dhe Whitman, Hemingway dhe Faulkner, Sylvia Plaths, e të tjerë që janë dhe bëhen vlera të botës krijuese, por që ka kaq shumë, dhe që një listë e tillë ka ndryshuar në njëzet vitet e fundit. Kanuni letrar nuk është zhvendosur aq shumë sa është prerë në një mijë kanone të ndryshme, të nxitur nga botimet, shtypjet e vogla, mediat sociale dhe një shpërthim i trendeve në Internet, por dhe nga dashamirësi të tilla sikurse është dhe përkushtimi i autorit gjithëplanësh Bilall Maliqi.

Bilall Maliqi injoron kështu snobin e ndezur në veten e parë. Ai hyn në përkushtuesit e denjë konglomerat që po luftojnë dhëmbë e thonj për të ruajtur pjesën e domosdoshme të vlerës dhe cilësisë së librit. Përkushtimet e tij në të gjitha zhanret janë ndryshëm në margjinat e kulturës krijuese shqiptare, duke mbështetur zëra të rëndësishëm dhe shpesh subversivë që përndryshe do të mbyten nga shqetësimet e kësaj gjullurdie tranzicionale dhe tregësime të botimit pa kriter të librit

shqip në këto kohë.

Bilall Maliqi hyn tek kritikët e mirë, të cilët janë eklektikë. „Eklektik” është një fjalë argëtuese. Ata nuk mund të rishikojnë vetëm temat dhe stilet që u pëlqejnë interesave të tyre personale. Njëanshmëria është anatemi për artin e kritikës. Kritikët e mirë janë domosdoshmërisht mendjehapur, shumëdimensionale dhe me ide të rrumbullakosura mirë. Ata e kuptojnë se kjo gjë e quajtur jetë është një përpjekje e rrjedhshme, ndaj dhe „Nëpër vepra letrare” ka shumë arsye të jetë në këtë kënd, sepse aty ndodh leximi si kritik dhe si i tillë shërben që të zgjerojë ndjeshmërinë estetike dhe shtrirjen intelektuale për t’iu përshtatur diversitetit të gjallë të mijëvjeçarit të ri.

„Nëpër vepra letrare” përqafon thelbin ku dallohet aftësia për të lexuar gjërat në disa mënyra, përveç fjalë për fjalë, është një shenjë e pjekurisë intelektuale, atë që Keats e quajti „aftësi pozitive”, një pranim pothuajse shpirtëror i sigurisë në jetë dhe art. Kritikët e mirë e kanë këtë cilësi, edhe nëse vepra e tyre lexohet me një tendencë të caktuar, kjo bëhet dhe nga përkushtimi i denjë i Bilall Maliqit. Për të arritur një perspektivë të re, „Nëpër vepra letrare” dhe autori i tij tregojnë se duhet të shkëputemi nga nocionet e paramenduara dhe të notojmë në mbretërinë e misteriozes, duke shpresuar të dalim në breg me kuptim të ri. Kjo është zemra e kritikës, si dhe e ndjeshmërisë së Bilall Maliqit. Kjo aftësi është ajo që krijon një përvojë leximi të shtresave.

POEZIA SHQIPE ME ALFABET ARAB

Poezia për bejtexhinjtë ishte nostalgji, kujtesë, ëndërr, mall, etje, varfëri, dashuri, harmoni, përsosje shpirtërore

Sulejman MEHAZI

Do ta fillojmë me poezinë "Tirana jonë si mësoi" shkruar nga Zenel Bastari:

*"Ymrin (jetën) na e kanë shkurtue,
po na shtrydhin porsirrush
Bytym kalbi(krejt zemra) na u
coptua,
me vner shpirti u mbush.
Buke pa bukë po rrojnë fakirat,
(të varfërit, të shkretët).
Pa opinga, zbathe e zhveshë;
vetë janë mbulue me gjithë të mirat,
si katilat rrinë tue qesh."* (Zenel Bastari)

Këto vargje poetike të Zenel Bastarit na japin imazhin e kohës së veprimtimit poetik të poezisë shqipe me alfabet arab. Zenel Bastari, i lindur në fshatin Bastar të Tiranës, me këto vargje, jep një tablo të trishtuar të popullatës së Tiranës thujse njëqind vjet më parë, sesa Migjeni me "Poemën e mjerimit". Bastari me nota të ashpra realiste vë në dukje jetën e vështirë e plot vuajtje të masave të varfra të qytetarëve tiranas, pasigurinë dhe pakënaqësinë e tyre në kushtet e sundimit feudal, në shturje të sipër. Në Shqipëri, në shekullin XVIII, lindi dhe u zhvillua një rrymë letrare tepër origjinale, rryma e bejtexhinjve, nga fjala turko-arabe, bejta-vjershë.

Kjo rrymë letrare pati përhapje shumë të gjerë në qytete të ndryshme të Shqipërisë, të Kosovë e më gjerë, por edhe në qendra më të vogla fetare, e më pak nëpër fshatra. Edhe pse krijimtaria poetike e bejtexhinjve ruan ndikimin e poezisë së kulturës orientale, megjithatë është pjesë përbërëse dhe e pandarë e kulturës së popullit tonë. Kjo letërsi me alfabet arab ndahet në dy faza zhvillimore: Faza e parë laike që shkon deri në fund të shekullit XVIII dhe faza e dytë fetare mistike, nis që nga çereku i fundit i shekullit XVIII, kapërcen shekullin XIX dhe vazhdon në shekullin XX, deri në Luftën e Dytë Botërore, sidomos në Kosovë.

Dëshmia më e hershme e shkrimit të poezive me alfabet arab është me titull: "Imzot, mos më lerë pa kave" nga Muçi Zade, më 1725, kurse më e vonshme poezia "Ni e përmene n'gjuhë shqipe" nga Hysni Statovci, më 1947. Sipas kësaj vërehet se kjo poezi u shkrua në kontinuitet për dy shekuj me radhë. Studiuesi Hajdar Salihu, në librin e tij mjaftë serioz "Poezia e bejtexhinjve", Rilindja, Prishtinë, 1987, fq. 14), thotë se: "Poezia shqipe me alfabet arab u shkrua në shekullin 18; vazhdoi të shkruhet prej shumë autorëve në shekullin 19, atëherë kur letërsia e romantizmit dominonte si formacion historiko-letrar; dhe u shkrua edhe në pjesën e parë të shekullit 20^o.

Sipas historisë së letërsisë shqiptare, shekulli XVIII është fundi i letërsisë së vjetër shqipe dhe etapa e parë e poezisë shqipe me alfabet arab. Përfaqësuesit e parë të kësaj letërsie janë: Ibrahim Nezimi apo siç njihet ndryshe Nezim Frakulla dhe Hasan Zyko Kamberi, e më pas një numër mjaft i madh i poetëve: Muçi Zade (Jug), Sylejman Naibi (Berat), Dervish Hasani (Krushë e Vogël), Anonimi i Gjirokastrës, Molla Hysejn Dobraci i Shkodrës, në dekadat e fundit të shekullit XVIII do të shkrua-



jnë poezi edhe Ismail pashë Velebishti, Hysen Efendi Shkodra, Molla Sali Pata që ishte poet satirik i oborrit të Bushatlinjve, Sylejman pashë Elbasani, Ibrahim Elbasani, Sylejman Temani nga Berati, Omer Sadedin Efendi nga jugu i Shqipërisë, Haxhi Ymer Kashari nga Tirana etj. Kjo poezi do të shkruhet edhe gjatë tërë shekullit XIX dhe numri i autorëve në këtë shekull do të jetë shumë më i madh. Veprimtaria letrare e këtyre autorëve do të jetë më e begatshme dhe më e pasur. Vlen të përmendim autorin më kryesor të këtij shekulli, Muhamet Kçyçkun, me poemat me motive islame "Erveheja" dhe "Jusufi dhe Zulejha", pastaj Tahir Efendi Boshnjaku nga Gjakova, Dervish Salihin nga Lubizhdi i Hasit, Dalip Frashërin, Sheh Jonuzin nga Suhadoll i Mitrovicës, Baba Meleq Shemberdhenjin nga Skrapari dhe shumë poetë të tjerë. Poezia me alfabet arab e shekullit XX është shkruar vetëm në Kosovë. Krijues më të shquar të kësaj periudhe janë: Sheh Mala - Rahovec, Vesel Guta - Zaskok, Ferizaj, Hysni Statovci - Batllavë, Llap, Dervish Veseli - Rahovec, Hafiz Imer Shemsiu - Prishtinë, Faik Efendi - Prishtinë, Dervish Idrizi - Gjakovë, Sheh Osmani - Junik, Shaip Zurnaxhiu - Rahovec etj.

FUQIA E ARTIT POETIK

Dihet se letërsia shqipe me alfabet arab, apo letërsia e bejtexhinjve, siç emërtohet zakonisht në terminologjinë e ngulitur teorike e historike letrare, u shkrua në shekujt XVIII e XIX; në qendrat më të zhvilluara ekonomike e kulturore, edhe pse u shkrua sipas modelit të letërsisë së Lindjes dhe se e përdori alfabetin arab, por dukshëm e pasuroi jo vetëm formën, por edhe përmbajtjen poetike. Poezia për këta shkrimtarë edhe pse ishte produkt njerëzor, por i një bote tjetër nga realja, natyrorja, ata shprehnin kumtimet, shpresat për botën që nuk i përkisnin. Poezia për bejtexhinjtë ishte nostalgji, kujtesë, ëndërr, mall, etje, varfëri, dashuri, harmoni, përsosje shpirtërore. Për të gjitha këto bejtexhinjtë na bëjnë me dije se poezia i takon intuitës, imagjinatës, frymëzimit, zemrës, shpirtit, dashurisë, dritës, përjetësisë që i takojnë të njëjtit lloj gjenealogjik të esencës së krijimit.

Poezia për bejtexhinjtë, për dervishët dhe shejlerët është dërgimtare mjaft e duruar që e pranojnë shpirtat e fuqishëm prometheik, të

cilët nga zemrat e tyre nxjerrin zjarr, nga zjarri dritë dhe nga drita nxjerrin përjetësi. Pra, arti poetik në kuptimin e plotë të fjalës është cilësi, vlerë dhe dhuratë natyrore e shpirtërore. Këta poetë para poezisë, melodisë, pikturës gjenden ballë për ballë me fshehtësitë e quajtura cilësi, vlerë, me kuptime e pamje metafizike të fjalës; sepse kjo pamje, ky komunikim bëhet njohuri mbi botën e brendshme shpirtërore, sikurse shkenca që ka njohuri mbi natyrën fizike të jashtme.

Definicioni i artit dhe i bukurisë artistike për bejtexhinjtë është ligj shpirtëror e hyjnor i cili përcaktohet nga frymëzimi që i dedikohet lumturisë së vërtetë njerëzore. "...Prandaj misioni i artit është të na japë kënaqësi estetike që qëndron përmbi të gjitha këtyre mizorive të jetës. Këdojmë një poezi, shikojmë një pikturë, dëgjojmë një simfonie dhe kënaqemi! Jeta na ëmbëlsohet, na bëhet e dashur, e bukur..." (Lasgush Poradeci) Kjo kënaqje e poetëve bejtexhinj, apo e poetëve dervishë nuk krijohet me anë të qasjes së intelektit, analizës, vëzhgimit, eksperimentit dhe përvojës së jashtme që është një shumë e sendeve të dukura me sy të rëndomtë, por tjetër lloj, është krehje në brendi të poetëve, në skutat dhe fshehtësitë më të thella shpirtërore. Këto fshehtësi intuitive, imagjinative poetike bejtexhinjtë i parandiejnë, por nëpërmjet shqisave shpirtërore, siç janë: shqetësimet, përjetimet, dashuritë, vuajtjet dhe aspak s'kanë të bëjnë me njohjen racionale.

Krijimet poetike të bejtexhinjve janë përplot me shenja dhe simbole që i vërejnë vetëm poetët mistik, sepse këta me kënaqësi të madhe flasin për totemin bimë, kafshë, shpezë, yje, qiej, njeri, shpirt, fe, Zot dhe dukuri të ndryshme të cilët i detyrojnë të bëjnë rite dhe vallëzime magjike e mistike. Poezitë e bejtexhinjve që këndoheshin nëpër teqetë e ndryshme ishin ndërmyjetësuese e përjetësisë, duke ngadhënyer fatin e njeriut me ndihmën e fjalës së bukur poetike. Në themel të poezive të bejtexhinjve qëndron uniteti i stërllashtë, sepse dramati poetike dhe tragjeditë e vogla të bejtexhinjve për nga origjina janë bashkë me krijimin e njeriut të parë. Origjina e valëve dhe pikturave poetike, e ritualeve metrike e ritmike, e yjeve kozmike fetare, na duken se janë të lashta më shumë se vet njeriu. Poetët e teqeve, edhe pse e përdornin shkrimin arab, vlerat e tyre poetike-artistike ishin të jashtëza-

konshme, në konstelacionin estetik, botën fizike, materiale, të jashtme e shprehnin dhe e përkujtonin me anë të botës metafizike të zemrës.

SFERA FIZIKE DHE METAFIZIKE POETIKE

Vetëdija kryesore e shkrimtarëve që shkruanin me alfabet arab ka qenë ajo fetare. Të shkolluar kryesisht nëpër medrese, ndaj dhe është e natyrshme që edhe misioni i tyre ka qenë mësimi fetar. Prandaj, edhe hedhja e hapit në fusha të tjera të dijes, si patriotike, shoqërore, iluministe, kulturore apo thjeshtë praktike jetësore, këtë e kanë bërë sipas derës së hapur të vetëdijes fetare. Koncepti kryesor i poezive të bejtexhinjve është dashuria ndaj Zotit, që përbën kulmin ndërlidhëse shpirtërore të sferës fizike dhe metafizike poetike. Si shembull do ta marrim poezinë e Baba Meleq Shemberdhenjit, vjershëtor shqiptar, lindur në krahinën e Skraparit në shekullin XIX, me titull "DASHURIA, DASHURIA" (Poezia e bejtexhinjve, Rilindja, Prishtinë, 1987, fq. 354,355.) "Ku e ngrehu këtë jetë/ Zot i Math e i Vërtete,/ Me Madhëri të Tij Vetë/ Dashuria, dashuria. /Si bëri dhenë dhe qjellë/ pa vuri hën' e djellë,/ shumë farësh që ka mbjellë/ dashuria, dashuria. Kush bëri yjtë dhe renë?/ shtiu shinë njomi dhenë?/ nxori mbi të gjithë ç'qenë/ Dashuria, dashuria. Bëri lumenjtë dhe detnë/ pa nxori Hava, Ademë, /i mësoi emrat sa qenë/dashuria dashuria. Në pleqëri Zeqirjai/kërkoj djallë nga Perëndia,/ Kush ia dha Jahjanë atija? Dashuria, dashuria. Merjemes ashtu ia dhanë/ pa burrë e bëri Isanë,/ Pun' t e Zotit ashtu janë/ Dashuria, dashuria"

Dashuria te këta poetë konsiderohet si një qenie reale e përqendruar në epiqendrën e fizikes reales dhe metafizikes, ideale. Për këta poetë dashuria është thelbi kryesor i botës fizike trupore dhe botës metafizike shpirtërore. Para se të themi se ekziston dashuria, ne duhet të kemi parasysh konceptin e dashurisë nga poeti i shquar modern, Lasgush Poradeci, i cili thotë: "Unë besoj në dashurinë. Më shumë më ka tronditur në jetë dashuria, më shumë më ka gëzuar dashuria." Dashuria për poetin Dervish Baba Meleq Shemberdhenjin është koncept bazë dhe tek ai ekziston që prej Zotit e më poshtë, por jo si koncept racional, sepse ai mund të kapet edhe me syrin e përbashkët të arsyes dhe zemrës. Këta sy ekzistencën e dashurisë e shohin si të vërtetë të pamohueshme, dashuria për Baba Meleqin është vet Zoti, Allahu, është bashkë me gjërat tjera, njëlloj si drita apo nuri, sepse është kudo dhe nuk mund t'i përshkruhet vendi, është mbi çdo gjë.

Pra të gjitha këto shprehje poetike: Zot i madh e i Vërtetë, jetë, dhenë, qjellë, hënë e djellë, yjet e retë, shiu e dhenë, lumenjtë e detërat, Ademi e Hava, Zeqirjai e Jahja, Merjemja e Isai në thelb prezantojnë njohje intuitive të dashurisë, njohje e thelbit të gjërave, gjegjësisht thelbit tokësore, qiellore, yjore. Poeti i cili ka arritur njohjen intuitive të dashurisë, zhvishet nga ekzistenca e tij dhe pastrohet nga unë i tij fizik. Por ky nivel mendor dhe

shpirtëror i njohjes intuitive të dashurisë nuk është i mjaftueshëm, sepse për të arritur përsosmëria më e lartë e dashurisë duhet të vendoset relacioni me pasqyrimin e cilësive qiellore, yjore, universale e fetare. Kjo shkallë lidhshmërie e dashurisë intuitive mund të emërohet ndritje e dashurisë. Kjo ndritje e dashurisë, krijohet me anë të përkujtimit dhe mallit ndaj bukurisë së Zotit, xhemalit. Si shembull, e kemi poezinë e Shej Malës nga Rahoveci, "Zemra daim vaj po ka", "Zemra daim vaj po ka./ për ty Allah ka sevda./nuk do qetër në dynja/ lyp xhematin tënd me pa. /Aman Allah hak mevla/ qyrma zemrën ç'a po ka./hiç prej ashkit s'mund m'u da /Lyp xhemalin tënd me pa"(Poezia e bejtexhinjve, Rilindja, Prishtinë, fq.400.)

Poeti Shej Mala dashurinë dhe bukurinë e zbulon me anë të intuitës, në botën e shqisave dhe prej kësaj ngritës në botën shpirtërore, ose prej botës fizike në botën e ideve apo shqisave shpirtërore (Xhemalit), atëherë është e arsyeshme që ky potencial do të kthehet në pozicionin prej ku ka ardhur. Dashuria është trajtë shpirtërore, në të cilën poeti si qenie shpirtërore, ndjek rrugën e njohjes së Xhemalit (Bukurisë) dhe nëpërmjet kësaj përpjekje të kapërcejë kufijtë e bukurisë fizike dhe të ngrihet në piedestalin e ngritjes shpirtërore. Dashuria ndaj Xhemalit paraqet përpjekjen shpirtërore të poetit, që ekzistencën e saj ta shpëtojë nga thundrat e egra dhe të ulëta njerëzore, për ta prezantuar në lartësitë e ndritura makrokosmike, gjegjësisht në botën e ndritur. Zemra e përvuajtur e Sheh Malës, është vendbanimi i dashurisë, zemra e tij prej ashkut nuk mund me u nda, është vend ku buron fshehtësia e dashurisë, ajo është qendër e njohjes së dashurisë.

KONCEPTET ESTETIKE NË POEZITË E BEJTEXHINJVE


Poezia për bejtexhinjtë llogaritet si brumë ku gjendet Zoti, ku gatuhet bukuria e kulturës islame, e artit, meditimit dhe dashurisë së fesë, gjuhës, popullit, por edhe të popujve në mes vete. Me shumë të drejtë kanë konstatuar estetët dhe kritika letrare, se definicioni i poezisë dhe artit në përgjithësi është ligj shpirtëror e hyjnor, i cili përcaktohet nga frymëzimi, që i dedikohet lumturisë dhe kënaqësisë së vërtetë njerëzore. Aristoteli poezinë e krahasonte me anë të karaktereve të veçanta të autorëve: autorët që kishin karakter të dobët, krijojnë vepra të dobëta, kurse ata që kishin karakter të lartë krijojnë vepra të bukura. E për karakterin, moralin dhe etikën e njerëzve më së mirë flasin poezitë e bejtexhinjve. Thuajse të gjithë këta poetë janë brumosur me virtyte të moralit shoqëror e fetar.

Studiuesi Mahmut Hysa në librin e tij: Alamiada shqiptare I, Logos-A, Shkup, 2000, fq. 149.) thotë se: "Muhamet Kyçyku është autori që moralin shoqëror e sintetizon me moralin fetar, është autor që mendon se të këqijat njerëzore mund t'i luftojnë edhe më me sukses njeriu që e ka të formuar vetëdijen fetare, njeriu që ka dituri nga dituria islame, njeriu që udhëhiqet nga konceptet morale-etike islame. "Arti është për një pakicë njerëzish, për një elitë të zgjedhur shpirtëror të lartë". Ndjenjat e bukura fetare, bashkë me dëshirat e thella shpirtërore ekzistojnë në njeriun që nga lindja, kurse njerëzit me botëkuptime të ulëta materiale dhe kolektive nuk kanë mundësi asesi të kuptojnë idealin e vërtetë të artit poetik.

Reflekse

BIOSEMIOTIKA

Lidhja e ngushtë midis jetës dhe perceptimit estetik dukshëm u dobësua, me tendencë të ndërpritet. Pra, nevojitet një teori për përforcimin e relacionit art - realitet empirik



Afrim REXHEPI

Në shek. 21, estetika pretendon të bëhet disiplinë më shumë se filozofia dhe teoria për të bukurën dhe shijen. Realiteti fizik, problemet ekzistenciale, ishin baza e provokimit të pyetjes, Ç'kuptim ka ekzistenca në kohën tonë? Një lidhje midis artit dhe jetës është interaktive, sepse në kohën e zhvillimit të shkencës kuptimi për jetën është esencial. Kanti, përmes kritikës së gjykimit, estetikën e kthen në gjykim universal. Mario Perniola definon: "Me Kantin qenia njerëzore është e lumtur, sepse përmes gjykimit universal, gjykon realitetin empirik". Lidhja e ngushtë midis jetës dhe perceptimit estetik dukshëm u dobësua, me tendencë të ndërpritet. Pra, nevojitet një teori për përforcimin e relacionit art - realitet empirik. Teoritë për formën, në vete ngërthejnë problemin e definimit të formës. Në kuadër të një termi qëndrojnë dy nocione që për grekët e vjetër semantiki ishin të ndara. Eidos (struktura e formës) ishte formë intelegibile, kurse morphe (perceptimi i formës) ishte formë sensitive. Teoritë estetike të shek. 20, në mënyrë të ndryshme e kanë interpretuar formën: Velfin - joformëzimi; Rigël - forma artistike; Varinger - stili joorganik etj. Teoria e dekonstrukcionit, përmes nocioni dallim që lidh, zgjidh dilemën e estetikës së shekullit 20. Desubjektivizmi i emocioneve të Frojdit, shkatërrimi ontologjik i strukturës së qenies të Vitgenshtajnit dhe Hajdegerit, e deri te proceset teorike dekonstruktive: psikike / fenomenologjike - empirike / fiziologjike të Derridasë. Gjykimi i Kantit, pathosi i Hegelit, më nuk janë në funksion. Në funksion estetik janë konceptet teorike të Lusi Irigarit dhe të Zhak Derridasë, të cilët flasin për përjetimin që nuk mund të kapet përmes shpirtit, por që përjetohet nga jashtë edhe atë te gjërat të cilët vetë-përjetojnë. Në prag të shekullit 21, estetika fiziologjike është në funksion.

Kah fundi i shekullit të kaluar dhe fillimi i shekullit të ri, subjektivizmi transcendent i Kantit do të ripozicionohet nga Gilles Deleuze (1925 - 1995), themelues i materializmit të ri - ontologjitet e orientuara nga procesi, teoria e afekteve dhe realizmi spekulativ - ontologjitet e orientuara nga objekti, përmes kompleksitetit të empirizmit transcendent. Sipas subjektivizmit

transcendent të Kantit, koha dhe hapësira janë forma apriori të ndjesive, pra nuk janë veti të objekteve në vetvete, por janë cilësi të strukturës subjektive. Dallimi është se Deleuze kërkon gjenezën e formave apriori të ndjesive për të shpjeguar se si krijohen këto struktura të përvojës, pasi ato nuk mund të krijohen, siç mendon Kanti, nga asgjëja. Ky është thelbi i temës së empirizmit transcendent të Delezit. Ai thekson konceptin e zhvillimit të biosemiotikës dhe se lëvizja jetës në kohë bazohet tërësisht në evolucionin e ndjeshmërisë ndaj shenjave. Mbijetesat varet nga një ndjenjë e caktuar e vazhdimësisë hapësinore dhe rregullimit kohor. Ndjenja e rendit ripërpunohet vazhdimisht. Asgjë nuk vendoset paraprakisht, përkundrazi, del nga fuqia universale për të gjeneruar dallime. Bota, pra, përbëhet nga marrëdhëniet midis këtyre dallimeve. I gjithë kozmosi duket se karakterizohet nga ekzistenca e ripërtëritjes së përvetshme.

Modeli i empirizmit transcendent të Delezit, krijohet në rrafshin e imanencës, në të cilin përjashtohet çdo lloj transcendence. Rrafshi i imanencës nuk është një koncept që mund të mendohet, por është imazh i mendimit. Një shembull tipik i empirizmit transcendent të Delezit është mendimi i tij, se ai nuk e sheh objektin fizik në tërësinë e tij, ai e sheh objektin fizik vetëm si një formë, dhe forma është vetëm një aspekt i objektit, është pjesë përbërëse e saj. Ai percepton intensitetin e formës, percepton forcat termike të formës, sasinë dhe cilësinë e formës etj. Sipas tij, imanenca nxit gjykimin se planeti tokë është i sheshtë dhe jo sferik. Toka në mënyrë paradoksale mendon, toka nuk është ky planet, nuk është toka në të cilën qëndrojmë, apo konceptualisht toka si territor etj. Toka është ajo që është. Përtej fuqive tona empirike, ne nuk mund të mendojmë për të, por ajo imponohet dhe na mundëson konceptualisht të mendojmë për të. Rrafshi i imanencës nuk është një koncept, diçka që mund të mendohet, por një imazh i mendimit. Pra, empirizmi transcendent i Delezit është post-darvinian në kuptimin që evolucionin i specieve nuk është vetëm evolucionin i një forme të re të jetës, por edhe evolucionin i një forme të re të ndjesisë.

Në librin Çfarë është filozofia?, Deleuze dhe Guattari, e përkufizojnë artin si një

bllok ndjesish, të përbërë nga percepte, afekte dhe imazhe. Nocione të tilla janë gjithashtu vendimtare për të kuptuar idenë e Delez për kinemanë dhe filmin, siç është përpunuar në studimet e tij Lëvizja - Imazh dhe Koha - Imazh. Sapo shfaqet, imazhi shkakton afekt dhe befasisht reagojmë fizikisht, kemi frikë, largohemi, shohim në imazh diçka që nuk i përket askujt, ndonjë cilësi, diçka të kuqe, diçka të shpejtë, ndonjë formë, etj. Perceptim dhe afekti, të kombinuara në një rrafsh të imanencës, nxisin një mendim të caktuar, dridhje, frikë, që organikisht nuk është e jona. Sipas Delezit, funksioni themelor i artit është të prodhojë "shenja" që do të na ripozicionojnë nga ligjësitë e tanishme të perceptimit. Në kontekst, Delezi citon Fransis Bekonin, "ne po kërkojmë një vepër arti që bën efekt në sistemin nervor, e jo në tru".

Delez thekson faktin që ajo që ka peshë në perceptimin thelbësor të formave është forca e formës, është intensiteti termik i formës, është inercioni, është graviteti i formës, janë të gjitha forcat e padukshme të formës të cilat përmes procedimit krijues "deformin i formës pa transformim", bëhen të dukshme. Pol Sezani ishte i pari që i bëri deformimet e duhura pa transformim, duke e mundësuar kuptimin të bie përsëri në objektin e njëjtë. Linjat e forcës të cilat kalojnë në lëvizje, bëjnë që forma, ndonëse pak e trazuar ose e deformuar nga forcat e presionit, të shfaqet shumë herë më e thellë dhe më e qartë. Enumeracioni i forcave, pasqyrimi i padukshëm i forcave, deformimet të cilat nuk kalojnë as në transformim e as në dekompozim, kthimi i forcave të dukshme të formës, janë referencat e estetikës së Delezit për të cilin vepra e artit është estezis. Kështu të paktën mendon Delezi dhe definon: "Në artin, nuk është i rëndësishëm riprodhimi apo shpikja e formave, por kapja e forcave. Për këtë arsye asnjë art nuk është figurativ. Detyra e pikturës është përcaktuar si përpjekje për t'i kthyer forcat e dukshme të cilat në vetvete janë të padukshme. Ashtu sikurse muzika përpjeket t'i kthyer forcat e tingullit që në vetvete nuk janë tinguj". Njëri nga filozofët e shquar poststrukturalist, Zhak Ransjer, thekson, "Delez përmbushi fatin e estetikës, duke e realizuar forcën e veprës së artit në shqisë të pastër. Ai arriti koherencën e kthesës së tij antilogjike".

KAFE ME NËNËN

Frynte një erë plakë në vjeshtë që po lindte
 Është ditëlindja e Irfanit të vrarë para njëzet vjetëve
 gjethet e pjergullës bien
 mbi flokët e zbardhura të nënës
 ajo nuk sheh mirë
 nuk dëgjon mirë
 jemi vetëm në mes të parajsës së djegur
 derisa ajo në kujtimet e saja gatuante bukë për babain tim
 për mua dhe për veten
 në Tiranë në banesën e Martin Cukallës
 unë pija raki Skrapari me Nexhat Dibrën

Piku një mollë dhe e theu heshtjen
 Bir
 pse disa viteve u mungojnë muajt
 Rashë nga qielli i shtatë
 në këmbë
 si mace që i kishte mbetur vetëm një shpirt
 Nga molla e rënë doli një krimb si derr i luftës
 që e kishte majmur liria

Pije kafënë nënë
 pije
 janë vite të krimbura

KUR FËMIJËS I THINJEN FLOKËT

Një kali hingëllinë
 brenda ëndrrës së një fëmije
 vrapon nga një skaj në skajin tjetër
 si i harbuar
 dhe ndalet
 vetëm kur fëmijës i thinjen flokët

Është natë
 ca gjethe vallëzojnë pa pikë shpirti në ajër
 një erë e lehtë
 por e ftohtë
 ia kreh flokët nënës së tij

FJALËT KANË SHPIRT

Fjalët kanë eshtra
 mish
 dhëmbë
 shpirt
 Kështu që
 nuk e kuptoj poetin
 që sillet si këngëtari
 para një publiku të shurdhër
 e që bile nuk e kafshon buzën
 derisa ta përgjak

KOHË E PISTË

Në atdheun e shndërruar në shportë mbeturinash
 njerëzit i hedhin ditët pa punë
 netët pa gjumë
 ëndrrat e vdekura
 dashuritë e vyshkura
 vitet e kalbura që u kanë mbetur
 nga jeta e tyre e vetme
 sikur të ishin mbeturina të darkës së fundit

Një burrë
 si kafshë e detyruar të jetojë në errësirë
 me dekada
 me fytyrën si dikush që do të vdiste pas dy dite
 gruan nga portreti i varur në murin e mykur
 me zë të mbytur e pyet
 se si quhet
 Me dorën e shtrirë të lypësit
 i kërkon pak emocion
 ia premtton një kështjellë prej zalli

Akrepat e orës në dorën e vajzës brenda portretit
 filluan të lëvizin
 Është e mahnitshme
 se sa larg mund të arrijë
 dashuria njerëzore
 edhe në kohë të pista

DISA PËLLUMBA

Nuk jam duke u munduar
 ta ndryshoj botën
 me asnjë poezi timen
 unë vetëm përpiqem si
 ta zëmë
 këtyre pëllumbave
 të vizatuar në fletore fëmije
 apo këtyre të tjerëve
 që dikush i ka krijuar
 prej balte të pjekur
 apo prej plastike
 t'u jap shpirt
 t'i emëroj
 dhe t'i lëshoj të fluturojnë
 të lirë
 nëpër hapësirën e vdekjes

ME NJË FËMIJË NË VALIXHE

Me një fëmijë dy vjeç në valixhe
 një burrë e një grua e kapërcejnë kufirin
 ilegalisht

Pas tetë dekadave
 fëmija
 tashmë i vdekur
 do ta kalojë po atë kufi në arkivol
 legalisht
 apo
 i vdekur do të ecë me këmbët e tij
 deri te varri i vet
 në dhë të huaj
 dhe para Zotit do të paraqitet
 me mallin për atdheun
 që kurrë nuk e desh

NË DETIN LAKURIQ

dita e parë

fluturoj me aeroplan
ulur jam skaj dritares
njërin sy i lëshoj tokës
tjetrin qiellit blu
pas meje një udhëtar vetëm lutet

kur vështroj jashtë
më bëhet se shoh zogjtë e bardhë
tuba-tuba
që kanë humbur rrugën

po
ata udhëtonin
kërkonin dashurinë e humbur
n'atë dimrin e zi përplot borë

tri orë më vonë zbres që ta prek detin lakuriq
edhe gratë e veshura me diell
pardon
me krem për mbrojtje nga dielli

pa pritur një grua
zhvesh lëkuren para syve të mi
s'pata guxim të flas me të
as ta prek me dorë

dita e dytë

e vara këmishën
në degët e qiellit blu
zinxhirin e spirancës në sukën që fle

peshqit me sy qershie
më shikojnë plot butësi

rri përballë kofshëve të skuqura
dhe gjoksit të ndezur të një gruaje
që më ngjante në pjeprin e djegur n' diell

jam në luftë me peizazhin
më pulëbardhat që më buzëqeshin

e dija se do të më zinte gjumi shpejt
deti lakuriq qepallat m'i mbylli

dita e tretë

shtëpia ime është në fund të katundit
e katundi është larg nga këtu

aty i kam fshehur kujtimet
të shpëtojnë nga sëmundjet

kam fshehur aty
një mollë dhe një ftua të kafshuar

me trastën në shpinë e kërkoi rrugën e katundit
në detin lakuriq asnjë shenjë s'e gjej

të gjitha rrugët tashti i shoh
si tufë zogjsh në fluturim

kam mbetur duke i shkundur kokrrat e kripës
që e kanë terur lotin e syrit

dita e katërt

një i moshuar vdiq
në detin lakuriq

u mblodhën njerëzit
ta shikojnë si instilacion arti

kritikët që erdhën me vonesë
thanë e paska pi detin

një fëmijë i pasherr
e pshurri instilacionin
nuk e kuptonte idenë e autorit

në St. Petersburg e lajmëruan popin
të bëhej gati për ekspozitën e radhës
se një qytetar i tij kishte vdekur
nga vezët e peshkut

dita e pestë

në detin lakuriq shoh një bahçe
e shumë molla sherbete

shoh peshqit që bëhen gati t'i kafshojnë

nga merakun që s'mund t'i arrijnë
dridhen si gjethi në zjarr

kur e panë pjatën që i priste
vdiqën brenda vetes

eh a ja vlen të vdiset
për dy kokrra mollë

dita e shtatë

në ishullin idiot
në rërën e nxehtë
një virgjëreshë sapo bëhet gati
ditët e zeza t'i mbyllë në det
t'ia prishë kodin lakuriqësisë njerëzore

pasi u la lakuriq gjithë natën në det
virgjëresha u pastrua
nga mëkatet që ia kishte shkaktuar
një qen rrugaç

dita e dhjetë

është fillim shtatori
në relievin e rërës
njerëzit po ua prishin qetësinë peshqve
duke u përpjekur ta mësojnë gjuhën e tyre

në syrin e qelqtë të peshkut
asnjëherë nuk do të dimë
cila është ëndrra më e bukur e tyre

çdo ëndërr
është vetëm një herë e njëjtë

DHE MBI TOKË, DHE NËN TOKË

Bajram SEFAJ

"Rrini të qetë, në ferr ka vend për të gjithë dhe nuk ia vlen të bëni në garë kaq të ashpër, për të treguar se cili është më i poshtër se tjetri!" - F. Dostojevski

Për të vdekurit, është fjala. Veçmas për ata, si puna ime që, në gjallje mbi tokë, si të kishin qenë nën tokë. Kur në jetën e gjatë e ngratë, gjallëronin mbi tokë, jeta ndaj tyre tregohej kurnace, e egër, e pamëshirshme, e pashpirt, idhnake dhe mizore..., nuk u jepte pothuajse asgjë. Nuk u dhuron asnjë kacidhe, asnjë të mirë, e vlershme, ndërkaq, as ata, nga ana e tyre, jetës së atjeshme, éternele, (i thonë francezët asaj jete atje), pra, jetës së nëndheshme, të gjatë e të ngratë, kur të gjitha qeniet njerëzore, njëherë mirë, janë të barabarta, janë të barabarta sepse janë të vdekur, në e mirë kjo universale, barazie!

Padrejtësitë e kësaj bote në jetë, dallimin midis të pasurve të varfërve, shlyen e asgjësohen përgjithmonë!

Mendo(ni) mirë. Mendo(ni) e vraje(ni) mendjen. E vë(ni) gishtin mbi tëmth: kjo çështje kaq serioze, lë të vihet në peshojë (në kandar, pse jo!) mund të zgjasë edhe për vetëm për pak çaste, deri sa të kryhen

ceremonitë tradicionale të varrimit. Në varrimin e pasanikut, mund të ketë më shumë pjesëmarrës. Të veshur me rroba të zaza, kat e krevate (costum cravate), mund t'ia krisin një a më shumë fjalime lamturnirës, të sheqerosura me fjalë të ëmbla, herë-herë të gemta. Mashtroese. Shtriganë!

Shumë nga oratorët, sidomos ata që janë të vijës së ngushtë të përmes familjare, vëmendjen me shumë e kanë të përqendruar në përmbytjen e testament, të ngujuar atje në dollap apo në barkun e kasafortës, se sa në fjalët boshe të folësit të radhës. Dekiku i fundit të jetës, soset, s'ka më, përfundon Ndoshta vazhdon edhe për pak çaste. Të pasurit, rrugën e fundit, nga vendbanimi deri të Varrezat, kur është edhe vendbanimi tyre, i fundit, si për çdo kënd, mund të bëjnë mbi dilizhanëse, karroca, automjet të shtrenjtë, ndjekur nga kolona e gjatë e automobilave po ashtu, të shtrenjtë, vezullues, të porsa ardhur nga një botë tjetër e largët... *

Mirë u bë, fort mirë u bë, kur qielli u hallakat, u shkund e, s'dihet nga cili kat i tij, u shpalua kjo porosi gatuar, përmbledh e stampuar në paftë të bardhë...

Aq shumë u gëzova dhe u lumturova sa, akoma pa e lexuar mirë, me nguti e vura nën nëntitull, thua se ekzistonte rreziku (i zi) se do ma vidhte ndokush... I thash vetmisë time memeece, u be fort që hasa në këtë porosi, nga kushdo që vjen, mirë se vjen e, aq më parë, kur vjen nga mendja e ndritur, e një shkrimtari kreativ e me nam botëror. Po, kjo ore mik, s'është tjetër pos dhuratë e perëndisë (fr: cadeau de dieu!). Dhuratë e ndarë në dy pjesë, ama. Pjesa e parë, e mira: se me erdhi në një çast kritik, kur u rroka, fyt për fyt, me një temë misterioze, të ngatërruar e të mykët që, kurrqysh t'ia zë petën e rrëfimit, duke që luajtur kështu, rrolin e një të dështaku i maniak, kur me meditimet, refleksione dh broçkulla e tij kësodore të vyshkura e bajate, mundon vetën dhe të tjerët. U sorollatura andej këndeje, u solla e pështolla, si pordha nëpër të linjta, siç thotë populli ynë (përjetësisht i vuajtur) e, në vend së t'i bie shkurt e trup e shqip: të them atë që synoja (vdiasja) ta thojta: vdekja, çasti i ndërrimit jetë, shuarja a ikja nga kjo botë, automatikisht shlyen e asgjëson krejt, dallimet midis të pasurve dhe të vobektëve. E mira, pra, e porosisë, si e porositur, që befasisht zbriti nga pala

e shtatë e qiellit, ishte ngase, aty për aty, ndërpreu e preu, fluturimin tim imagjinari e të kotë fare. Në porosinë të madhit fisnikut Fjodor, nuk e gjeta atë që synoja, atë që shpresoja se do ta gjej. Nuk rrihim dot të njëjtin thumb. Nuk i binim e dridhim të njëjtin tel. Shkrimtari mirënjohur, kishte problem më të lehte dhe më kollajshëm së unë, si marrës i porosisë: "Rrini të qetë, në ferr ka vend për të gjithë dhe nuk ia vlen të bëni në garë kaq të ashpër, për të treguar se cili është më i poshtër se tjetri!" - F. Dostojevski.

* Në këtë botë të mbidheshme, numri i të poshtërve, në mënyrë rapide e pandalshme, marramendëse, shtohet përditë e më tepër, sa që, menjëherë e pa hezitimi, mund të shkrepë urdhri: të ngritët një aneks Ferri, shumë herë më i madh se që është ekzistuesi vetë!

Me porosi e nisa, me porosi, po e përmbaroj kë copë hall që me solli dhimbje të madhe, si të pashërueshme kurrë. Paulo Coelho, porosite: "Gjej dikë që të bën të qeshësh, sepse mjafton një buzëqeshje për të bërë rrëzëlluese një ditë të zymtë!".

Gaillard, 02/04/2023



QENI QË DONTE TË BËHEJ NJERI

Augusto MONTERROSO

Ka ca kohë që në shtëpinë e një tregtari të pasur në Meksiko, e pajisur dhe e stolisur me të gjitha orenditë dhe aparatat më të fundit, jetonte një Qen. Papritur e pa kujtuar, këtij Qeni të uruar ia shkrepë në tru të bëhej njeri dhe, për ta realizuar këtë ëndërr, iu fut punës derreç.

Në krye të disa viteve, pas një këmbënguljeje prej mushke, arriti t'ia dalë mbanë. Pra, gjithë përpjekjet e tij të mundimshme u kurorëzuan me sukses: me lehtësinë më të madhe filloi të ecte vetëm mbi dy këmbë. Kështu që e ndjeu veten se ishte tamam një qenie e vërtetë humane.

Tani, as për të kafshuar nuk kafshonte më si qen, vetëm se: sa herë që takohej me ndonjë të njohur, sidomos me ata që i hidhnin diçka për të ngrënë, bishtin e tundte fort; sa herë që do të shtrihej për gjumë, do t'i bënte nja dy-tri rrokullisje në kurriz; sa herë që do të dëgjonte kambanat e kishës, do të gërnjapset e do të jargavitej; dhe natën, sa herë do të shikonte hënën e plotë, do të hipte mbi ndonjë gur a mur e do të kuiste përvajshëm. (Në shqip: Bajram Karabollli)

PRERËSI I KOKAVE

Jorge Luis BORGES

Askush nuk e kujton më djegien e kishave, as vrasjen e Huan Duartes, i ekzekutuar me urdhër të Peronit. Unë nuk mund të flasë me paanësi; ime më, ime motër dhe im nip kanë qenë burgosur. Mua më sikterrisën në një vend koti, bibliotekar në rrethina. Një dedektiv nuk më ndahej kudo që shkoja. Më në fund, u miqësua me mua dhe më tha: «Më fal, Borhes, por unë dua të fitoj bukën e gojë». Atëherë, për ta ngushëlluar i tregova se im atë kishte njohur një ushtar të vjetër që kishte qenë prerës kokësh i të dënuarve me vdekje. Ishte një njeri i mirë që kryente detyrën, duke vepruar përherë në të njëjtën mënyrë. Të dënuarit, me duart të lidhura prapa kurrizit, uleshin në tokë. Ky xhelat u afrohej, miqësisht, u rrihte shpatullat me pëllëmbë dhe u thoshte: «Kurajë, miku im. Ta dish se më shumë vuajnë gratë kur lindin fëmijën» Pastaj, vetëm me një të rënë të shpejtë u priste kokën. Me sa duket ishte pothuajse e pandjeshme... (Në shqip: Bajram Karabollli)



Astrid Lindgren, shkrimtarja e Pipi Çorapegjatës

E DASHUR, E KËRKUAR, E PËLQYESHME, E ÇMUAR...

Shfaqja e një Pipi si personazh ndryshe përmes aventurës krijoi një figurë dhe univers të ri të panjohur të botës femërore që nuk ishte dukur më parë

Xhahid BUSHATI

Shkrimtarja e shquar suedeze Astrid Lindgren na dhuroi një personazh si Pipi Çorapegjata, që u bë i dashur dhe "pronë" e shumë fëmijëve të rruzullit tokësor.

A ishte shkrimtarja që i dha famën Pipit, a ishte Pipi që i dha famën shkrimtares? Një pyetjeje të tillë, asnjëherë nuk mund t'i jepet një përgjigje e saktë. Por disa të vërteta që i marrim vesh gjatë optikës së leximeve, është e udhës t'i pohojmë, si: talenti dhe magjia Lindgren, përkushtimi dhe njohja në thellësi e botës së fëmijëve, dashuria deri në dhembje për shpirtin e tyre, shpirt të cilin e mbron, e shpirtëzon, e respekton, i jep hapësirë, fluturim ëndrre, kulturologji dhe liri (në kuptimin e meritueshëm të këtyre fjalëve), etj.

Astrid Lindgren dhe Pipi Çorapegjata u bënë të lexueshëm e të admirueshëm për fëmijët. Përjetësisht zunë vend në bibliotekat e tyre, si gurë të çmueshëm. Për t'u mos u plakur!

Shfaqja e një Pipi si personazh ndryshe përmes aventurës krijoi një figurë dhe univers të ri të panjohur të botës femërore që nuk ishte dukur më parë dhe të çuditshëm, debatues dhe mosbesues, skeptikë, etj., në përballje me studimet që ende jetonin të formatuara e të ngurta nga disa studiues të kësaj letërsie. Autorja krijoi një personazh, veç të tjerave, u bë edhe model imitimi në jetën e përditshme nga bashkëmoshatarë të Pipit, por që kapërceu edhe shekullin e saj.

Në këtë libër ne njihemi me një vajzë të çuditshme, gati me pamje kllouni, qukse, me bishtaleca si shtupa, me gojë të madhe që vazhdimisht zgërdhëhet vesh më vesh, me këpucë të mëdha dhe me çorape të gjata, njërin të zi e tjetrin bojë kafe. Po kaq të çuditshme janë edhe sjelljet e saj. Ajo vazhdimisht fantazon për njerëz e popuj të jashtëzakonshëm. Sipas rrëfimeve të saj njerëzit në Egjipt ecin mbrapsht, në Indokinë vetëm me duar, kurse në Kongon Belge nuk gjen një banor të vetëm të thotë të vërtetën. Kjo vajzë është vetëm nëntë vjeç, por ka një forcë të jashtëzakonshme, ndeshet me policët, mund vjedhësit, del më e fortë dhe më e shkathët se mjeshtrit e sprovuar të cirkut. Edhe emri i kësaj vogëlusheje është po kaq i pazakontë e qesharak, e quajnë Pipi Çorapegjata (në gjuhën suedeze emri Pipi ka kuptimin e marrëzisë apo të çmendurisë).

Pasi mëson për suksesin e kësaj shkrimtareje, menjëherë të lind pyetja: Çfarë ka ditur Astrid Lindgreni të zbulojë në botën e fëmijëve, ç'gjë të veçantë fshehin rrëfimet e saj? Te Pipi çdo fëmijë gjen diçka nga vetja, nga dëshirat dhe ëndrrat që i gjallojnë thellë. Pipi nuk është ana e dukshme e fëmijëve, por fantazia e tyre. A nuk janë fëmijët që mendojnë se pas çdo kaçube apo gardhi fshihet diçka që vërtet mund t'ia vlejë? Kështu Pipi bëhet zhbiruese, eksploratore që ndërmerr ekspedita të mëdha në një hapësirë tepër të vogël. Çdo fëmijë dëshiron të jetë i guximshëm, sypatrembur, i jashtëzakonshëm, dhe Çorapegjata është e tillë, ajo vë në lojë policët e ndeshet me ta, kap hajdutët e rrezikshëm, i tall, i flak majë dollapit dhe, si shpërblim për argëtimin që i dhuruan, u fal nga një monedhë ari. Çdo fëmijë i ka zili mjeshtrit e cirkut, po quksja e vogël ua kalon atyre pa ndonjë mundim të madh. Në vend që të jetojë një spektatore e urtë, ajo korr duartrokitjet e publikut. Atë askush nuk e

detyron të shkojë në shtrat kur vjen ora e gjumit, punë kjo e prindërve, që çdo fëmijë ia sjell në majë të hundës. Ajo është vetë kuzhiniera, gatuan ç'të dojë, si t'i mbushet mendja dhe ha pa orar. Në faqet e këtij libri ne shohim një botë ku të rriturit ose nuk ndërhyjnë ose nuk duken fare, një botë ku shumë mirë mund të jetohej pa tutelën e tyre.

Veç Pipit në hapësirat e librit njihemi edhe me dy fëmijë të tjerë, me Tomin e Anikën. Atyre u pëlqen aventura, por janë më se të zakonshëm, u binden prindërve dhe rregullave që ka vënë shoqëria. Kështu lexuesi kurrsesi nuk e identifikon veten me çamarroken Pipi, me gjithë gëzimin që u sjell ky personazh.

Në vetvete fëmijët kurrsesi nuk mund të jenë Pipi, Pipi është ajo që ata dëshirojnë të jenë. Pamjen e saj të jashtme asnjë fëmijë nuk do ta pëlqente për veten e vet. Të vegjlit i mrekullon forca e shoqes së tyre, sepse ky është një mjet që të siguron pavarësinë, por është i pamundur, se një fëmijë nuk mund të jetë kurrë më i fortë se një i rritur. Po kështu Pipi Çorapegjata ka një valixhe të madhe plot me monedha ari, ajo blen gjithçka dhe sa të dojë, gjë që ngelet në kufirin e ëndrrës.

Pipi të zbavit me pikëpyetjet që u vë rregullave të të rriturve, të cilat sikur janë krijuar enkas për të kufizuar lirinë e fëmijëve. Ajo bën ato që do t'i pëlqenin çdo fëmijë, kacavaret nëpër pemë, lëpin kremën e pastave, ha shumë ëmbëlsira dhe trillon me një fantazi që është për t'u pasur zili. Tomi dhe Anika krijojnë një raport të drejtë me figurën e saj. Ata nuk kanë se si të jenë si ajo, por, brenda së zakonshmes së tyre i pëlqejnë e i duartrokin aventurat. Pipi është dëshira e çdo fëmijë, por kurrsesi realiteti. Ajo i bën fërtele moralizimet, nuk do t'ia dijë për to. Kurse dy fëmijët e tjerë as që guxojnë ta çojnë nëpër mend këtë gjë.

Në fund të librit të tretë Pipi vendos të mos rritet, dhe kjo është bindëse se ajo është krijuar si një ëndërr nga fantazia e një fëmijë dhe dëshiron të ngelet gjithmonë e tillë, një çupëlinë çamarroke dhe e jashtëzakonshme.

Ku është merita e autores që ia arrin një gjëje të tillë?

Merita e saj më e madhe është se ajo botën në krijimtarinë e saj e sheh dhe e percepton nga brendësia, nga brendësia e botës së fëmijës. Ajo në krijimtarinë e saj nuk e sheh as nuk e percepton fëmijën me sytë e botës e të parë nga jashtë, por nga brendësia e botës së fëmijës. Duke hyrë në këtë botë Lindgren diti t'i hetojë të gjitha të metat, devijimet, prapësitë, shablonizimet bajate dhe mangësitë e jetës përgjithësisht. Shkruan për fëmijën në familje, në shkollë, në shoqëri. Në krijimtarinë e saj fëmijën dhe as botën përgjithësisht nuk i sheh me sytë e një të rrituri, por me sytë e botës së brendshme të fëmijës. Fëmijën e sheh me sytë e fëmijës. Ëndërrën e fëmijës e sheh me sytë e ëndërrës së fëmijës. Dëshirën e fëmijës e sheh me sytë e dëshirës së fëmijës. Fantazinë e fëmijës e sheh me sytë e fantazisë së fëmijës. Imagjinatën e fëmijës e sheh me sytë e imagjinatës së fëmijës.

Pikërisht një qëndrim i tillë, një qasje e tillë në krijimtarinë e saj, Astrid Lindgrenin e bënë aq të dashur për lexuesin, aq të kërkuar për fëmijën, aq të dashur, aq të pëlqyeshme dhe aq të çmuar në fushën e letërsisë për fëmijë përgjithësisht.



FJALA PO PËRËPËLITET NË AGONI

Këto të vocklat e të brishtat fjalë, na ngrenë moralisht. Na udhëheqin e na shtypin. Shuajnë luftërat, shkaktojnë debate, i zmadhojnë gabimet, e nxjerrin në shesh të vërtetën.

Hart WEGNER

1.
Para shkrimtarit ishte rapsodi. Para fjalës së shkruar ishte fjala. Përpara gjuhës, poezia e cila na bëri të besojmë që fjala fare mirë mund të jetë edhe send. Poeti filozof Francis Ponzh u mor një jetë të tërë për të zbuluar lidhjet e thella ndërmjet fjalës e sendit. Vepra e tij kryesore, e përbërë nga një poezi relativisht e shkurtër "Le Pré"- shtypur në letër bojëkafë që t'i ngjasonte ngjyrës së tokës nga e cila rritet ky livadh letrar - dhe nga shënime, pjesë ditarësh e variante të ndryshme të kësaj poeme të mbledhura në librin *La Fabrique du Pré*, është prova më e pakundërshtueshme në mbrojtje të fjalës. Fahnestoku përshkruan procesin krijues të Ponzhit me fjalët deri në atë shkallë, sa ato u ngjasojnë sendeve. "Kuptimet e njëpasnjëshme u japin fjalëve épaisseur-in e tyre, një densitet fizik, por veçanërisht një thellësi semantike. Épaisseur krijon një materie, që i bën fjalët drejtpërdrejtë të këmbësorë e si të barasvlershme me sendet, dhe jo thjesht simbole arbitrare siç mendojnë pasardhësit e lingvistit Sosyr. Duke lexuar shënime të hollësishme gjatë katër viteve që punoi mbi shtatë faqet e *Le Pré*-së, ne mund të ndjekim procesin krijues të shtresëzimit të fjalëve me kuptime e shoqërizime të shumta, derisa ato shndërrohen në sende, "fjalë-si-të-jenë-sende." Prosesi krijues i Ponzhit nuk qëndron në transferimin e natyrës në letër, por më tepër në lindjen e natyrës nga letra. Ai flet për lëndinën sikur shpërthen nga letra, në ngjyrë të errët si të tokës. Fleta bëhet dhë, ndërsa poeti shkruan, "kjo fletë e bardhë duhet të na shpjerë menjëherë te një fletë tjetër, te dhéu ngjyrëkafë". Pikërisht prej kësaj letrë lind poema. "Në fletën e dhéut kafe kokrrizat e vockla të diturisë nxorën bisqe." Dhe nëpërmjet këtij procesi lëndina është shndërruar ose krijuar nga poeti. Askush nuk mund të hedhë poshtë fjalët e Novalis: poeti e kupton natyrën më mirë, sesa mendja e një shkencëtari.

Poeti amerikan Ricard Uilbër, dy herë fitues i çmimit Pulitzer, flet për ndikimin që ka pasur (sidomos *Le Parti pris des choses*) Francis Ponzhe për të, "duke ma përforcuar shijen për një saktësi konkrete në artin e të shkruarit."

2.
Vetë Rilke ka mësuar nga Rodeni dhe skulpturat e tij se si të përqendrohet në objektet e të krijojë poema, që të jenë jo vetëm shprehje të ndjenjave, por edhe sende konkrete. Në përpjekjet drejt një poezie sa më reale, Rilke krijoi *Ding Gedichte*, që gjeti shprehjen në *Poemat e reja*. Rilke, ashtu si edhe Ponzh, vite më vonë i lartësuan sendet e jetës së përditshme, duke krijuar fjalë-si-të-jetë një lulëkuqe, një gocëdeti apo një pyll me pisha. Sendet e poemave, si edhe fjalët që i përshkruajnë ato,, bëhen të rëndësishme. Toro shkroi në ditarin e tij se "rrënjët e fjalëve janë sendet", si një përmbyllje të atij pohimi të bërë disa vite më parë se, meqë të gjitha sendet janë të rëndësishme, edhe fjalët duhet të jenë të tilla. Shkaku pse duhet të shqetësohemi në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet fjalëve e sendeve, është fakti se shumë armiq kërcënojnë fjalën sot. Mungesa e vetëdijes për fjalën e shkruar, zëvendësimi i fjalëve me shkurtimet e numrat, mungesa e dëshirës për t'i



mësuar të tjerët, vetveten, puna e pakët që bëhet për të zgjeruar fjalorin vetjak, janë të lidhura me rënien e interesit për lexim. Dhe kjo s'ka ndodhur ngaqë fjala është zhdukur, përkundrazi, fjalët "janë me ne kudo. Në fshetësinë tonë erotike gjatë gjumit. Ne jemi shpesh më të vetëdijshëm për pështymën sesa për to, paçka se i përdorim më shpesh se edhe vetë këmbët tona." (*Hatitations*, 114) Pavarësisht natyrës së tyre të kudonodhur, ato na shërbejnë ashtu si vetëm fjalët mundet. "Këto të vocklat e të brishtat fjalë, na ngrenë moralisht. Na udhëheqin e na shtypin. Shuajnë luftërat, shkaktojnë debate, i zmadhojnë gabimet, e nxjerrin në shesh të vërtetën." Vlerësimi më i madh që i është blatur fjalës ndonjëherë, ndodhet në kapitullin e parë të *Ungjillit të Shën Gjonit*. Ai fillon me këto vargje të famshme: Në fillim ishte Fjala, dhe Fjala ish në Perëndinë, dhe Fjala ishte Perëndia. Po kështu ishte në fillim edhe me Perëndinë. Gjithçka është bërë me anë të Tij; asgjë s'është bërë pa Të. Në Atë është jeta; dhe jeta ishte drita e njerëzve... Dhe Fjala u bë mish, dhe jetoj mes nesh, dhe ne pamë lavdinë e Tij, Lavdia e të vetëm lindurit prej Atit, plot hir e të vërtetë. (Gjoni 1:1-4,14) Nuk është një çështje e besimit fetar, nëse dikush do t'i pranonte këto vargje si një shpërfaqje e madhësisë dhe rëndësisë së fjalës, qoftë ajo logos prophorikos ose logos endiathetos. Por kuptimi i vërtetë i fjalës Logos e shqetësonte studiuesin Faust, teksa përpjeqej të gjente përkthimin e saktë të fjalës, që të pasqyronte përpikëmerisht dramën kozmike të krijimit të botës, sesa thjesht atë të fjalës: E shkruar është: "Në fillim qe Fjala"/ Ja ngeca që këtu! Kush më jep ndihmë?/ Unë nuk mund ta çmoj kaq shumë Fjalën./ Pra, duhet ndryshe ta përkthej/ në më ndriçoftë Shpirti drejt e mirë./ E shkruar është: "Në fillim qe Mendja./ Peshoja mirë këtë varg të parë./ mos të nxitohet tepër pena! Mos është Mendja që i krijon të gjitha?/ Do t'ish më mirë: "Në fillim qe Forca!"/ Por edhe duke shkruar këtë

rresht./ E ndjej që s'do qëndroj këtu./ Më ndihmon Shpirti; tash e shoh të qartë e shkruaj i kënaqur: "Në fillim qe Vepra." Fjala për Shën Gjonin ka një domethënie të tillë, sa ai e përdor për ta njëjtësuar me Krishtin, por njëherazi ajo shërben për të siguruar identitetin e qenieve njerëzore. Në Librin e Shëmbëllimit të Jobit njëri nga zërat pohon: "E di Zot, që s'jam gjë veçse një fjalë." Nëpërmjet fjalëve, gjuha modelon identitetin tonë vetjak e shoqëror. Francis Ponzh duke cituar nga cogito ergo sum i Dekartit, shkruan: "Flas dhe ti më kupton, si rrjedhim, ne ekzistojmë." Ekzistencialisti Martin Haideger shikon në fjalët rrënjën "qenie" njerëzore ("Sein"). Novalis thoshte se çdo qenie njerëzore ka gjuhën e vet, pasi gjuha është shprehje e shpirtit. Por ajo mund të shndërrohet në një dizavantazh, siç e ka vënë në dukje edhe R. Bart: "Çdo individ është një i burgosur i gjuhës së tij." Si rrjedhojë, humbja e fjalës do të thotë humbja e identitetit njerëzor. Identifikimi i njerëzve me numra prej kohësh ishte konsideruar një shenjë barbarizmi. Në filmin gjerman pa zë *Variété* (A. E. Dupont, 1925) fokusimi i kamerës te numri i të burgosurit, luajtur nga Emil Jannings, nënvizon qartë poshtërimin e karakterit. Si një fantazmë e bardhë, numri 28 fillon të mbushë tërë ekranin, duke e shndërruar shpinën e të burgosurit ku ndodhej numri në një plan të parë filmimi, si të ishte portreti i Janningsit. Këtu numri është bërë thelbi i qenies të zvetënuar njerëzore. Në filmin e Stenli Kubrik "A Clockwork Orange" (1977), vuajtja e protagonistit, e huliganit Aleks, nis që nga çasti kur i caktojnë numrin.

Kryeroja: Ndodhesh ne burgun H. M. Parkmur. Qysh nga ky çast çdo njeriu do t'i drejtohesh me fjalën "zotëri." Emrin?

Aleks: Aleksanër de Large, zotëri.

Kryeroja: Sa të kanë dënuar?

Aleks: 14 vjet, zotëri.

Kryeroja: Krimi?

Aleks: Vrasje, zotëri.

Kryeroja: Mirë. Hiqja prangat, zotëri.


Ti tani je 655321 dhe mos e harro këtë numër.

Kohët e fundit, në kutinë time postare më erdhi një revistë. Për titull kishte një seri numrash: 89123, që ishte njëkohësisht edhe kodi postar i zonës sime. Poshtë numrave, me germa të vogla ishte shkruar, "Të krijojmë një komunitet, le ta nisim me banorët e kodit tuaj." Padyshim, popullsia e zonave të tjera do të ketë marrë revista të ngjashme (natyrisht, për titull duhet të kenë kodet postare të zonave të tyre!). Kësisoj, identiteti ynë do të jetë një kod prej pesë shifrash e jo p.sh. Xhon Dou, Sahara Avenju, Las Vegas, USA.

3.
Ne nuk po vajtojmë vdekjen e një fjale, por faktin që Fjala po përëpëlitet në agoni. Profetizuesit e idesë "se po i ikën koha fjalës e bashkë me të edhe gjuhës, ashtu siç e njohim ne", ka kohë që kanë vënë alarmin. Suzan Sontag ka trajtuar çështjen e të shkruarit mbi filozofinë në një epokë kur sistemet filozofike të së kaluarës janë shpërbërë. Ajo konsideron si më të shquar në stilin e ri të shkrimeve filozofike eseistin rumun E. M. Çoran, i cili shkruan në frëngjisht, por nën traditën e mendimit të filozofëve të rinj gjermanë, siç demonstron në "Aforizmat filozofike të Lichtenbergut", të Novalisit, të Niçes, në pasazhet e "Elegjitë e Duinos" të Rilkes, si edhe në "Përsiatje mbi Mëkatën, Dhimbjen, Shpresën dhe Udhën e Vërtetë" të Kafkës." Më 1956 Çoran profetizoi fatin e tmerrshëm të gjuhës, ndonëse, sipas tij, ka një dritëz të vogël shprese për një lulëzim delikat para fundit: "S'ka dyshim, ne jemi dëshmitarë të shpërbërjes madhështore të gjuhës. E ardhmja e saj? Ndoshta do të ketë ca impulse ndjeshmërie. . . Fati i saj mund të jetë edhe një agoni e shpejtë vdekjeje." Kur lexon pohimin e Çoranit, që thotë se kur dashuron një gjuhë, nuk është e ndershme ta mbijetosh atë, çdokush e ka të qartë se nuk ka mbetur asnjë rrugë tjetër për këtë dashnor të fjalës, veçse të hidhet mbi shpatën e tjetrit.

HERMETIZMI I ÇDO FJALE

Arti i vërtetë nuk është ai që shpreh, tregon, por ai që jep mundësinë e një shumësie shpjegimesh



(Hamdi) Erjon MUÇA

Shekulli i nëntëmbëdhjetë ishte dhe shekulli i revolucioneve dhe prehermetizmi ishte në fazat e veta më të përparuar, në mos, te disa poetë ndeshemi me hermetizëm të vërtetë. Dhe njëri prej këtyre është edhe Stefan Mallarme.

Me emrin Mallarme jam përballur për herë të parë në një libër me kujtime të Giuseppe Ungaretti-t; ishte i mrekulluar prej tij ndoshta edhe i influencuar nga ky lloj prehermetizmi i mugët, kaotik, jo i rrëmujshëm, por kaotik, pjellë e asaj perëndie prepagane, Kaosit, që kontrollonte gjithçka përpara se të shfaqej Kronosi, dhe që në vargjet e Mallarmes duket sikur rijeton. Pa u ringjallur; jeton si të mos ketë rënë kurrë.

Mallarme, përpos çdo lloj sfumature të mundshme, është babai i hermetizmit të vërtetë. Të paktën mua më është dashur ta lexoj në dy mënyra, pak a shumë siç thotë edhe studiuesja italiane, Luciana Frezza; Mallarme duhet lexuar edhe me gjaknxehtësi edhe me gjakftohtësi, larg çdo lloj paragjykimi të mundshëm. Në të dyja mënyrat e leximit përfton diçka nga Mallarme, dhe duke ia mbivendosur ndjesinë e gjakftohtësisë asaj të gjaknxehtësisë, mund të arrihet një lloj ndërveprimi me tekstin Mallarme-jan. E, ndokush mund edhe të thotë: eh sa kohë paske mor njeri, ne nuk kemi kohë ta lexojmë një herë dhe jo më dy herë?! Nejsë! Për të gjithë ata që nuk kanë kohë dhe që kanë dëshirë të vëzhgojnë përtej kuptimit tradicional të fjalës, punën e rëndë e bëra unë dhe kjo është ajo që unë kam vëzhguar.

Ah, edhe një gjë tjetër: mjaft nga miqtë e mi, kur kemi dialoguar për poezinë italiane, më kanë thënë se arrijnë të perceptojnë më mirë hermetizmin e Quasimodo-s se sa atë të Montale-s. Kjo ka dy arsye, e para ka të bëjë me gjuhën në të cilën lexohen këta autorë. Në gjuhën italiane, hermetizmi i Montale-s është shumë më hermetik se sa ai i Quasimodo-s, kjo ngaqë hermetizmi i Quasimodo-s nuk është hermetik i pastër, por i

kontaminuar. Kjo gjë ndodh edhe me Mallarme-n. Për shumë kohë ai është etiketuar si poet i zymtë, i pak kuptuar, i pakuptuar, kjo ngaqë në atë periudhë, askush nuk mund të hamendësonte në lindjen një stil të ri. Ndoshta, pikërisht, duke zbrëthyer artin Mallarme-jan, Ungaretti-it i lindi maksima e tij e famshme: Poezia është aty ku fsheh diçka. Për projektin tim, përpos se më duhet të merrem me ata poet që janë të drejtpërdrejtë, paraprakisht të hermetizmit, më duhet të gjej edhe poezi të shkurtra apo sonetet dhe kjo nuk është punë e lehtë, ngaqë në shekullin XIX poetët shkruanin tmerrsisht gjatë; edhe ata kishin më tepër kohë për t'ia përkushtuar shkrimin poezisë, edhe lexuesit për t'ia lexuar këto krijime të gjata.

Poeti e nis poezinë me vargun: Po të sjell të birin e një nate të Edomit!

Edomi ka qenë një mbretëri në jug të Izraelit dhe, sipas shkrimeve në librat e shenjta, duhet të ishin pasardhës të Davidi-t dhe Esae-s. Po pse të mos thoshte të birin e një nate të Izraelit, apo të Galileës. Jo, ai shkon pak më përpara në kohë, dhe kur thotë të birin, kërkon të thotë pjellën e një nate, dhe si themi ne, që të tregoj këtë histori duhet një natë dimri. Pra, poeti na thotë tërthorazi që po na sjell një përrallë apo histori, e lindur në një natë të Edomit; periudhë e pandriçuar mirë e njerëzimit; me pak fakte dhe ato pak janë shumë të dyshimta, kundërshtuese, më tepër të denja për botën e përrallave se sa të fakteve.

I zi, me flatrën e mpirë, gjakosur, ç'pendëzuar,
nga qelqi i përfakur prej esence erëzash dhe ari,
nga dritaret e ngrira, mjerisht! të errëta sërish,
agimi u zhyt përmbi kandilin engjëllor.

Më pas është kjo fjali e gjatë, i njëjti mendim, në formën e një strofe virtuale. Dhe, kur më sipër përdora fjalën kaotike si një veti e veprës Mallarme-jane, pikërisht këto lloje vargësh kisha në mendje.

Ngaqë poeti si fillim na paraqet të gjitha vetitë tija vizive ashtu edhe fizike dhe më pas na thotë se kujt i përkasin, dhe më pas akoma se çfarë ushtron, dhe në fund fare kundër kujt. Pra, agimi i njerëzimit nuk është aspak i ndriçuar, ashtu siç u munduan të na e paraqisnin utopistët dhe soc-realizmi i shekullit XX. Jo, ai është i errët dhe antikapat dhe me këtë mangësi të vetën, këtë cungësi, u mundua të futej në jetët e njerëzve, nga dritaret shekullore të ngrira dhe nga i ftohti dhe tymi i kandilave të besëtytnisë. Falë mugëtirës së mungesës së fakteve të pamohueshme, po lindet një histori moderne me ekstreme, kundërshtues të palëvizshëm dhe pranues të palëvizshëm.

Palma! dhe kur ia tregoj relikën
këtij ati orvatës i një buzëqeshje
armiqësore,
vetmia e kaltër dhe shterpë ka ngjethur.

Palma, në numrin shumë dhe jo si përcaktuese. Kjo fjalë më dërgon në oazat e pakta mes shkretëtirave, ku një dorë me palma mundohen të mbijetojnë dhe i bëjnë hije një pellgu me ujë; vetmi që rrethon pranë një pike shprese dhe kjo shpresë edhe vetë është e pashpresë, sepse nuk ka as prurje e as derdhje. Kjo është krijesa njerëzore, një grumbull palmash mes shkretëtirës. Dhe kur poeti, intelektual, mundohet t'ia zbulojë këtë relike të së shkuarës njeriut, ky sepse armiqësohet, sikur ngjethet nga një frikë e pakuptueshme. Sa bukur e mbyll këtë mendim. Vetmia e kaltër dhe shterpë ka ngjethur. Vetmia e qiellores me engjëj pa seks e tremb, por krahu e atyre që kundërshtojnë, mospranuesve të patundshëm kjo i nervozon, irriton, në një farë mënyre i ngjeth edhe ata. Ja pra se si poeti, i klasifikon të njëjtë si pranuesit pa kushte si kundërshtuesit e patutshëm. Janë të gjithë ca palma vetmitare, që i bëjnë hije pellgjeve të tyre të pashpresa.

O përkundës, me tët bij dhe pafajësinë
e këmbëve tuaja të ftohta, prit një
krijesë krupëse:

dhe zëri yt që ndjell klaviçembalë dhe
viola,

të shtypësh do të duash me gisht të
shqyer gjirin tënd

derisa të lindë gruaja në të këllptën
bardhësi

për buzë nga ajri i të virgjërës kaltërsi të
uritura?

Në mbyllje, Mallarme bëhet edhe më hermetik, kaotik, aq sa edhe ato dy mënyra leximi, që përmenda më lart, nuk janë të njafatueshme. Madje, edhe këtu ku shumë herë lexim më kanë çuar, nuk më kanë qartësuar plotësisht. Mirëpo, arti i vërtetë nuk është ai që shpreh, tregon, por ai që jep mundësinë e një shumësie shpjegimesh. Duhet t'i përngjasë krijesës njerëzore; të ngjashëm, por jo të njëjtë. Çdo individ me pretendimet dhe me dyshimet e veta, me këndvështrimin e vet dhe me ndjesitë e veta, në bazë të të cilave edhe e bukura, edhe e shëmtuara marrin subjektivitetin e pranuar. Në këtë mbyllje, duket sikur Mallarme i drejtohet edhe vetes, pra atij që po ia tregon këtë përrallë fëmijës së vet, por edhe atyre përralla treguesve, përkundësve, që shekulli pas shekulli janë munduar të përgjumin krijesën njerëzore. Me tët bij, thotë poeti; kjo ka të bëjë edhe me të presonalisht, pasi i vetmi fëmijë që i mbeti në jetë poetit ishte vajza, sepse djali i vdiq në moshë fare të vogël nga një sëmundje e gjakut. Ndërsa në dualizmin e vet, kjo përbën një

lloj provokimi, për të gjithë liturgjinë Hebraike që është mëma e besimeve monoteiste europiane dhe jo ku spikat pushteti i patriarkatit. Kjo botë, fajtoreshë në mendime, në besime, në bindje, është e pafajshme fizikisht, materialisht; sado të shpresojë apo jo në lartësi, këmbët i ka të mbështetura mbi tokën ku varroset, pra të ftohta, më pranë vdekjes nga ç'pandehim. Vetes, përkundësve, por edhe dëgjuesve, të përkundurve, poeti u thotë të dëgjojnë edhe këtë krijesë, krupëndjellëse; siç thoshte më vonë edhe poeti unë i madh, Migjeni: Far, e idhtë... far' e idhtë...- O njerz të bimë nga far' e ambël! Një të vërtetë, apo një të vërtetë të mundshme, por që për njerëzit, si rëndomtë ndodh, e vërteta, jo pak herë u ndjell krupën. Zëri prej tregimtarit, i rëndë, as me tonalitet të lartë dhe as me tonalitet të ulët, pra klaviçembal ose violë; kush studion muzikë e di mjaft mirë që viola për më tepër është ai zëri ndërmjetës, mes violinës dhe violonçelit. Ky tregimtar do stepet, pasi të ketë përthithur këtë histori vërtetësie, me gishtin e vet të shqyer, si vizion i gishtit të perëndisë që dhuron jetë, do mundohet, do shpresojë të krijojë një tjetër vërtetësi, por me një panjollësi të lëkundur, gjithnjë të etur, uritur, për apoteozat qiellore. Mirëpo, madhështia e poetit qëndron pikërisht te shenja e pikësimin. Ajo pikëpyetje në fund e bën më të rëndësishme krijesën e tij. Ia le në dorë lexuesit mënyrën se si dëshiron të sillt; do vijojë kacafytjet, pranimet dhe mos pranimet mbi disa histori të pafaktueshme apo do nisnin të kërkojnë shpjegime të reja.

Poeti i titullon këtë krijesë: "Dhunti e poemë". E duhet të kesh pikërisht këtë dhunti për të krijuar diçka që shkon përtej të gjitha pritshmërive. Hermetike në çdo fjalë, duke bërë, që edhe vetë gjuha, si formë shkencore, të mos ketë më atë saktësinë me të cilën jemi mësuar ta paragjykojmë.

DHUNTI E POEMËS

Po të sjell të birin e një nate të Edomit!
I zi, me flatrën e mpirë, gjakosur,

ç'pendëzuar,

nga qelqi i përfakur prej erëzash dhe
ari,

nga dritaret e ngrira, mjerisht! të
errëta sërish,

agimi u zhyt përmbi kandilin engjëllor.
Palma! dhe kur ia tregoj relikën

këtij ati orvatës i një buzëqeshje
armiqësore,

vetmia e kaltër dhe shterpë ka
ngjethur.

O përkundës, me tët bij dhe pafajësinë
e këmbëve tuaja të ftohta, prit një

krijesë krupëse:

dhe zëri yt që ndjell klaviçembalë dhe
viola,

të shtypësh do të duash me gisht të
shqyer gjirin tënd

derisa të lindë gruaja në të këllptën
bardhësi

për buzë nga ajri i të virgjërës kaltërsi
të uritura?

STAMBOLLI LETRAR

Tre shkrimtarëve në Turqi i bëhen dy pyetje: - Cili është libri (i disponueshëm në anglisht) që ngjall më së miri Stambollin? - Cila është një librari e preferuar në Stamboll?...

Buket Uzuner: Qyteti i dy kontinenteve

Janë të pakta qytetet në botë për të cilat janë shkruar romane, monografi, poema dhe kujtime të panumërta. Stambolli ka qenë gjithmonë një nga ato pak qytete që ka ndryshuar historinë njerëzore me përbërjen (entitetin) e tij multikulturor dhe pozicionin e tij gjeostrategjik. Stambolli është vend unik, duke qenë i vetmi qytet në botë që ndodhet në dy kontinente me një det që kalon nëpër të nga një ngushticë natyrore. Parapëlqej të zgjedh "Stambollin" e Orhan Pamukut: kujtimet dhe qytetin, teksa ai pikturon imazhet poetike të qytetit përmes kujtimeve dhe emocioneve të tij personale në një autobiografi të gjallë të guximshme dhe letrare. Ai flet për Stambollin e fëmijërisë së tij, në rrugët e pasme dhe rrugët ujore si të ishte një tregimtar përrallash; Pamuk tregon përrallat e shkrimtarëve të Stambollit Tanpınar dhe Yahya Kemal, si dhe atyre që kanë jetuar në Stamboll, si Floberi, Nerval, Lord Bajroni, Amicis dhe Kavafi me trishtimin (hüzün) e një parajse të humbur. Lexuesi e kupton menjëherë se Stambolli është edhe shtëpia e Pamukut edhe zemra e imagjinatës së tij. Unë kam shumë librari të preferuara në Stamboll. Siç e dini, Stambolli është i vendosur në dy kontinente, prandaj zgjidha dy librari, edhe në njërin edhe në tjetrin kontinent: Libraria Minoa (Şişli, në anën evropiane) është një librari e pavarur me një gamë të gjerë librash në anglisht dhe turqisht. Kafeneja e saj ka ëmbëlsira të bukura dhe kafe të mirë; Libraria Penguin (Suadiye, në anën aziatike) është një librari pesëkatëshe që ofron libra të



Buket Uzuner

megjithatë, kur libraria u zhvendos në Narmanlı Han dhe përfundimisht në Kalımın e Tunelit, ato shiten një gamë të gjerë librash të vjetër dhe të rinj nga zhanre dhe tema të ndryshme, si dhe gravura. Kam takuar pronarin nga brezi i tretë i familjes së tyre, djalin e kushëritit të tyre, Albert Sapan, i cili e trashëgoi librarinë së fundmi nga Samuel Sapan. Megjithatë kornizat e copëtuara prej druri të librarisë japin përshtypjen e neglizhencës, ajo pasqyron mishërimin e shpirtit të braktisur të pakicave të Stambollit. Me pak klientë brenda, sidomos sot, dyqani u reziston librarive të reja moderne pranë

inë e Motrave Cohen, ashtu si unë sot.

* Hebrejtë kanë jetuar në Spanjë që nga koha e Romës së Lashtë. Sefardik vjen nga fjala hebraike Sefard, që do të thotë, Spanjë. Në fillim kjo fjalë përdorej për t'u referuar pasardhësve të hebrenjve të Spanjës. Ata sot janë të shpërndarë nëpër të gjithë botën, në Izrael, Turqi, SHBA, në Amerikën Latine, Greqi, Bullgari, Francë e Britani e Madhe, mes të tjerash "Hebrejtë sefardikë" tashmë është një term me kuptim më të gjerë dhe përdoret për të identifikuar hebrenjtë nga Orienti, Azia apo Afrika.

(Poeti, përkthyesi dhe artisti vizual Erkut Tokman është anëtar i Shoqatës së Poezisë së Shkrimtarëve të Mërguar, si dhe i PEN-it turk dhe italian. Ai është autor i pesë përmbledhjeve me poezi).

Matt A. Hanson: Një Megalopolis* Bizantin



Erkut Tokman

ndryshëm në çdo kat së bashku me një kafene komode.

(Buket Uzuner është biologe dhe e trajnuar në shkencat mjedisore. Autorja e romaneve, tregimeve të shkurtra dhe udhëtimeve, libri i katërt dhe i fundit i Kuartetit të saj Natyror, "Zjarri", u botua në janar 2023).

Erkut Tokman: Qyteti si një roman i pashkruar

- Meqenëse ndodhet në fund të rrugës Istiklal (La Grand Rue de Pera) në lagjen Tünel (Tunel) të Beyoğlu -Stamboll dhe konsiderohet si libraria e tretë më e vjetër e qytetit, sa herë që kaloj pranë librarisë Cohen Sisters (Motrat Cohen), ajo ka qenë gjithmonë një kalim-kujtimesh për mua. Është një kalim i vjetër historik, me hijezime, me një kafene simpatike përballë stacionit të teleferikut Galata - Tunnel - i konsideruar si sistemi i dytë më i vjetër i metrosë me teleferikë (pas Londrës) - përmes të cilit mund të udhëtoni midis lagjeve Beyoğlu dhe Karaköy, duke u ngjitur deri në kodër. Menjëherë duke dalë nga stacioni, përballeni me derën e madhe dhe të mrekullueshme të hekurit të kalimit dhe stacionit të fundit të tramvajit të vjetër. Pronaret e librarisë ishin dy motra, hebrej sefardikë*: Mazalto Kohen dhe Elisa Kohen Benzimra. Ato e themeluan atë në kopshtin e konsullatës suedeze për të shitur libra mbi infermierinë dhe modën; më vonë,

stacionit të tramvajit, sikur të kishte mbetur e vetme, në fund të një kalimi me erë librash të vjetër. Dy tavolina të vjetra, të rrumbullakëta me një palë karrige përballë, janë shpesh bosh sa herë që jam atje. Ato përballen me shkallët për në katin e varur (pezull) të librarisë që ruan libra me bollëk mbi zonën e kuzhinës. Kam kërkuar këtu për libra të vjetër dhe disa të rinj, duke i pyetur gjithmonë për protagonistët e epokave të tjera që do të vizitonin librarinë sikur të kishin dalë nga një roman i pashkruar mbi Stambollin. Mbi "Muzeun e pafajësisë" së Orhan Pamuk ose "Një mendje në paqe e Ahmet Hamdi Tanpınar" do të zgjidhja Fatih-Harbiye të Peyami Safa-s, i vendosur pranë të njëjtit stacion të vjetër të tramvajit, të lagjes Tünel të librarisë. Fatih përshkruan "shpirtin dhe traditën lindore të Stambollit"; Harbiye - "shpirtin dhe traditën perëndimore". Protagonistja kryesore, Nerimane, përballet me një dilemë fejeje mes dy protagonistëve kryesorë meshkuj, Shenasiun dhe Mexhidin. Shenasiu mishëron karakterin dhe stilin e jetesës tradicionale lindore, ndërsa Mexhidi pasqyron idetë, vizionin dhe stilin e jetës së Stambollit modern perëndimor. Po kështu, midis dy lagjeve të qytetit, Fatih (lindor) dhe Harbiye (perëndimor), kalon tramvaji i vjetër - ashtu si protagonistët e romanit, të cilët udhëtojnë sa andej-këtej, ashtu si dy anët e qytetit, Lindja dhe Perëndimi. Ndihej si protagonist në këtë qytet, sikur e jetoj jetën time në një roman të pashkruar mbi Stambollin dhe besoj fort se edhe ata protagonistë duhet të ishin në librar-

- Një grua e çuditshme (1971), nga Leylâ Erbil, avancoi feminizmin avangardist nga skajet e Evropës, Rusisë dhe Islamit. Është një himn i fragmentuar i femrës, duke minuar perspektivat e një babai dhe nëne dhe pjekurinë e vajzës së tyre ndaj individualitetit të të rriturve, përmes evokimeve të rrjedhës së ndërjegjes së skenave historike të multikulturalizmit dhe artit të Stambollit, duke menduar për virgjërinë, martesën, incestin dhe lirinë nga patriarkitë e kombit dhe familjes. Me vetëdije të mprehtë politike, portreti i Stambollit i Erbilin në fund të shekullit të njëzetë zbulon trashëgiminë e vet letrare frojdiane dhe marksiste. Mendimet e saj mbi librat e komunizmit i përmbysin ndarjet e Lindjes dhe Perëndimit, të punëtorit dhe studiuesit. I nominuar dy herë për Çmimin Nobel për Letërsi nga PEN Turk, Erbili përfaqëson një anë të pakënduar të Stambollit përtej romanizimit të saj orientalist si Orhan Pamuk ose cikli i vështirë i lajmeve të vendit.

E ribotuar nga Deep Vellum në prill të vitit 2022, përkthyesja Amy Spangler përgatiti prozën e pjekur të Erbilin në një linjë të drejtpërdrejtë prejardhjeje bashkëpunuese me ish-përkthyesen Nermin Menemencioglu. Kafeneja letrare Minoa, përjetë nga kalatat (skelat) e Beshiktashit, përditëson raftet e veta me trillime të reja bashkëkohore në anglisht. Fondi i saj është veçanërisht i mbushur me libra arti dhe botime speciale, të formatit të madh si edhe libra të kuzhinës. Atje shërbehet një nga llojet e petullave më të shijshme në Turqi dhe organizojnë koncerte intime xhaz nën një bibliotekë komode me romane të dorës së dytë.

(Matt A. Hanson është gazetar dhe redaktor në Stamboll. Ai shqyrton dhe shtjellon romanet bashkëkohore turke për World Literature Today dhe ka shkruar për Artforum, Artnet News, ARTnews, ArtAsiaPacific, Tablet, Milionat, Fjalët pa Kufij dhe shumë të tjera).

* Megalopolis është një qytet i madh dhe me popullsi të dendur ose grup qytetesh që përbëjnë një kompleks urban.

(Marrë nga worldliteraturetoday.org, përktheu nga anglishtja: Fitim Nuhiu)



Matt A. Hanson

BILLIE HOLIDAY, PERËNDESHA E XHAZIT

Me krijimtarinë artistike, Billie u bë e dashur dhe e dëgjuar shumë edhe nga bota intelektuale, filozofi dhe shkrimtari i madh francez Jean-Paul Sartre, i pasionuar pas xhazit, e bëri të përjetshme Billie Holiday në romanet e tij, pjesë e trilogjisë në tentativë "Rrugët e lirisë".



Bujar MEHOLLI

Shumë prej artistëve të mëdhenj janë përcjellë nga vështirësitë, varfëria apo mungesa e prindërve; në kulm të dëshpërimit disa i kanë marrë jetën vetes duke ia shkrepur, disa i kanë "përpirë" vështirësitë dhe dufin e kanë zbratur përmes artit. Vështirësi të tilla përjetoi në fëmijërinë e saj edhe Billie, bija e një prostitute që punonte herë pas here në bordello. Billie, ende e njomë, u njoh me diçka të egër, çnjerëzore: u përdhunua nga fqinji i saj, nga ky tmerr që përjetoi mblodhi forcat për të ndërtuar një karrierë të jashtëzakonshme në xhaz, zhanër që përherë ka ofruar mundësi ideale për t'u zbratur nga vuajtjet dhe për ta lehtësuar sado pak shpirtin. Zaten, xhazi u lind si reagim ndaj vuajtjeve dhe robërisë që përjetonin njerëzit afro-amerikanë nën të bardhët.

Billie Holiday u lind më 7 prill të vitit 1915 në Filadelfia, por me emrin Eleanor Fagan. Qysh në fëmijëri shfaqu prirje drejt muzikës, vokali i saj i ngrohtë kishte premisat për t'u bërë i dëgjuar dhe i dashur në mbarë botën; nisi të interpretojë nëpër kafene të vogla të Filadelfias ku luhej xhaz mbrëmjeve. Aty provojë marihuanën dhe alkoolin në ambiente tipike xhazi, ku ngadhënjente liria e plotë e individit dhe qejfi rreth e rrotull tij. Për Billien ky ishte melhemi për t'i fashitur vuajtjet dhe tmerrin që kishte përjetuar. Për më tepër, e kishte braktisur edhe i ati derisa asaj i ishte dashur shpesh ta ndërrojë mbiemrin për shkak të marrëdhënies së prindërve dhe paligjshmërisë. Ngadalë, zëri i saj po linte mbresa të thella te njerëzit dhe të pasionuarit e xhazit që i frekuentonin këto mbrëmje full jazz. Njohja me muzikantë si Teddy Wilson e të tjerë, hapi portën e madhe të karrierës së saj. Kur ishte dërguar në shkollën e riedukimit, Billie që fascinohej nga vokali i Armstrongut që ka qenë crucial për të që ta zgjedh profesionin e këngëtares xhaz. Edhe aktorja e filmave pa zë Billie Dove i linte mbresa të thella. Gjithsesi, Nju-Jorku ishte për Billien "Tokë e Premtuar" siç ishte për Woody Guthrien apo për Bob Dylanin më vonë.

Me të arritur në Nju-Jork bashkë me të ëmën, karriera e saj profilizohet. Ajo nisi të interpretojë nëpër bare të vogla derisa njëra nga mbrëmjet që vendimtare për karrierën e saj. Ishte duke interpretuar për xhaz & bluz këngëtares Monette Moore, kur për fat të mirë aty ndodhej John Hammond, i njohur për zbulimin e talenteve të reja. Mjaftoi ta dëgjonte për pak çaste teksa interpretonte. Ai që i bindur se Billie do të jetë ylli i ardhshëm i xhazit. "Billie është e jashtëzakonshme. Ajo është këngëtarja më e mirë e xhazit që kam dëgjuar" u shpreh teksa i ofroi kontratë dhe e prezantoi me pianistin Wilson që e përmenda sipër. Ishte viti

1933 kur Billie nisi të luajë me pianistin Wilson. Më pas në seancat e regjistrimit që organizonte Hammond, u njoh me trumpetistët më të njohur të kohës. Kur e dëgjonin Billien duke kënduar ngeleshin të fascinuar nga individualiteti i saj i spikatur vokal që vinte krejt natyrshëm. Billie ishte e lindur për të kënduar me një thellësi të jashtëzakonshme që krijon emocione të mëdha. Përmes zërit zbraste gjithë trishtimin dhe vuajtjet që i ishin mbledhur në grykë nga jeta e trazuar. Duke e njohur saksofonistin Lester Young dhe duke vazhduar me interpretimet e incizimet, popullariteti i saj u rrit ndjeshëm. Ajo konsiderohej dendur si njëra nga këngëtares më të mira në historinë e xhazit. Kjo vajzë e varfër dhe me jetë të shthurur arriti të bëhet yll xhazi; siç e shohim stili dekadent i jetesës u shtri në tekstet e këngëve të saj që luftonin racizim dhe seksizmin.

Kah fundi i viteve '30 ajo bëri sërë bashkëpunimesh me muzikantë si Count Basie, Artie Shaw, Benny Goodman, Duke Ellington, Ben Webster, etj, ku u shqua për transformimin vokalistik. Megjithatë, ky zë i mrekullueshëm vinte e rrënohej dita-ditës dhe për këtë fajin e kishin disa shprehë të Billies si heroina, opiumi, dhe veçmas, cigarja, të cilën e konsumonte në masë të madhe. Diskografia e saj përbëhet nga gjithsej 12 albume në studio, tre albume live dhe 38 këngë single. Ajo bashkëpunoi me kompanitë e famshme të incizimit të këngëve si "Columbia records", "Brunswick records" apo "Decca records". Ndër hitet e mëdha që edhe sot e gjithë ditën dëgjohen me ëndje, janë: "I'll be seeing", "If the moon turns green", "Blue moon", "Am I blue?", "I'm a fool to want you" e shumë tjera...

Vitet '40 shënojnë nisjen e rrënimt të karrierës së saj. Pasi i vdiq e ëma, varësia ndaj heroinës u bë e evidente në jetën e Billies, ishte pikërisht ajo që ia shkatërroi karrierën teksa në gjendje të rënduar psiko-emocionale akuzohej në vazhdimësi për përdorim të tepruar drogash, ikje nga pagesa e tatimit dhe për prostitucion. Vite më vonë, shohim një Billie pothuajse të shpërfytyruar: s'e ka më sharmin e dikurshëm kur interpretonte në kafenet e vogla, as kur incizonte këngë të pavdekshme si: "I can't get started", "Summertime" apo "These foolish things". Zëri i ishte më i ngjirur dhe i zhytur në melankoli të thellë. Megjithë përpjekjet që të mbetej aktive dhe të incizoi këngë tjera, iu shfaqën problemet shëndetësore nga varësia ndaj drogës dhe pijes, ndaj gjendja fizike iu përkeqësua ndjeshëm. Ajo u shtri në spital në majin e vitit '59. Ndërroi jetë nga sëmundja e mëlçisë më 17 korrik, 44-vjeçare. Kortezhin e saj e shoqëroi një numër i madh njerëzish, 3000, kryesisht muzikantë xhazi dhe artistë tjerë që përshëndeteshin me femrën e veçantë dhe të rrallë që kishte kaluar nëpër një jetë të trazuar me shumë vuajtje, dëshpërime, humbje e rëndime shpirtërore, por që kishte arritur ta skalis emrin me shkronja të arta në zhanrin e asaj muzike që ia fashiste dhimbjet dhe i jepte sado pak prehje në këtë botë të madhe e të egër. Me krijimtarinë artistike, Billie u bë e dashur dhe e dëgjuar shumë edhe nga bota intelektuale, filozofi dhe shkrimtari i madh francez Jean-Paul Sartre, i pasionuar pas xhazit, e bëri të përjetshme Billie Holiday në romanet e tij, pjesë e trilogjisë në tentativë "Rrugët e lirisë". Tingujt sensual kur ngjizeshin me vokalin krijonin melhemin e vetëm për këtë shpirt delikat që arriti të hip në fronin e xhazit dhe të mbesë aty.

Jeff Weddle

MANIFESTI VRITMË NËSE KE KOQE

Për kë të shkruajmë, nëse jo për njerëz?

Profesorët, predikuesit dhe shefat nuk na duan dhe nuk kanë nevojë për ne.

Ata janë të mbushur me dogmat e shekujve.

Çfarë leverdie do të kishin prej poezie?

Pyetni profesorët dhe ata do të thonë

e dinë se çka është poezia, dhe çka nuk është

dhe kujt i lejohet ta shkruajë. Në pidh të s'amës

le të shkojnë.

Pyetni predikuesit dhe ata do të thonë

vargu i urryer i dymijë viteve të kaluara

është i mjaftueshëm për të na mbajtur të gjithëve të ngopur,

duke dhjetuar, të frikësuar dhe nën kontroll. Në pidh

të s'amës le të shkojnë.

Pyetni shefat edhe ata do të thonë se nuk marrin vesh gjë nga poezia dhe duan që asgjë të mos ndryshojë as për ta dhe as për punëtorët e tyre.

Trutrumcakëve u pëlqejnë trutrumcakët dhe,

bile edhe më shumë, turrja pas parasë. Në pidh

të s'amës le të shkojnë.

Por punëtorët, disa prej tyre, kanë nevojë për atë që ne ofrojmë, bile edhe nëse e kuptojnë poezinë.

E njëjta gjë vlen për të varfërit, të harruarit, të dëbuarit.

Është e vërtetë për të rinjtë ende të paregjur

me rutinë dhe rrena.

Është e vërtetë për shpirtin e lirë, kërkuesit, të trishtuarit, të vetmuarit, të zgjuarit,

të çuditshmit, tinëzakët në errësirë, të harlisurit, paranojakët,

maniakët seksual, narkomanët, pijanecët, të çmendurit

dhe të hareshmit.

Është e vërtetë për planetin tonë të pushtuar,

duke u vrarë minutë pas minute nga përsëritja e pamend e së djeshmes.

Njerëzit kanë nevojë për poezi bile edhe nëse nuk e kuptojnë fort mirë.

I rri në besë poezisë, vëllezër dhe motra.

Shkruani ëndrra dhe vizione të reja.

Ky është melhemi që ne sjellim.

Kjo është ajo që mban dritën e botës.

Unë nuk u besoj librave që i kam lexuar

as flamujve të vendit tim

as flamujve të shtetit tim

dhe po që se qyteti im ka një flamur

as atij nuk i zë besë.

Jam mosbesues ndaj zogjve të caktuar

dhe shumë fëmijëve.

Vashat më trembnin kur isha i ri

dhe më në fund e kam kuptuar se nuk kisha faj.

Unë nuk u besoj këngëve tua patriotike

bile as siloganeve tua finoke.

Vritmë nëse ta merr mendja.

Nuk besoj se ke koqe.

Ngandonjëherë besoj në filma,

nëse janë përnjëmend filma të mirë

mbi krimet serioze dhe femrat fatale,

ose, edhe më mirë, Porky Pig.

Kryesisht shikoj në horizont

dhe pyes veten pse shikimi i një gjëje

të tillë

mund të ketë rëndësi.

Dhe po kërkoi kafe në kuzhinë

dhe shikoj orën time për justifikime

dhe i rrëmbej librat me grusht

dhe aty-këtu e lexoj nga ndonjë rresht

dhe pastaj ndaloj dhe përpiqem të fle.

Unë besoj në ëndrrat e mia më të thella,

në ato që vijjnë rrallë.

Po kërkoi rrugëdalje nga këtu,

dëshira ime më e rëndësishme që kam pasur ndonjëherë,

ama nuk besoj se do të realizohet ndonjëherë.

Pëktheu: Fadil Bajraj

NUMRI I ARDHSHEM ME 15 MAJ

HEJZA

05 MAJ, 2023

Kryeredaktor i Hejzës: **Avni Halimi** (avni65halimi@gmail.com)

Editon Produksioni **TAKAT STUDIOS**
Drejtor: **Genc Halimi** (genc@takat.tv)

Rruga e Kaçanikut nr. 208, Shkup, 1000